

# AKTIVITETI PËR PAJTIM DHE TRANSFORMIM TË KONFLIKTIT

MANUAL PËR EDUKIMIN  
QYTETAR MBI PAQEN





# **AKTIVITETI PËR PAJTIM DHE TRANSFORMIM TË KONFLIKTIT**

Manual për edukimin qytetar mbi paqen

Redaktuar nga:  
Nevena Radosavljević

Gusht 2022,  
Munih, Gjermani



# Përmbajtja

|   |            |
|---|------------|
| <b>1. Hyrje .....</b>   | <b>06</b>  |
| <b>2. Mirëkuptimi ndërkulturor .....</b>                          | <b>07</b>  |
| 2.1. Dialogu ndërkulturor .....                                   | 08         |
| 2.2. Paqja dhe ndërtimi i paqes .....                             | 16         |
| 2.3. Konflikti dhe transformimi i konfliktit .....                | 36         |
| 2.4. Dhuna .....  | 43         |
| 2.5. Pajtimi .....  | 48         |
| 2.6. Të drejtat e njeriut .....                                   | 53         |
| 2.7. Kujtimi .....  | 62         |
| 2.8. Ndjeshmëria dhe shkrim-leximi emocional .....                | 70         |
| <b>3. Komunikimi .....</b>  | <b>75</b>  |
| 3.1. Gazetaria e paqes .....                                      | 76         |
| 3.2. Stereotipet dhe paragjykimet .....                           | 86         |
| 3.3. Ndryshimi i narrativëve .....                                | 90         |
| 3.4. Gjuha e urrejtjes .....                                      | 99         |
| 3.5. Lajmet e rreme dhe edukimi mediatik .....                    | 107        |
| <b>4. Ndërmarrësia shoqërore .....</b>                            | <b>113</b> |
| 4.1. Ndërmarrësia shoqërore – Teori dhe praktikë .....            | 114        |
| 4.2. Problemet Sociale, Aktivizmi dhe Ndërmarrësia Shoqërore .... | 119        |
| <b>5. Mirënjohjet .....</b>                                       | <b>124</b> |
| <b>6. Bibliografia .....</b>                                      | <b>125</b> |

# 01

## Hyrje

Mirë se vini në doracakun për Edukim Qytetar për Paqe, i prodhuar përmes Aktivitetit për Pajtimin dhe Transformimin e Konfliktëve, i zbatuar nga Community Building Mitrovica, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë dhe Iniciativa e Re Shoqërore, dhe e mbështetur nga popullin amerikan përmes USAID-it.

Ky manual ka për qëllim të ofrojë njohuri të gjera mbi temat e të mësuarit ndërkulturor, komunikimit dhe ndërmarrësisë shoqërore. Ai bashkon teorinë dhe praktikën e edukimit për paqen përmes mësimi joformal dhe formal.

Këto tre tema janë të ndara në kapituj të ndryshëm dhe në nën tema të ndryshme. Çdo nën temë përbëhet nga: (Shënim i përkthyesit: sipas origjinalit temat janë ndarë në kapituj dhe në nëntema, prandaj mendoj që duhet të përdoret shprehja nën temë).

- 1 Pjesa teorike, që ndihmon në kuptimin e mëtejshëm të lëndës;
- 2 Pjesa praktike, që ofron dy punëtori për lëndë, që mbështesin kuptimin dhe reflektimin e mëtejshëm të çështjes, si dhe një udhëzim praktik për drejtimin e punëtorive.

Përveç kësaj, disa nga temat po sjellin edhe pjesën e tretë – praktikën e mira nga niveli lokal. Kjo pjesë jep informata për projektet më të suksesshme në Kosovë që janë zbatuar nga Community Building Mitrovica, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë dhe Iniciativa e Re Shoqërore.

Ky doracak paraqet një përmbledhje të metodave më të mira praktike nga materialet dhe mjetet e ndryshme arsimore, të cilat janë përshtatur në kontekstin e Kosovës, si dhe teoritë e studiuesve të shquar në fushat që mbulojnë.

Përfundimisht, doracakun u kushtohet edukatorëve, mësuesve, aktivistëve, punëtorëve rinorë dhe të gjithëve që dëshirojnë të punojnë më tutje në edukimin për paqen dhe të drejtat e njeriut. Doracakun synon të sjellë edukimin për paqen më afër të gjitha niveleve të shoqërisë, të mbështesë më tutje kulturën e paqes dhe të nxisë procesin e ndërtimit të paqes dhe pajtimin brenda kontekstit të Kosovës.



# 02

## Mësimi ndërkulturor

## 2.1. Dialogu ndërkulturor

Dialogu ndërkulturor është një nga thelbësoret e botës moderne, por në të njëjtën kohë, një nga mjetet më të vjetra të demokracisë dhe paqes. Në botën e kombësive, etnive, kulturave, feve, racave, gjinive, traditave, gjuhëve dhe në fund të personaliteteve të ndryshme, është shumë e rëndësishme të jemi të vetëdijshëm për këto dallime dhe të gjejmë mënyra të mirëkuptimit dhe komunikimit dhe dialogut paqësor.

Sipas Këshillit të Evropës, dialogu ndërkulturor është përkufizuar si “shkëmbim i hapur dhe i respektueshëm i pikëpamjeve ndërmjet individëve, grupeve me prejardhje dhe trashëgimi të ndryshme etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore mbi bazën e mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë. Ajo operon në të gjitha nivelet - brenda shoqërive, midis shoqërive të Evropës dhe midis Evropës dhe botës më të gjerë”<sup>1</sup>.

Dialogu ndërkulturor është në pajtim me edukimin ndërkulturor që ka për qëllim të sjellë mirëkuptim midis kulturave dhe njerëzve të ndryshëm duke hulumtuar dallimet dhe ngjashmëritë e tyre. Mësimi dhe dialogu ndërkulturor janë jashtë rëndësisë në luftimin

e llojeve të ndryshme të dhunës, diskriminimit ose çdo lloj shkeljeje të të drejtave të njeriut. Për më tepër, është e rëndësishme të thuhet se në kultura të ndryshme, simbole apo sjellje të ndryshme kanë kuptime të ndryshme. Prandaj, duhet të jemi të vetëdijshëm se diçka që pranohet pozitivisht në kulturën ose shoqërinë tonë mund të jetë fyese për kulturat ose shoqëritë e tjera përkatëse. Dialogu ndërkulturor na lejon të kuptojmë dhe respektojmë dallimet, por edhe të kërkojmë ngjashmëri. Për më tepër, dialogu ndërkulturor na hap një hapësirë për të mësuar, hulumtuar dhe rritur si persona. Na jep një mundësi për t’iu qasur të tjerëve me një mendje të hapur dhe kuriozitet, dy pika fillestare për të takuar njerëz që janë nga kultura dhe etni të ndryshme dhe që flasin gjuhë të ndryshme. Nëse i afrohem me kuriozitet dhe me mendje e zemër të hapur – mund të na hapë një botë krejt të re.

Kur mendojmë për kultura të ndryshme, është gjithmonë e rëndësishme të mendojmë për pamjen më të gjerë (Shënim i përkthyesit: Përveç përkthimit kam përdorur edhe përshtatje, nuk bëhet fjalë për konflikt fjalësh, kjo e përdorur është e saktë dhe e duhur), më të gjerë nga ajo që mund të vëzhgojmë. Për të ndihmuar këtë, Edward T. Hall<sup>2</sup> ka krijuar një Model Kulturor Ajsberg.

<sup>1</sup> Dokumenti i Bardhë mbi Dialogun Ndërkulturor, 2008, i paraqitur nga Ministrat e Punëve të Jashtme të Këshillit të Evropës në sesionin e tyre të 118-të ministror, Strasburg;

<sup>2</sup> Për më shumë informata, lexojeni Edward T. Hall, *Beyond Culture*, 1976.



# AJSBERGU KULTUROR

Figura Nr. 1,  
Modeli Kulturor  
i Ajsbergut



TË OBSERVUARA

TË PA OBSERVUARA

Ky Model Ajsberg (Figura Nr. 1) tregon se ka shumë më tepër në kulturë sesa mund të shohim, se ka më shumë gjëra nën sipërfaqe që mbështesin një kulturë.

Kjo do të thotë që, ne nuk mund të gjejkojmë një kulturë bazuar në atë që shohim,

por duhet të kalojmë më shumë kohë duke zbuluar individë nga kulturat përkatëse. Ne duhet të hulumtojmë perceptimin, qëndrimet, besimet dhe vlerat në mënyrë që të kuptojmë më mirë një kulturë.

Përfundimisht, për të kuptuar më mirë një kulturë, ose kultura, mund të përdorim edhe “Qepën kulturore” (Figura Nr. 2) që u zhvillua nga Geert Hofstede. Qepa është një metaforë e dobishme për të shpjeguar se kulturat kanë shumë shtresa, ashtu si një

qepë, dhe kultura është shumë më tepër se ajo që shohim jashtë. Qepa kulturore mund të na ndihmojë të kuptojmë kulturën përmes shtresave të vlerave, ritualeve, heronjve dhe simboleve.

# QEPA KULTURORE




FIGURA NR. 2  
QEPA KULTURORE

## IDE PËR PUNËTORI

## PUNËTORIA



Punëtori e përshtatur nga  
Pakoja e Instrumenteve për  
Dialogun Ndërkulturor, Shërbimi  
Civil Ndërkombëtar

## Linja e dallimit

**Koha:** Deri në 1h e 30min

**Grupi:** Më shumë se 10

**Qëllimi:** Për të kuptuar  
dallimet dhe për të gjetur  
ngjashmëri (mund të përdoret  
gjithashtu për të njohur më

mirë njëri-tjetrin).

**Materialet:** Letra dhe  
stilolapsa

## Përshkrimi i punëtorisë:

**HAPI 1** Jepu pjesëmarrësve 2 letra dhe kërkoni të shkruajnë në njërën prej tyre një gjë që kanë të përbashkët me të tjerët në grup. Kjo nuk duhet të jetë diçka e qartë si “Unë jam një qenie njerëzore”, por diçka më delikate si “më pëlqen të mësoj gjuhë të tjera”.

Pas kësaj, kërkoni të shkruajnë në letrën tjetër një gjë që i bën ata të ndryshëm nga të tjerët në grup. Përsëri, nuk duhet të jetë diçka vërtet e dukshme si “Unë kam flokë të kuq”, por diçka më pak e dukshme, si “Unë jam duke mbledhur kartolina/Nuk kam udhëtuar asnjëherë jashtë vendit tim”. Ata nuk duhet të shkruajnë emrat

e tyre në letër. Kur të kenë mbaruar, facilituesit duhet të mbledhin të gjitha letrat.

**HAPI 2** Kërkoni nga pjesëmarrësit të qëndrojnë në një rresht përpara facilituesit. Duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme ndërmjet facilituesve dhe pjesëmarrësve. Për shembull, nëse jeni në dhomën e trajnimit ose në klasë, pjesëmarrësit duhet të jenë në njërën anë të dhomës, ndërsa facilituesi është në anën tjetër, përballë njëri-tjetrit.

**HAPI 3** Facilituesi duhet të lexojë me zë të lartë të gjitha fjalitë një nga një. Kërkoni pjesëmarrësve të bëjnë një hap përpara nëse mund të

lidhen me fjalinë. Ata që nuk mund të lidhen me fjalinë nuk duhet të lëvizin. Pas disa sekondash, pjesëmarrësit duhet të kthehen në rresht. Ky ushtrim duhet të bëhet në heshtje, vetëm duke vëzhguar dhe jo duke komentuar.

**HAPI 4** Facilituesi mund të shtojë gjithmonë fjali (të përfshira në shtojcë).

Hapi 5: Pasi të lexohen të gjitha fjalitë, kërkoni pjesëmarrësve të ulen në rreth për reflektimin përfundimtar.

## INFORMIMI



(facilituesi gjithmonë mund të shtojë pyetje në varësi të mënyrës se si shkoi aktiviteti (për shembull diçka që ishte interesante ose befasuese):

- Si ndiheni pas këtij aktiviteti?
- A keni ndonjë përfundim në bazë të

këtij aktiviteti?

- A ka pasur diçka që ju ka habitur?
- Çfarë ju pëlqeu më shumë?
- Sa e lidhni këtë aktivitet me botën reale?
- Si mund të jemi më të vetëdijshëm për dallimet dhe ngjashmëritë në jetën tonë?

**Përfundoni me theksimin e rëndësisë së mbajtjes së mendjes dhe zemrës së hapur dhe takimit me njerëz me kuriozitet për të mësuar më shumë, jo për të gjykuar. Diversiteti është ajo që na bën të bukur.**



### SHTOJCA 1

#### FJALITË E SUGJERUARA PËR T'I SHTUAR:

- 1 Unë e dua familjen time;
- 2 Unë jam mysliman/ortodoks/katolik/ateist;
- 3 Unë jam homoseksual;
- 4 Unë kam vizituar më shumë se 10 vende;
- 5 Unë kam vuajtur nga konflikti i armatosur në Kosovë;
- 6 Unë flas më shumë se 3 gjuhë;
- 7 Unë besoj në paqe;
- 8 Unë i dua qentë;
- 9 Ne jemi të ndryshëm por të barabartë;
- 10 Unë besoj në barazinë gjinore;
- 11 Unë do të kisha një partner nga kombësi/etni/fe të ndryshme;
- 12 Unë do të doja të jetoja diku tjetër;
- 13 Unë preferoj dimrin para verës;
- 14 Unë do të doja të mësoja shqip/serbisht;
- 15 Mua më pëlqen fantashkenca.

# PUNËTORIA



Punëtori e përshtatur nga Pakoja e Instrumenteve për Dialogun Ndërkulturor, Shërbimi Civil Ndërkombëtar

## Perceptimi i mjedisit kulturor

**Koha:** Deri në 1h e 30 min

**Grupi:** Më shumë se 10

**Qëllimi:** Të hulumtohen kultura të ndryshme dhe shtresa të kulturës.

**Përgatitja:** Koncepti i modelit kulturor të ajsbergut dhe qepës kulturore.

**Materialet:** Fletushka të printuara, Ajsberg në letër grafike ose prezantim.

### Përshkrimi i punëtorisë:

**HAPI 1** Jepini secilit pjesëmarrës një fletushkë të shtypur dhe jepini 15 minuta për t'i mbushur ato vetë (ky është ushtrim individual);

**HAPI 2** Pasi të keni përfunduar punën individuale, ndani ata në grupe (5-6 persona për grup, në varësi të madhësisë së të gjithë grupit) dhe kërkojuni të ndajnë thjerrëzat e tyre (deri në 25 minuta);

**HAPI 3** Pas ndarjes në grupe, kthejini ata përsëri në grup dhe pyesni se çfarë do të thotë kultura për ta, ose çfarë elementesh duhet të ketë? Pas diskutimit, tregojuni atyre dhe shpjegoni Modelin e Ajsberg-ut dhe Qepën Kulturore dhe për çfarë përdoren ato;

**HAPI 4** Pasi ta shpjegoni këtë, kërkojuni atyre të kthehen në grupet e tyre të mëparshme dhe të përpiqen të vendosin thjerrëzat e tyre

në modele - vendosni çdo karakteristikë ose në modelin e qepës ose në modelin e ajsbergut. Informoni grupin se pas kësaj, çdo grup duhet të prezantojë të dy modelet;

**HAPI 5** Secili grup paraqet modelet e tij dhe atë që ka mbledhur. Gjetja e ngjashmërive ndërmjet grupit mirëpritet gjatë prezantimeve.

## INFORMIMI



1. A keni mësuar diçka të re në lidhje me kulturat tjera?
2. A ishte e lehtë për të gjetur një shtresë apo vendosur karakteristikat? Çka ishte lehtë, çka ishte vështirë?
3. Sa ju ndihmoi ky ushtrim të kuptoni më mirë kulturat?
4. Cilat janë mësimet kryesore nga ky aktivitet?



## SHTOJCA

Perceptimi juaj pozitiv për kulturën tuaj  
Maksimum 3 gjëra

---

---

---

---

Perceptimi juaj negativ për kulturën tuaj  
Maksimum 3 gjëra

---

---

---

---

Stereotipi global pozitiv i kulturës suaj i  
perceptuar nga të huajt  
Maksimum 3 gjëra

---

---

---

---

Stereotipi global negativ i kulturës suaj i  
perceptuar nga të huajt  
Maksimum 3 gjëra

---

---

---

---

## PRAKTIKAT E MIRA NGA NIVELI LOKAL

### 1. KOLEKTIVI I KOSOVËS

**Çfarë?** - Kolektivi i Kosovës - objektivi i përgjithshëm i këtij projekti të IRSH (*Iniciativa e Re Shoqërore*) ishte të kontribuonte në procesin e demokratizimit dhe dialogut konstruktiv ndëretnik përmes sfidimit të kapjes së shtetit në Kosovë, duke nxitur dhe promovuar bashkëpunimin dhe komunikimin pozitiv ndërkomunitar për sfidat kryesore shoqërore. Një grup kolektiv ekspertësh, akademikësh dhe analistësh rinorë shqiptarë dhe serbë u mbledhën për të sfiduar kapjen e shtetit dhe për të thyer modelin e “politikave me bazë etnike” dhe narrativëve sundues brenda shoqërisë kosovare. Një raport u publikua si një përmbledhje e diskutimeve që Kolektivi i Kosovës pati në pesë takimet e tyre gjatë vitit 2021. Diskutimet e Kolektivit të Kosovës u strukturuan si takime gjysmë formale Chatham House, për të lehtësuar një diskutim të hapur mbi temat që duket se i ndajnë serbët dhe shqiptarët në Kosovë. Ajo që i bën të jashtëzakonshme diskutimet e Kolektivit të Kosovës është se ato trajtuan çështje që konsiderohen të ndjeshme, pra padinë për gjenocid ndaj Serbisë nga Kosova. Vlen të theksohet se të gjitha këto takime u frymëzuan, u organizuan dhe u lehtësuan tërësisht në nivel lokal, dhe asnjë nga takimet nuk kishte aktorë të jashtëm, d.m.th., “dikush nga BE-ja”, të ndihmonte në krijimin e një mjedisi të favorshëm për diskutim. Ky projekt ishte shembulli i përsosur i agjencisë së fuqishme të shoqërisë civile në Kosovë, dhe potencialit për të luajtur një rol më konstruktiv dhe më mundësues në procesin e përgjithshëm të normalizimit të marrëdhënieve.

**Nga kush?** Nisma e Re Shoqërore

### 2. AKTIVITETI I DIALOGUT TË TË RINJËVE TË KOSOVËS

**Çfarë?** - Aktiviteti i dialogut të të rinjve të Kosovës - Qëllimi kryesor i këtij projekti është fuqizimi i të rinjve për të qenë pjesë aktive në ballafaqimin me të kaluarën dhe procesin e pajtimit në Kosovë, duke inkurajuar komunikimin, ndërveprimin dhe bashkëpunimin ndëretnik, adresimin e interesave të përbashkëta, ndërtimin e besimit dhe promovimin e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe qëndrimeve pozitive. Nëpërmjet aktiviteteve të tij arsimore joformale siç është Programi i Shkëmbimit të Rinisë, ky projekt përmbush misionin e tij për angazhimin e të rinjve nga komuniteti shqiptar dhe serb në Kosovë, për të kontribuar më shumë në ballafaqimin me procesin e kaluar duke i inkurajuar ata që të jenë avokatët e radhës të pajtimit. Gjatë shkëmbimit, të rinjtë mësojnë edhe për bazat e fotografisë së prodhimit të videove, tregimit dhe teatrit. Secili grup ka një mentor profesionist për të udhëhequr dhe ndihmuar studentët në projektet e tyre. Detyra e tyre është t'i përdorin këto forma arti si një mjet për dialog dhe bashkëpunim me njëri-tjetrin, si dhe një mënyrë për të kundërshtuar bashkërisht narrativet nacionaliste që ekzistojnë në shoqëritë tona dhe në të njëjtën kohë për të promovuar pajtimin. Pas përfundimit të shkëmbimit, pjesëmarrësit kanë mundësinë të ekspozojnë projektet e tyre për publikun e gjerë.

**Nga kush?** Zbatuar nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut Kosovë dhe mbështetur nga USAID.

## 2.2. PAQJA DHE NDËRTIMI I PAQES

“Paqja është më shumë se mungesa e luftës” është mësimi më i rëndësishëm në procesin e përcaktimit të paqes, edhe pse ka tendenca për ta përshkruar paqen thjesht si “mungesë lufte”. Pas këtij përkufizimi, mund të jemi më të saktë dhe të themi se paqja është mungesa e çdo lloj dhune. Paqja nuk është thjeshtë një gjë e thjeshtë që ndodhë në një moment të caktuar por një proces jo i dhunshëm dhe pjesëmarrës që redukton çdo lloj dhune. Për më tepër, paqja krijon kushte të mirëqenies në nivele të ndryshme: të brendshme (paqe brenda vetes), sociale (paqe me të tjerët) dhe mjedisore (paqe me natyrën). Ky doracak fokusohet më shumë në paqen me tjetrin, duke marrë parasysh situatën aktuale në Kosovë dhe marrëdhëniet ndëretnike, si dhe nevojën për të nxitur marrëdhëniet ndërmjet njerëzve që kanë vuajtur nga lufta në Kosovë.

Johan Galtung<sup>3</sup>, i njohur si “babai i studimeve të paqes” në hulumtimin për paqen, ishte një nga pionierët e përcaktimit të paqes. Ai dallon dy lloje paqeje, pozitive dhe negative. Sipas tij, paqja negative mund të përshkruhet si përkufizim që në fillim, mungesë e thjeshtë e luftës, apo mungesë e konfliktit të hapur të armatosur. Paqja negative mund të shihet si një armëpushim për shembull. Nga ana tjetër, paqja pozitive nënkupton reduktimin e të gjitha llojeve të dhunës dhe arritjen e paqes duke përdorur mjete paqësore dhe jo të dhunshme. Paqja pozitive kërkon të arrijë të gjitha liritë, të drejtat e njeriut dhe barazinë për të gjithë njerëzit. Duke marrë parasysh në kontekstin lokal, situata aktuale në Kosovë mund të quhet paqe negative pasi komunitetet e vuajtura nga lufta nuk përjetojnë më konflikt të hapur

të armatosur, por ende jetojnë të ndarë dhe pa marrëdhënie mes tyre. Paqja pozitive do të nënkuptonte që të gjitha komunitetet që vuajtën nga lufta të jetojnë dhe të bashkëpunojnë në mënyrë të barabartë, duke respektuar të drejtat dhe liritë e të gjithëve.

Përveç paqes pozitive dhe negative, ne mund të dallojmë edhe aktorë të ndryshëm për paqen. Piramida e Ndërtimit të Paqes, e zhvilluar nga John Paul Lederach<sup>4</sup>, është një mjet që na ndihmon të kuptojmë më mirë se cilët janë aktorët e paqes dhe rolet e tyre.<sup>12</sup>

3 Për më shumë lexojeni Johan Galtung, “Peace by Peaceful Means”, 1996;

4 Për më shumë informata lexojeni “Building Peace: Sustainable Reconciliation in Divided Societies”, John Paul Lederach, 1998;






FIGURA NR. 2  
**TREKËNDËSHI I LEDARCH I LIDERSHIPIT TË PAQES**

Sipas tij, ekzistojnë tre nivele të ndryshme të udhëheqjes në ndërtimin e paqes: nga lart-poshtë, niveli i mesëm dhe niveli bazë. Ndërsa niveli nga lart-poshtë përfaqëson lidërshepin politik të nivelit të lartë, niveli i mesëm i referohet udhëheqësve akademikë dhe fetarë, dhe niveli bazë është i përqendruar në liderët lokalë, trajnimet dhe përfshirjen e të rinjve. Edhe pse ka nevojë që të tre nivelet të punojnë fort për të arritur paqen, niveli bazë i shoqërisë, siç mund ta vërejmë në piramidën e paraqitur, është më i madhi, prandaj ka ndikim të lartë në procesin e ndërtimit të paqes. Është e rëndësishme të theksohet roli që të

rinjtë dhe qytetarët kanë në këtë proces, pasi ata mund të jenë udhëheqës të paqes dhe të nxisin ndryshime paqësore në shoqëri. Nuk është gjithmonë nevoja për të qenë në një pozicion drejtues nga lart-poshtë për të sjellë ndryshime pozitive. Për më tepër, nëse ndjekim këtë piramidë, mund të konkludojmë lehtësisht se pushteti është në duart e nivelit bazë të shoqërisë.

## IDE PËR PUNËTORI

## PUNËTORIA



## REFLEKTIMI ME NDËRTUESIT E PAQES

**Koha:** Deri në 1h e 30 min.

**Grupi:** Më shumë se 10 (Gjatë punës në grup do të ketë pesë grupe pune, prandaj sigurohuni që të ketë pjesëmarrës të mjaftueshëm për çdo grup (së pakut 2)

**Qëllimi:** Për t'u frymëzuar për të ndërmarrë veprime për paqen, mësoni më shumë rreth ndërtuesve të shquar të paqes dhe merrni motivim për të qenë më aktivë në këtë fushë..

**Materialet:** Letra dhe lapsa

## Përshkrimi i punëtorisë:

## HAPI 1

Ndani pjesëmarrësit në pesë grupe. Për këtë, ju mund të përdorni një energjizues, për shembull sallatë frutash. Sallatë frutash: shkruani në copa të vogla letre 5 lloje të ndryshme frutash (për shembull: banane, mollë, luleshtrydhe, kumbull, qershi). Përziejeni ato dhe kërkoni secilit pjesëmarrës të marrë një letër për vete. Nëse grupi përbëhet nga persona që i takojnë komuniteteve me gjuhë të ndryshme, mund të shkruani gjithashtu të gjitha frutat në tabelë, së bashku me përktimet në të gjitha gjuhët e folura në dhomë. Sigurohuni që të ketë një karrige për çdo person në dhomë, përveç jush që jeni në

këmbë. Rregullat janë si më poshtë: personi në mes, në këtë rast ju, duhet të thotë një frut. Në atë moment, të gjithë njerëzit që e kanë këtë frut, duhet të ndryshojnë vendet, përfshirë edhe ju. Një person që qëndron në këmbë duhet të thotë frutin tjetër. Përveç frutave, ekziston një opsion për të thënë "sallatë frutash" që do të thotë se të gjithë duhet të ndryshojnë vendet. Nëse grupi është shumëgjuhësh, personi në mes duhet të përdorë gjuhën që nuk është vendlindja e tij/saj. Luaje disa herë derisa të gjithë të zhvendosen të paktën 2-3 herë.

Ndajeni grupin në pesë, sipas llojit të frutave që ishin.

## HAPI 2

Secili grup merr rastet për një nga ndërtuesit e paqes (Alice Paul, Mahatma Gandhi, Martin Luther King, Malala Yousafzai, Nelson Mandela). Rastet janë në shtojcë.

## HAPI 3

Kërkojuni atyre të analizojnë rastin dhe të zhvillojnë një poster për këtë ndërtues të paqes, duke iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:

1. Cila ishte sfida kryesore me të cilën po përballlej ai/ajo?
2. Cili ishte konflikti kryesor që ajo/ai duhej të zgjidhte?
3. Duke përdorur cilat qasje/metoda u përpoq ajo/ai të zgjidhte konfliktin?

4. Cili ishte aktiviteti më i rëndësishëm për ndërtimin e paqes që ka bërë ky person?

**HAPI 4** Njoftoni ata se duhet të jetë një person që do të veprojë si paqe ndërtues që ata morën, duke e përfaqësuar këtë person gjatë emisionit televiziv “Reflektim me Paqe ndërtuesit”. Jepuni 30 minuta për t’u përgatitur për rolet e tyre dhe për të analizuar rastet.

**HAPI 5** Ftoni ata në emisionin televiziv “Reflektim me Paqe Ndërtuesit”. Dhoma duhet të organizohet në atë mënyrë që pjesëmarrësit që përfaqësojnë paqe ndërtuesit të ulen përpara pjesëmarrësve të tjerë, në mënyrë që të gjithë t’i shohin ata. Prezantuesi i TV (me ta janë edhe facilitue-

sit.) Le të fillojë emisionin televiziv!

Pyetje të mundshme për emision televiziv:

- Ju lutem prezantoni veten. Si quheni? Nga jeni?
- Cili është edukimi juaj?
- Çfarë ju bën të dëshironi të përfshiheni në konflikt në komunitetin tuaj?
- Cilat veprime keni ndërmarrë për paqen në komunitetet tuaj?
- Cilat ishin veprimet më të rëndësishme që ju keni bërë?

**HAPI 6** Informimi

- Si ju pëlqeu ky aktivitet?
- A jeni befasuar nga ndonjë informatë? Çfarë ju duk më tronditëse, apo më mbresëlënëse?
- A mund të lidheni me disa prej tyre? Nëse po, kush dhe pse?
- Si do të silleshit nëse do të ishit vendosur në

të njëjtin pozicion si ky person?

- Cilat veprime janë ndërmarrë nga këta njerëz për paqen?
- Sa efektive ishin ato veprime?
- A mendoni se nëse këta njerëz do të kishin përdorur qasje të ndryshme (veprime të dhunshme) problemi do të ishte zgjidhur në mënyrë më efektive?
- Cilat nga veprimet/qasjet do të përdornit në komunitetin tuaj për promovimin e paqes?
- A duhet të jesh po aq i famshëm sa këta njerëz për të sjellë ndryshim?

Përfundoni duke theksuar se askush nga ne nuk duhet të jetë aq i famshëm sa njerëzit që marrin pjesë në shfaqje. Ne mund t’i përdorim ato si modele për të sjellë ndryshim në realitetet tona lokale. Ne mund të mësojmë prej tyre, të frymëzohemi prej tyre dhe të fillojmë nga pak. Çdo veprim, çdo hap për paqen ka rëndësi.



## SHTOJCA

### RASTI NR. 1: ALICE PAUL



Aktivistja **Alice Paul** ia kushtoi jetën punës së saj për të drejtat e grave dhe ishte një figurë kryesore në shtytjen për Amendamentin e 19-të.

Një udhëheqëse në luftën për të drejtat e grave për shtatëdhjetë vjet, Alice Paul mbrojti një fushatë jo të dhunshme të mosbindjes civile që përfshinte marshime në shkallë të gjerë në Uashington DC, piketime në Shtëpinë e Bardhë dhe greva urie në burg. Taktikat e saj rezultuan në miratimin e Amendamentit të Nëntëmbëdhjetë të Kushtetutës së SHBA në vitin 1920, duke iu dhënë grave të drejtën për të votuar. Menjëherë pas kësaj, ajo e ktheu vëmendjen e saj në promovimin e një ndryshimi të të drejtave të barabarta për të mbrojtur gratë nga diskriminimi. Ajo drejtoi Partinë Kombëtare të Grave për një gjysmë shekulli.

E lindur në Moorestown, Nju Xhersi në 1885, Paul ishte një pasardhës i William Penn, themeluesi kuaker i Pensilvanisë. Themeli i aktivizmit të saj ishte tradita kuaker e shërbimit publik dhe promovimit të barazisë gjinore. Me arsim të lartë, ajo

fitoi një BA në biologji, një MA në sociologji, një doktoraturë në ekonomi, dhe disa diploma në drejtësi. Ndërsa studionte dhe punonte në Angli, Paul u njoh me gratë aktiviste (“sufragiste”) dhe taktikat e tyre militante. Ajo u arrestua shtatë herë dhe u burgos tre herë, duke marrë pjesë në disa greva urie. Duke u kthyer në SHBA në vitin 1910, e dobësuar fizikisht, por e vendosur, ajo u bashkua me kolegen londineze Lucy Burns dhe së bashku ato filluan të drejtojnë kauzën e të drejtës së votës nën kujdesin e Shoqatës Kombëtare të Votimit të Gruas (SHKVG).

Në vitin 1913, grupi organizoi paradën më të madhe ndonjëherë në Uashington për të përkuar me inaugurimin e Presidentit Woodrow Wilson. Tetë mijë marshuan dhe gjysmë milioni e shikuan paradën, shumë shikues që ngacmonin pjesëmarrësit. Më vonë, Paul përdori mosveprimin e policisë për të mbrojtur marshuesit për të fituar simpatinë e publikut. Paul dhe Burns u ndanë nga SHKVG në 1914 kur organizata refuzoi të mbështeste një shtytje për një ndryshim kushtetues dhe formuan partinë e tyre më radikale (e cila u bë Partia Kombëtare e Gruas) për të mbrojtur të drejtën e grave. Në vitin 1917, ato u bënë protestueset e para që piketuan Shtëpinë e Bardhë dhe kaluan 18 muaj atje, duke shfaqur pankarta që pyesnin: “Z. President, sa kohë duhet të presin gratë për lirinë?”

Paul u arrestua në tetor 1917 dhe kaloi shtatë muaj të gjatë në burg, duke organizuar greva urie, duke duruar rrahje të

rënda së bashku me të tjerët. Ajo u ushqye me vezë të papërpunuara përmes një tubi ushqimi dhe u dërgua (“u vendos”) në izolim dhe në repartin psikiatrik. Mbulimi i shtypit çoi në një protestë publike dhe lirim të saj përfundimtar. Opinioni publik shpejt u hodh në favor të lëvizjes dhe, me mbështetjen e Presidentit Wilson, Kongresi ratifikoi Amendamentin e Nëntëmbëdhjetë të Kushtetutës së SHBA më 26 gusht 1920.

Alice shkroi amendamentin e parë për të drejtat e barabarta dhe në vitin 1923 u prezantua në Kongres. Është dashur të ndalojë diskriminimin në bazë të gjinisë. Amendamenti origjinal lexohej:

**Barazia e të Drejtave sipas ligjit nuk do të mohohet ose shkurtohet nga Shtetet e Bashkuara ose asnjë Shtet për shkak të gjinisë.”**

Amendamenti i të Drejtave të Barabarta

Paragrafi 1. Barazia e të Drejtave sipas ligjit nuk do të mohohet ose shkurtohet nga Shtetet e Bashkuara ose asnjë Shtet për shkak të gjinisë.

Paragrafi 2. Kongresi do të ketë fuqinë për të zbatuar, përmes legjislacionit përkatës, dispozitat e këtij neni.

Paragrafi 3. Ky amendament do të hyjë në fuqi dy vjet pas datës së ratifikimit.

Amendamenti nuk kaloi kurrë. Ne ende nuk kemi një Amendament për të Drejtat e Barabarta, por ai është prezantuar në çdo seancë të Kongresit që nga viti 1923. Alice Paul vazhdoi të punojë për barazinë ligjore për gratë deri në vdekjen e saj më 9 korrik 1977. Sot, është si koha kur gratë nuk kanë mundur të votojnë asnjëherë edhe pse kanë ekzistuar, duke iu falënderuar Alice Paul dhe miqve të saj.

Pas ratifikimit, Paul punoi për të miratuar një amendament për të drejtat e barabarta. Përpjekjet e saj për të futur gjuhën e të drejtave të grave në preambulën e Kombeve të Bashkuara rezultuan që shumë kombe në mbarë botën të miratonin një gjuhë për të drejta të barabarta që SHBA nuk e ka pranuar kurrë.

## CITATE TË ALICE PAUL:

*“Nuk do të ketë kurrë një rend të ri botëror derisa gratë të jenë pjesë e tij.”*

*“Unë kurrë nuk dyshova se të drejtat e barabarta ishte drejtimi i duhur. Shumica e reformave, shumica e problemeve janë të ndërlikuara. Por për mua nuk ka asgjë të komplikuar për barazinë e zakonshme.”*

*“Më ka ndodhur se thjesht nuk e shikoja se si mund të vazhdoja dhe të vazhdoja të haja mish. Thjesht më dukej kaq... kanibaliste. Dhe kështu, unë jam vegjetariane dhe që atëherë kam qenë.”*

*“Veprat, jo fjalët.”*

## Pyetje për t'i diskutuar:

1. Cila ishte sfida kryesore me të cilën ajo po përballlej?
2. Cili ishte konflikti kryesor që ajo duhej të zgjidhte?
3. Duke përdorur cilat qasje/metoda ajo u përpoq që të zgjidhte konfliktin?
4. Cilat janë aksionet kryesore të paqes që ajo bëri?



## RASTI NR. 2: MARTIN LUTHER KING JR.



Gjatë më pak se 13 viteve të udhëheqjes së **Dr. Martin Luther King Jr.** të Lëvizjes Moderne Amerikane për të Drejtat Civile, nga dhjetori 1955 deri më 4 prill 1968, afrikanë-amerikanët arritën më shumë përparim të vërtetë drejt barazisë racore në Amerikë se sa kishin prodhuar 350 vitet më përpara

Dr. King konsiderohet gjerësisht si avokati kryesor kundër dhunës në Amerikë dhe një nga udhëheqësit më të mëdhenj jo të dhunshëm në historinë botërore.

Në vitin 1955, ai u rekrutua për të shërbyer si zëdhënës i Bojkotit të Autobusëve në Montgomery, e cila ishte një fushatë nga popullsia afrikanë-amerikane e Montgomery, Alabama për të detyruar integrimin e linjave të autobusëve të qytetit. Pas 381 ditësh pjesëmarrjeje pothuajse universale nga qytetarët e komunitetit të zi, shumë prej të cilëve duhej të ecnin me kilometra për të shkuar në punë çdo ditë si rezultat, Gjykata e Lartë e SHBA vendosi se ndarja racore në transport ishte jo kushtetuese.

Në vitin 1957, Dr. King u zgjodh president i Konferencës së Udhëheqjes së Krishterë

Jugore (SCLC), një organizatë e krijuar për të ofruar udhëheqje të re për lëvizjen tani në zhvillim të të drejtave civile. Ai do të shërbente si kreu i SCLC deri në vrasjen e tij në 1968, periudhë gjatë së cilës ai do të dilte si udhëheqësi më i rëndësishëm social i lëvizjes moderne amerikane për të drejtat civile.

Në vitin 1963, ai drejtoi një koalicion të grupeve të shumta të të drejtave civile në një fushatë jo të dhunshme që synonte Birmingham, Alabamën, i cili në atë kohë përshkruhej si “qyteti më i veçuar në Amerikë”. Brutaliteti i mëvonshëm i policisë së qytetit, i ilustruar më qartë nga pamjet filmike televizive të të rinjve zezakë që sulmoheshin nga qentë dhe tubat e ujit, çoi në një zemërim kombëtar që rezultoi në një shtytje për legjislacion të paprecedentë për të drejtat civile. Ishte gjatë kësaj fushate që Dr. King hartoi “Letër nga një burg në Birmingham”, manifesti i filozofisë dhe taktikave të Dr. Kingut, i cili kërkohet të lexohet sot në shumë universitete në mbarë botën.

Më vonë në 1963, Dr. King ishte një nga forcat shtytëse pas Marshimit për Punë dhe Liri, i njohur më shpesh si “Marshimi në Uashington”, i cili tërhoqi mbi një çerek milion njerëz në Qendrën Kombëtare. Pikërisht në këtë marshim Dr. King mbajti fjalimin e tij të famshëm **“Unë kam një ëndërr”**, i cili forcoi statusin e tij si një udhëheqës i ndryshimeve shoqërore dhe ndihmoi në frymëzimin e kombit për të vepruar mbi të drejtat civile. Dr. King më vonë u emërua “Njeriu i Vitit” nga revista Time.

Në vitin 1964, në moshën 35-vjeçare, Martin Luther King, Jr. u bë personi më i ri që fitoi Çmimin Nobel për Paqen. Fjalimi i tij i pranimit në Oslo mendohet nga shumë të jetë ndër komentet më të fuqishme të mbajtura ndonjëherë në këtë ngjarje, duke kulmuar në një moment me frazën e cituar shpesh:

**Unë besoj se e vërteta e paarmatosur dhe dashuria e pa-kushtëzuar do të kenë fjalën e fundit në realitet. Kjo është arsyeja pse e drejta e mposhtur për-kohësisht është më e fortë se e keqja triumfuese”.**

Gjithashtu në vitin 1964, pjesërisht për shkak të Marshimit në Uashington, Kongresi miratoi Aktin historik për të Drejtat Civile, duke eliminuar në thelb ndarjen e legalizuar racore në Shtetet e Bashkuara. Legjislacioni e bëri të paligjshëm diskriminimin e njerëzve me ngjyrë ose pakicave të tjera në punësimin, strehimin publik, arsimin ose transportin, zona të cilat në atë kohë ishin ende shumë të ndara në shumë vende.

Vitin tjetër, 1965, Kongresi vazhdoi të miratojë Aktin e të Drejtave të Votimit, i cili ishte një grup ligjesh po aq të rëndësishme që eliminuan pengesat e mbetura për të votuar për afrikano-amerikanët, të cilët në disa zona ishin zhveshur pothuajse plotësisht nga e drejta. Ky legjislacion rezultoi drejtpërdrejt nga Selma në Montgomery, AL Marshimi për të Drejtat e Votimit të udhëhequr nga Dr. King.

Ndërmjet 1965 dhe 1968, Dr. King e zhvendosi fokusin e tij drejt drejtësisë ekonomike, të cilën ai e theksoi duke udhëhequr disa fushata në Çikago, Illinois dhe paqen ndërkombëtare, të cilën ai e mbrojti duke folur fuqishëm kundër Luftës së Vietnamit. Puna e tij në këto vite arriti kulmin me “Fushata e Popullit të Varfër”, e cila ishte një përpjekje e gjerë për të mbledhur një koalicion shumë racor të amerikanëve të varfër që do të avokonin për ndryshime ekonomike.

Më 4 prill 1968, ai u vra në Motelin Lorraine në Memphis, Tennessee. Trupi i Dr. King u kthye në qytetin e tij të lindjes, Atlanta, Xhorxhia, ku në ceremoninë e varrimit të tij morën pjesë udhëheqës të nivelit të lartë të të gjitha racave dhe vijave politike

## CITATE TË MARTIN LUTHER KING:

*“Pyetja më këmbëngulëse dhe urgjente e jetës është: ‘Çfarë po bëni ju për të tjerët?’”*

*“Përparimi njerëzor nuk është as automatik, as i pashmangshëm... Çdo hap drejt qëllimit të drejtësisë kërkon sakrificë, vuajtje dhe luftë; përpjekjet e palodhura dhe shqetësimi i pasionuar i individëve të përkushtuar.”*

*Dashuria është e vetmja forcë që mund ta shndërrojë një armik në mik.*


*Unë kam një ëndërr që katër fëmijët e mi të vegjël do të jetojnë një ditë në një komb ku nuk do të gjykojnë nga ngjyra e lëkurës së tyre, por nga përmbajtja e karakterit të tyre.*

### Pyetje për t'i diskutuar:

1. Cila ishte sfida kryesore me të cilën ai po përballlej?
2. Cili ishte konflikti kryesor që ai duhej të zgjidhte?
3. Duke përdorur cilat qasje/metoda ai u përpoq që të zgjidhte konfliktin?
4. Cilat janë aksionet kryesore të paqes që ai bëri?



## RASTI NR. 3: NELSON MANDELA



**Nelson Mandela** u bë presidenti i parë me ngjyrë i Afrikës së Jugut në 1994, duke shërbyer deri në vitin 1999. Një simbol i ndërtimit të paqes globale, ai fitoi Çmimin Nobel për Paqen në 1993.

Nelson Mandela lindi në Transkei, Afrika e Jugut më 18 korrik 1918. Ai ishte djali i një udhëheqësi fisnor lokal të fisit Tembu. Si i ri Nelson mori pjesë në aktivitetet dhe ceremonitë e fillimit të fisit të tij vendas. Sidoqoftë, ndryshe nga babai i tij Nelson Mandela fitoi një arsim të plotë, duke studiuar në Kolegjin Universitar të Fort Hare dhe gjithashtu në Universitetin e Witwatersrand. Nelson ishte një student i mirë dhe u diplomua me një diplomë juridike në 1942.

Gjatë kohës së tij në universitet, Nelson Mandela u bë gjithnjë e më i vetëdijshëm për pabarazinë racore dhe padrejtësinë me të cilën përballeshin njerëzit jo të bardhë. Në vitin 1943, ai vendosi të bashkohej me **Kongresin Kombëtar Afrikan (KKA)** dhe të merrte pjesë aktive në luftën kundër apartheidit.

Si një nga avokatët e paktë të kualifikuar, Nelson Mandela ishte shumë i kërkuar;

gjithashtu angazhimi i tij ndaj kauzës e bëri atë të promovuar në radhët e KKA. Në vitin 1956, Nelson Mandela dhe disa anëtarë të tjerë të KKA u arrestuan dhe u akuzuan për tradhti.

Pas një çështjeje të gjatë dhe të stërzgatur gjyqësore, të pandehurit u liruan përfundimisht në vitin 1961. Megjithatë, me KKA të ndaluar tani, Nelson Mandela sugjeroi një rezistencë aktive të armatosur ndaj regjimit të apartheidit. Kjo çoi në formimin e Umkhonto we Sizwe, e cila do të vepronte si një lëvizje rezistence guerile. Duke marrë trajnime në vende të tjera afrikane, Umkhonto we Sizwe mori pjesë në sabotim aktiv.

Në vitin 1963, Mandela u arrestua përsëri dhe u gjykua për tradhti. Këtë herë shteti ia doli të dënonte Mandelën për komplot për të rrëzuar qeverinë. Megjithatë, çështja mori vëmendje të konsiderueshme ndërkombëtare dhe regjimi i apartheidit në Afrikën e Jugut ra nën vrotimin e komunitetit ndërkombëtar. Në fund të gjyqit të tij, Nelson Mandela mbajti një fjalim të gjatë, në të cilin ai ishte në gjendje të pohonte përkushtimin e tij ndaj idealeve të demokracisë.

Dënimi me vdekje i Mandelës u ndryshua në burgim të përjetshëm dhe nga viti 1964-1981 ai u burgos në burgun Robben Island, jashtë Cape Town. Në burg kushtet ishin të rralla. Megjithatë, Mandela ishte me shumë të burgosur të tjerë politikë dhe ekzistonte një lidhje e fortë miqësie e cila ndihmoi që kushtet e vështira të burgut të bëhen më të durueshme. Gjithashtu, në burg Nelson Mandela ishte shumë i disiplinuar; ai përpi-



qej dhe studionte dhe merrte pjesë në stërvitje çdo ditë. Ai më vonë tha se këto vite burg ishin një periudhë e mësimi të madh, edhe pse të dhimbshme. Mandela gjithashtu krijoi miqësi me disa nga rojet. Mandela më vonë do të thoshte se ndjente se po luftonte kundër sistemit të aparteidit dhe jo të bardhëve individualë. Pikërisht në burg Mandela u bë i vetëdijshëm për pasionin që afrikanët kishin për Ragbin dhe ai zhvilloi një interes për të vetë.

Gjatë kohës së tij në burg, Mandela u bë gjithnjë e më i njohur në të gjithë botën. Mandela u bë udhëheqësi më i njohur i zi dhe opozitë e regjimit të aparteidit. Kryesisht i panjohur për Mandelën, burgimi i tij i vazhdueshëm çoi në presion në mbarë botën për lirinë e tij. Shumë vende zbatuan sanksione ndaj aparteidit në Afrikën e Jugut. Për shkak të presionit ndërkombëtar, nga mesi i viteve 1980, regjimi i aparteidit filloi gjithnjë e më shumë të negocionte me KKA dhe Nelson Mandelën në veçanti. Në

shumë raste, Mandelës iu ofrua një liri me kusht. Megjithatë, ai gjithmonë refuzoi të vinte lirinë e tij mbi idealet politike të KKA.

### Liria dhe një Komb i ri Ylber

Përfundimisht Nelson Mandela u lirua më 11 shkurt 1990. Dita ishte një ngjarje e madhe për Afrikën e Jugut dhe botën. Lirimi i tij simbolizon fundin e afërt të aparteidit. Pas lirimit të tij, pasuan negociata të zgjatura (shpesh të ndërthurura me dhunë fisnore) dhe në prill 1994, Afrika e Jugut pati zgjedhjet e para të plota dhe të drejta. KKA u zgjodh me 65% të votave, dhe Nelson Mandela u bë Presidenti i parë i Afrikës së Jugut të re.

Si President, ai u përpoq të shëronte përçarjet e së kaluarës. Pavarësisht se u keqtrajtua, ai ishte zemërgjerë në trajtimin e tij me ish-shtypësit e tij. Qëndrimi i tij falës dhe tolerant fitoi respektin e të gjithë kombit të Afrikës së Jugut dhe lehtësoi ndjeshëm tranzicionin drejt një demokracie të plotë.

## CITATE TË MANDELËS

*“Unë e urrej diskriminimin racor më intensivisht dhe në të gjitha manifestimet e tij. I kam luftuar të gjitha gjatë jetës sime; Unë e luftoj atë tani dhe do ta bëj këtë deri në fund të ditëve të mia.”*

*“Nëse ka ëndrra për një Afrikë të Jugut të bukur, ka edhe rrugë që të çojnë në qëllimin e tyre. Dy nga këto rrugë mund të quhen Mirësia dhe Falja.”*

*“Gjatë jetës sime i jam përkushtuar kësaj lufte të popullit afrikan. Unë kam luftuar kundër dominimit të bardhë dhe kam luftuar kundër dominimit të zi. Unë e kam çmuar idealin e një shoqërie demokratike dhe të lirë në të cilën të gjithë njerëzit jetojnë së bashku në harmoni dhe me mundësi të barabarta. Është një ideal për të cilin shpresoj të jetoj dhe ta arrij. Por nëse është e nevojshme, është një ideal për të cilin jam i përgatitur të vdes.”*

*“Ne besojmë se Afrika e Jugut i përket të gjithë njerëzve që jetojnë në të, dhe jo një grupi, qoftë ai i zi apo i bardhë. Ne nuk donim një luftë ndër racore dhe u përpoqëm ta shmangnim atë deri në minutën e fundit.”*

*“Unë mësova se guximi nuk ishte mungesa e frikës, por triumfi mbi të. Trim nuk është ai që nuk ndjen frikë, por ai që e mposht atë frikë.”*

### Pyetje për t'i diskutuar:

1. Cila ishte sfida kryesore me të cilën ai po përballlej?
2. Cili ishte konflikti kryesor që ai duhej të zgjidhte?
3. Duke përdorur cilat qasje/metoda ai u përpoq që të zgjidhte konfliktin?
4. Cilat janë aksionet kryesore të paqes që ai bëri?



## RASTI NR. 4: MALALA YOUSAFZAI



**Malala Yousafzai**, (lindur më 12 korrik 1997, Mingora, Lugina Swat, Pakistan) është një aktiviste pakistaneze e cila, kur ishte adoleshente, foli publikisht kundër ndalimit të arsimit të vajzave që ishte imponuar nga Tehrik-e-Taliban Pakistan (TTP nganjëherë i quajtur talebanët pakistanezë). Ajo fitoi vëmendjen globale kur i mbijetoi një atentati në moshën 15-vjeçare. Në vitin 2014, Yousafzai dhe Kailash Satyarthi u nderuan së bashku me Çmimin Nobel për Paqen në njohje të përpjekjeve të tyre në emër të të drejtave të fëmijëve.

Vajza e një aktivisti dhe edukatori të hapur shoqëror, Yousafzai ishte një studente e shkëlqyer. Babai i saj - i cili themeloi dhe administroi shkollën që ajo ndoqi, Shkollën e Mesme dhe Kolegjin e Vajzave Khushal në qytetin e Mingora - e inkurajoi atë të ndiqte rrugën e tij. Në vitin 2007, Lugina Swat, dikur destinacion pushimesh, u pushtua nga TTP. E udhëhequr nga Maulana Fazlullah, TTP filloi të impononte ligje të rrepta islame, duke shkatërruar ose mbyllur shkollat e vajzave, duke i ndaluar gratë nga çdo rol aktiv në shoqëri dhe duke kryer sulme vetëvrasëse. Yousafzai dhe familja e

saj u larguan nga rajoni për sigurinë e tyre, por ata u kthyen kur tensionet dhe dhuna u zbutën.

Më 1 shtator 2008, kur Yousafzai ishte 11 vjeç, babai i saj e çoi atë në një klub lokal shtypi në Peshawar për të protestuar kundër mbylljes së shkollës, dhe ajo mbajti fjalimin e saj të parë: “Si guxojnë talebanët të më heqin të drejtën bazë për arsim?” Fjalimi i saj u publikua në të gjithë Pakistanin. Nga fundi i vitit 2008, TTP njoftoi se të gjitha shkollat e vajzave në Swat do të mbylleshin më 15 janar 2009. Korporata Britanike e Transmetimeve (BBC) iu afrua babait të Yousafzait në kërkim të dikujt që mund të bënte një blog për ta për atë se si ishte për të jetuar nën sundimin e TTP. Me emrin Gul Makai, Yousafzai filloi të shkruante shënime të rregullta për BBC Urdu për jetën e saj të përditshme. Ajo shkroi nga janari deri në fillim të marsit të atij viti 35 hyrje që u përkthyen edhe në anglisht. Ndërkohë, TTP mbylli të gjitha shkollat e vajzave në Swat dhe hodhi në erë më shumë se 100 prej tyre.

Në shkurt 2009, Yousafzai bëri paraqitjen e saj të parë televizive, kur u intervistua nga gazetari pakistanez dhe drejtuesi i emisionit të bisedave Hamid Mir në emisionin e ngjarjeve aktuale në Pakistan Capital Talk. Në fund të shkurtit, TTP, duke iu përgjigjur një reagimi në rritje në të gjithë Pakistanin, ra dakord për një armëpushim, hoqi kufizimin ndaj vajzave dhe i lejoi ato të ndiqnin shkollën me kusht që të mbanin burka. Sidoqoftë, dhuna u ringjall vetëm

disa muaj më vonë, në maj, dhe familja Yousafzai u detyrua të kërkonte strehim jashtë Swat derisa ushtria pakistaneze ishte në gjendje të largonte TTP-në. Në fillim të vitit 2009, reporteri i The New York Times Në fillim të vitit 2009, reporteri i New York Times, Adam Ellick punoi me Yousafzai për të bërë një dokumentar, **Klasa e përjash-tuar**, një pjesë 13-minutëshe për mbylljen e shkollës. Ellick bëri një film të dytë me të, të titulluar **Odiseja e një nxënëseje**. New York Times i postoi të dy filmat në faqen e tyre të internetit në vitin 2009. Atë verë ajo u takua me të dërguarin special të SHBA-së për Afganistanin dhe Pakistanin, Richard Holbrooke, dhe i kërkoi atij të ndihmonte në përpjekjet e saj për të mbrojtur arsimimin e vajzave në Pakistan.

**Unë mendoj se të kuptosh që nuk je vetëm, se po qëndron me miliona motrat e tua në mbarë botën është jetësore.”**

Me paraqitjet e vazhdueshme televizive dhe mbulimin e Yousafzait në mediat lokale dhe ndërkombëtare, ishte bërë e qartë në dhjetor 2009 se ajo ishte blogerja e re e BBC-së. Pasi u bë i njohur identiteti i saj, ajo filloi të merrte njohje të gjerë për aktivizmin e saj. Në tetor 2011 ajo u nominua nga aktivisti për të drejtat e njeriut Desmond Tutu për Çmimin Ndërkombëtar të Paqes për Fëmijët. Në dhjetor të atij viti asaj iu dha Çmimi i parë Kombëtar i Paqes për Rininë e Pakistanit (më vonë u quajt Çmimi Kombëtar i Paqes Malala).

Më 9 tetor 2012, Yousafzai u qëllua në kokë nga një person i armatosur i TTP-së, ndërsa ajo ishte rrugës për në shtëpi nga shkolla. Fazlullah dhe TTP morën përgjegjësinë për atentatin ndaj saj. Ajo i mbijetoi sulmit dhe u dërgua nga Peshawar në

Birmingham, Angli, për operacion. Incidenti shkaktoi protesta dhe kauza e saj u mor në mbarë botën, përfshirë nga i dërguari i posaçëm i OKB-së për arsimin global, Gordon Brown, i cili paraqiti një peticion që bënte thirrje që të gjithë fëmijët në mbarë botën të kthehen në shkollë deri në vitin 2015. Ky peticion çoi në ratifikimin e projektligjit të parë të Pakistanit për të Drejtën për Arsimim. Në dhjetor 2012, presidenti pakistanez Asif Ali Zardari njoftoi nisjen e një fondi arsimor prej 10 milionë dollarësh për nder të Yousafzait. Pothuajse në të njëjtën kohë, Fondi Malala u krijua nga Vital Voices Global Partnership për të mbështetur arsimin për të gjitha vajzat në mbarë botën.

Yousafzai u shërua, duke qëndruar me familjen e saj në Birmingham, ku u kthye në studimet e saj dhe në aktivizim. Për herë të parë që nga pushkatimi, ajo u shfaq në publik më 12 korrik 2013, në ditëlindjen e saj të 16-të, dhe iu drejtua një auditori prej 500 vetash në Kombet e Bashkuara në New York City. Mes shumë çmimeve të saj, në vitin 2013 Yousafzai fitoi Çmimin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, që jepet çdo pesë vjet. Ajo u emërua një nga njerëzit më me ndikim të revistës Time në vitin 2013 dhe u shfaq në një nga shtatë kopertinat që u shtypën për atë numër. Me Christina Lamb (korrespondente e huaj për *The Sunday Times*), Yousafzai bashkë shkroi një shkrim kujtimesh, Unë jam Malala: Vajza që u ngrit për arsim dhe u qëllua nga talebanët (2013). Ajo shkroi gjithashtu librin me figura **Lapsi Magjik i Malalës** (2017), i cili bazohej në fëmijërinë e saj. Në vitin 2014 ajo u bë personi më i ri që fitoi Medaljen e Lirisë, dhënë nga Qendra Kombëtare e Kushtetutës në Filadelfia për figurat publike që përpicën për lirinë e njerëzve në të gjithë botën. E nominuar për Çmimin Nobel për Paqen në 2013, por e kaloi atë vit, Yousafzai në vitin 2014 fitoi

çmimin, duke u bërë laureatja më e re e Nobel.

Pas fitimit të çmimit Nobel, Yousafzai vazhdoi të ndiqte shkollën në Angli - ajo u diplomua në Universitetin e Oksfordit në vitin 2020 - ndërsa përdori profilin e saj të zgjeruar publik për të sjellë vëmendjen ndaj çështjeve të të drejtave të njeriut në

mbarë botën. Në korrik të vitit 2015, me mbështetjen e Fondit Malala, ajo hapi një shkollë vajzash në Liban për refugjatët nga Lufta Civile Siriane. Ajo diskutoi punën e saj me refugjatët si dhe zhvendosjen e saj në Ne jemi të Zhvendosur (2019).

## CITATE TË TË MALALËS

*“Ne e kuptojmë rëndësinë e zërit tonë vetëm kur na heshtin.”*

*“Një fëmijë, një mësues, një libër, një stilolaps mund të ndryshojnë botën.”*

*“Unë mendoj se të kuptosh që nuk je vetëm, se po qëndron me miliona motrat e tua në mbarë botën është jetësore.”*

*“Kur e gjithë bota hesht, edhe një zë bëhet i fuqishëm.”*


*“Arsimi është edukim. Duhet të mësojmë gjithçka dhe më pas të zgjedhim se cilën rrugë të ndjekim. Arsimi nuk është as lindor, as perëndimor, është njerëzor.”*

### Pyetje për t'i diskutuar:

1. Cila ishte sfida kryesore me të cilën ajo po përballej?
2. Cili ishte konflikti kryesor që ajo duhej të zgjidhte?
3. Duke përdorur cilat qasje/metoda ajo u përpoq që të zgjidhte konfliktin?
4. Cilat janë aksionet kryesore të paqes që ajo bëri?



## RASTI NR. 5: MOHANDAS KARAMCHAND 'MAHATMA' GANDHI



I lindur në vitin 1869, nga prindër hindu që jetonin në Gujarat, kur India mbahej ende me forcë në Perandorinë Britanike, Gandhi udhëhoqi luftën për pavarësi, duke mos u larguar kurrë nga besimi i tij i vendosur në protestën e pa dhunshme dhe tolerancën fetare, përkundër se u arrestua dhe u burgos në disa raste. Kur indianët vepruan dhunshëm kundër njëri-tjetrit, ose kundër Rajit britanik në pushtet, ai agjëroi derisa dhuna mbaroi. Ai udhëhoqi një marshim prej 241 mijesh nëpër Indi (Marshi i Kripës) në shenjë proteste kundër monopolit britanik në prodhimin e kripës. Ai kaloi në total 2338 ditë në burg në një jetë të përkushtuar pa u lodhur ndaj paqes.

Gandhi udhëtoi në Afrikën e Jugut në fillim të vitit 1893 për të praktikuar drejtësinë nën një kontratë njëvjeçare. Duke u vendosur në Natal, ai iu nënshtrua racizmit dhe ligjeve të Afrikës së Jugut që kufizonin të drejtat e punëtorëve indianë. Gandhi më vonë kujtoi një incident të tillë, në të cilin ai u hoq nga një ndarje hekurudhore e klasit të parë dhe u hodh nga një tren, si “momenti i tij i së vërtetës”. Që atëherë, ai vendosi të luftojë padrejtësinë dhe të mbrojtë të drejtat e tij si indian dhe burrë.

Kur kontrata fillestare e Gandit skadoi, ai vendosi spontanisht të qëndronte në Afrikën e Jugut dhe të niste një fushatë kundër legjislacionit që do t'i privonte indianët të drejtën e votës. Ai përpiloi peticione, organizoi takime me politikanë dhe u dërgoi letra gazetave. Ai formoi Kongresin Indian Natal (organizata e parë e përhershme politike që u përpoq të ruante dhe mbronte të drejtat e indianëve në Afrikën e Jugut) dhe tërhoqi vëmendjen ndërkombëtare për gjendjen e vështirë të indianëve në Afrikën e Jugut.

Në vitin 1906, qeveria e Transvaal-it më pas miratoi një ligj që e bënte të detyrueshme për indianët mbi tetë vjeç që të mbanin një leje me gjurmën e gishtit, ndërsa anëtarët e tjerë të popullsisë nuk kishin nevojë për këtë. Shumë afrikano-jugorë me origjinë indiane i panë këto libra si përfaqësuese të shtetësisë së tyre të klasit të dytë.

Gandhi organizoi fushatën e tij të parë të jo-dhunës (opo satyagraha) për të inkurajuar mosbindjen civile masive. Në një takim masiv ku morën pjesë më shumë se 3000 njerëz u vendos që asnjë indian nuk do të aplikonte për regjistrim dhe se përpjekjet për të zbatuar ligjin do të përballeshin me rezistencë pasive. Në një protestë jo të dhunshme në Afrikën e Jugut, Gandhi u kërkoi indianëve të tjerë që të digjin librat e tyre. Gandhi e vuri trupin e tij në linjë duke vazhduar t'i hidhte librat në zjarr, edhe pse u rrah pa kuptim nga policia. Pas shtatë vitesh proteste, Gandhi negocioi një

marrëveshje kompromisi me qeverinë e Afrikës së Jugut. Ishte një ngjarje prekëse dhe historikisht e rëndësishme, sepse ishte veprimi i parë jo i dhunshëm i Gandit. Gandi vazhdoi të zhvillonte një lëvizje jo të dhunshme që përfundimisht çliroi të gjithë Indinë nga sundimi britanik.

**Për mua, e vërteta është Zoti dhe nuk ka asnjë mënyrë për të gjetur të vërtetën përveç mënyrës së jo-dhunshme. Gandi këmbënguli që ju mund të aplikoni të njëjtat vlera morale në politikë, biznes ose industri si në jetën private. Ai tha: “Është krejtësisht e mundur që një individ të përvetësojë këtë mënyrë jetese pa pasur nevojë të presë që të tjerët ta bëjnë këtë.”**

Gandi është më i njohur për filozofinë e tij jo të dhunshme, ose satyagraha (sanskritisht: përkthyer lirshëm si “këmbëngulje për të vërtetën” (satya ‘e vërteta’; agraha ‘ngulmimi’) ose ‘forca e shpirtit’ ose ‘forca e së vërtetës’). Kjo është një filozofi dhe praktikë e veçantë brenda kategorisë më të gjerë të përgjithshme të njohur përgjithësisht si rezistencë jo e dhunshme ose rezistencë civile. Satyagraha nuk është thjesht një strategji për të kundërshtuar të keqen pa përdorur dhunën - është një mënyrë e tërë për të rindërtuar shoqërinë, duke përdorur dashurinë dhe duke u përpjekur për të vërtetën.

Satyagraha përdor rezistencën jo të dhunshme për ta bërë kundërshtarin të përballet me faktin e padrejtësisë ose shfrytëzimit. Sidoqoftë, ndërsa satyagraha (ata që praktikojnë filozofinë) përdorin metoda të ndryshme jo të dhunshme për

t’u përballur ose për të bindur një kundërshtar - metoda si ulje dhe ulje, greva, agjërime, demonstrata, bojkot, piketim dhe mosbashkëpunim (të gjitha që përdori Gandi) - ata gjithashtu duhet të bëjnë punë konstruktive për të përmirësuar situatën. Sa herë që Gandi niste një fushatë kundër disa padrejtësive, ai gjithashtu niste skema konstruktive për të përmirësuar kushtet.

Nehru, kryeministri i parë i Indisë së pavarur, e konsideroi Marshimin e Kripës Satyagraha si shenjën e lartë të lidhjes së tij me Gandin, dhe mendoi se rëndësia e tij e qëndrueshme ishte në ndryshimin e qëndrimeve të indianëve:

”Sigurisht që këto lëvizje ushtronin presion të jashtëzakonshëm mbi qeverinë britanike dhe tronditën makinerinë e qeverisë. Por rëndësia e vërtetë, për mendimin tim, qëndronte në efektin që ato patën tek njerëzit tanë, dhe veçanërisht tek masat e fshatit... Mosbashkëpunimi i tërhoqi zvarrë nga balta dhe u dha respekt për veten dhe mbështetje te vetja...Ata vepruan me kujdes dhe nuk iu nënshtruan aq lehtë shtypjes së padrejtë; këndvështrimi i tyre u zgjerua dhe filluan të mendojnë pak për Indinë në tërësi. ....Ishte një transformim i jashtëzakonshëm dhe Kongresi, nën udhëheqjen e Gandit, duhet të ketë meritën për të.”

Teoria Satyagraha ndikoi në luftën e Nelson Mandelës në Afrikën e Jugut nën aparteid, fushatat e Martin Luther King, Jr. gjatë lëvizjes për të drejtat civile në Shtetet e Bashkuara dhe shumë lëvizje të tjera për drejtësinë sociale dhe lëvizje të ngjashme.

Martin Luther King tha: “Sikurse shumica e njerëzve, unë kisha dëgjuar për Gandin, por nuk e kisha studiuar kurrë seriozisht. Ndërsa lexova, u magjepsa thellë nga fushatat e tij të rezistencës jo të dhunshme. Unë u preka veçanërisht nga Marshi i tij i Kripës drejt Detit dhe agjërimet e tij të shumta. I gjithë koncepti Satyagraha ishte

thellësisht domethënës për mua. Ndërsa u futa më thellë në filozofinë e Gandit, skepticizmi im në lidhje me fuqinë e dashurisë u zvogëluar gradualisht dhe arrita të shoh

për herë të parë fuqinë e saj në fushën e reformës shoqërore.”

## CITATE TË TË GANDHI:

*‘Për mua, e vërteta është Zoti dhe nuk ka asnjë mënyrë për të gjetur të vërtetën përveç mënyrës së jo-dhunshme. Gandhi këmbënguli që ju mund të aplikoni të njëjtat vlera morale në politikë, biznes ose industri si në jetën private. Ai tha: “Është krejtësisht e mundur që një individ të përvetësojë këtë mënyrë jetese pa pasur nevojë të presë që të tjerët ta bëjnë këtë.’*

*‘Kur unë dëshpërohem, kujtoj se gjatë gjithë historisë rruga e së vërtetës dhe e dashurisë ka fituar gjithmonë. Ka pasur tiranë dhe vrasës, dhe për një kohë ata mund të duken të pathyeshëm, por në fund ata gjithmonë bien. Mendoni për këtë. Gjithmonë.’*

*‘Nuk ka rrugë drejt paqes, paqja është rruga’.*

### Pyetje për t'i diskutuar:

1. Cila ishte sfida kryesore me të cilën ai po përballej?
2. Cili ishte konflikti kryesor që ai duhej të zgjidhte?
3. Duke përdorur cilat qasje/metoda ai u përpoq që të zgjidhte konfliktin?
4. Cilat janë aksionet kryesore të paqes që ai bëri?

## PUNËTORIA



## UNË SI NDËRTUES I PAQES

**Koha:** Deri në 1h e 30 min.

**Qëllimi:** Për të hulumtuar se cilat vlera, aftësi dhe kompetenca janë të

rëndësishme dhe/ose të nevojshme për të qenë një ndërtues paqeje; për të kuptuar më mirë se nuk na duhen të

gjitha, por çdo njohuri, vlerë dhe aftësi ka rëndësi.

**Materialet:** Letra dhe stilolapsa

## Përshkrimi i punëtorisë:

## HAPI 1

Tregojuni pjesëmarrësve se ky sesion synon të hulumtojë se cilat vlera, njohuri dhe aftësi na duhen për të qenë ndërtues i paqes.

## HAPI 2

Paraqitjani pjesëmarrësve një vizatim të vogël njerëzor, siç shpjegohet në figurën 4. Shpjegoni se njohuritë janë diçka për të cilën ne përdorim kokën,

aftësitë janë diçka që mund ta bëjmë me duart tona, ndërsa vlerat vijnë nga zemra jonë. Për të qenë ndërtues paqeje, duhet t'i përdorim të tre. Kjo duhet të zgjasë 10 minuta.



FIGURA NR. 4

ILUSTRIM I QENIES NJERËZORE DHE VLERAVE, AFTËSIVE DHE NJOHURIVE



**HAPI 3** Kërkojuni pjesëmarrësve të marrin 15 minuta vetë për të menduar se cilat vlera, aftësi dhe njohuri duhet të kenë si ndërtues paqej. Jepuni letra dhe stilolapsa, që të mund të vizatojnë njerëzit e tyre.

**HAPI 4** Pas reflektimit individual, ndani ata në grupe, deri në pesë persona për grup (përpiquni të keni të paktën 3 grupe, në varësi të madhësisë së të gjithë grupit). Kërkojuni atyre të ndajnë njerëzit e tyre me grupin. Pasi secili person në grup të ndajë, ata duhet të bëjnë një njeri të përbashkët me të gjitha njohuritë, aftësitë dhe vlerat. Ata kanë 30 minuta për këtë.

**HAPI 5** Kërkojuni të gjitha grupeve të kthehen së bashku, dhe kërkojuni të tregojnë njerëzit e tyre dhe pse i renditën ato karakteristika. Ato duhet të jenë të sakta dhe konkrete. Në varësi të numrit të grupeve, ata mund të kenë deri në 2 minuta për prezantim.

**HAPI 6** Informimi:  
- Sa e vështirë ishte për ju të vini në dukje tiparet e ndërtuesit të paqes?  
- Pse zgjodhët veçoritë e përmendura për ndërtuesin e paqes?  
- A mendoni se të gjitha këto karakteristika nevojiten për të qenë një ndërtues paqej?

**HAPI 7** Kërkojuni pjesëmarrësve të mendojnë se në cilat fusha duhet të punojnë më shumë për t'u bërë ndërtues të paqes. Për çfarë tjetër kanë nevojë? Jepuni atyre disa minuta për të menduar për këtë, më pas kërkojuni të gjithëve të ndajnë me grupin.

**HAPI 8** Përfundoni me mendimet se edhe pse ata mendojnë se ka ende gjëra që u duhen për të qenë ndërtues paqej, nuk ka nevojë të jesh një super person. Është më e rëndësishme të kemi vullnet për të sjellë ndryshime pozitive dhe paqe në komunitet.

## PRAKTIKAT E MIRA NGA NIVELI LOKAL

### 1. MBËSHTETJE PËR DREJTËSINË KALIMTARE

**Çfarë?** - "Mbështetje për Drejtësinë Kalimtare" - Mbështetje për Drejtësinë Kalimtare" - Ky program është dizajnuar për studentët që studiojnë në universitetet publike dhe private të Kosovës, e në veçanti për studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës. Në kuadër të programit, në çdo cikël të kursit (gjithsej 8 cikle) rreth 30 studentë marrin pjesë në ligjërata javore të mbajtura nga personeli i ftuar i fakultetit dhe folës të ftuar nga fusha përkatëse dhe diskutojnë tema që lidhen me Drejtësinë Kalimtare (DK) si koncepti, mekanizmat e DK-së, proceset e DK-së në Kosovë, ndërtimi i paqes, të drejtat e njeriut dhe më gjerë. Përveç ligjëratave, gjatë programit studentët angazhohen në kërkime individuale mbi temën për të cilën janë më të interesuar, kryejnë një praktikë 3-6 mujore në Qendrën Burimore të Drejtësisë Kalimtare (QBDK) ose partnerë të tjerë, gjithashtu në fund të kursit studentët marrin pjesë në një vizitë studimore në Beograd. Qëllimi kryesor i projektit "Mbështetje për drejtësinë kalimtare" është të kontribuojë në ndërtimin e paqes përmes ndërgjegjësimit për rëndësinë e edukimit për të drejtat e njeriut për ndërtimin e paqes dhe drejtësinë kalimtare. Disa nga historitë e suksesit të këtij projekti janë: Kursi fakultativ universitar për Drejtësinë Kalimtare i zhvilluar - është arritur që deri më tani janë organizuar 8 cikle të Kursit për Drejtësinë Kalimtare dhe Ndërtimin e Paqes, dhe më shumë se 300 studentë kanë ndjekur kursin, studentët ndërmorën kërkime individuale dhe grupore, dhe shumica e tyre morën pjesë në vizitën studimore në Beograd (para Pandemisë Covid 19-). Biblioteka e Qendrës Burimore për Drejtësinë Kalimtare është zgjeruar me 35 tituj

librash mbi drejtësinë kalimtare, ndërtimin e paqes dhe të drejtat e njeriut.

Biblioteka do të përmirësohet më tej me tituj të tjerë dhe donacione librash nga programi MA i OSHC-ve për Drejtësinë Kalimtare që është zhvilluar dhe është në proces akreditimi universitar. Gjithashtu, në kuadër të programit është organizuar edhe një vizitë shkëmbimi për profesorët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës në Qendrën për të Drejtat e Njeriut të Universitetit të Oslos. Qëllimi i vizitës studimore ishte hartimi i përbashkët i Programit të Studimit MA për "Ndërtimi i Paqes, të Drejtat e Njeriut dhe Drejtësia Kalimtare" dhe gjithashtu zgjerimi i mëtejshëm i mundësive të bashkëpunimit. Si rezultat, programet e lëndëve janë zhvilluar bashkërisht dhe është nënshkruar marrëveshja e shkëmbimit Erasmus +. Aplikacioni Erasmus+ Exchange ka rezultuar i suksesshëm (Universiteti i Oslos aplikoi në emër të Fakultetit Juridik, UP) dhe shkëmbimet e para të studentëve u bënë nga shtatori 2021, ku studentët e Fakultetit Juridik kaluan një semestër në Qendrën për të Drejtat e Njeriut të Universiteti i Oslos. Në vitin 2022, studentët dhe stafi nga UNi Oslo do të kalojnë deri në një semestër edhe në Fakultetin Juridik UP. Për studentët e Universitetit të Prishtinës organizohen edhe udhëtime studimore në Beograd, Serbi. Këto janë udhëtime studimore 3 ditore që u ofrojnë studentëve të Universitetit të Prishtinës një mundësi për të biseduar me historianë të shquar, OSHC, aktivistë (të gjithë nga Beogradi) për të dëgjuar më shumë rreth mekanizmave të drejtësisë kalimtare dhe ballafaqimit me të kaluarën.

**Nga kush?** Zbatuar bashkërisht nga Community Building Mitrovica dhe Universiteti i Prishtinës (UP).

## 2. NDËRTIMI I BESIMIT NË KOSOVË

**Çfarë? Ndërtimi i Besimit në Kosovë** është një projekt me objektivin e përgjithshëm për të ndërtuar një hapësirë virtuale me shumë qëllime, që lejon që diskutimet për zgjidhjet për procesin e ndërtimit të besimit të vazhdojnë më tej në Kosovë. Si një platformë online, ajo arkivon, promovon dhe mbështet diskutime dhe iniciativa mbi procese të ndryshme të ndërtimit të paqes.

**Nga kush?** Nisma e re Shoqërore është një nga zbatuesit, i cili përfshin një rrjet të individëve që punojnë në ndërtimin e besimit në Kosovë

## 3. NGJARJE TË TREGIMIT TË HISTORIVE

**Çfarë?** Ngjarje të tregimit të historive - Kalimi i urës në qytetin e ndarë të Mitrovicës shpesh perceptohet si i pazakontë dhe ndonjëherë edhe i rrezikshëm. Sidoqoftë, mundësitë për zhvillimin profesional të të rinjve nuk duhet domosdoshmërisht të kufizohen brenda komuniteteve të tyre. Për të promovuar shembuj të bashkëpunimit të suksesshëm, ekipi i RCT ka organizuar më shumë se 15 ngjarje tregimi të historive. Në këto ngjarje, dy qytetarë nga komunitete të ndryshme ndajnë historitë e miqësisë apo partneritetit të tyre që u mundësoi atyre të gjenin më shumë mundësi për zhvillim personal dhe financiar. Këto histori janë shumë frymëzuese për njerëzit e tjerë duke pasur parasysh se i ndriçon ata në mundësitë që nuk e dinin se i kishin. Të gjitha këto ngjarje patën një audiencë të drejtpërdrejtë dhe historia e tyre u shpërnda edhe në rrjetet sociale për ata që nuk mund t'i bashkoheshin audiencës së drejtpërdrejtë.

**Nga kush?** Community Building Mitrovica në kuadër të projektit të Pajtitimit dhe Transformimit të Konfliktëve.

## 4. PIKTURIMI I MURALEVE

**Çfarë?** Të premten e 10 dhjetorit, ekipi i RCT shënoi Ditën e të Drejtave të Njeriut duke pikturuar një mural në anën veriore të urës kryesore në Mitrovicë. Ky aktivitet mbledhi së bashku artistë nga komuniteti shqiptar dhe serb i Kosovës, të cilët dizajnuan dhe pikturuan një mural me mesazhe për domosdoshmërinë e bashkëpunimit dhe harmonisë ndëretnike në Kosovë. Të mbledhur në një rast kaq të rëndësishëm, ato shërbejnë si shembull i përsosur se çfarë mund të arrihet nëse njerëzit nga bashkësitë e ndryshme etnike janë të gatshëm të bashkëpunojnë dhe të krijojnë së bashku. Aktivitete të tilla si kjo ndihmojnë në përmirësimin e lidhjeve dhe nxitjen e proceseve të pajtimit dhe ndërtimit të paqes në një qytet të ndarë. Murali i bashkë-dizajnuar dhe pikturuar nga Gentian Murati, Stefan Milutinoviq dhe Milan Dobriq është një urë simbolike ndërmjet komuniteteve në Kosovë – një urë e ndërtuar nga bashkëpunimi, kreativiteti, artet, mesazhet pozitive dhe vlerat dhe besimet e përbashkëta në përpjekjet për ndërtimin e besimit. Kjo pjesë e veçantë e qytetit ku është krijuar murali është ende një "temë e nxehtë" për shkak të historisë së saj të konfliktit. Megjithatë, është e rëndësishme t'u tregohet njerëzve se është simbol i unitetit të qytetit të Mitrovicës dhe jo ndarje. Prandaj, ky kontribut mural, jo vetëm që do të shërbejë si një vepër e bukur arti, por edhe një vepër për t'u përdorur nga qytetarët që do të marrin foto me të, si simbol i paqes.

**Nga kush?** Community Building Mitrovica në kuadër të projektit të Pajtitimit dhe Transformimit të Konfliktëve.

## 2.3. KONFLIKTI DHE TRANSFORMIMI I KONFLIKTIT

Dilema kryesore në përkufizimin e konfliktit ka qenë gjithmonë pyetja: a është konflikti diçka pozitive apo negative? Përgjigja do të ishte neutrale. Natyra e konfliktit është në vetvete nervore. Në thelb, konflikti mund të përkufizohet si një kontradiktë qëllimesh. Nëse shkojmë më tej në teori, mund të konkludojmë se ka shumë përpjekje për të përkufizuar konfliktin. Për shembull, përkufizimi i Johan Galtung<sup>5</sup> bazohet në qëndrime, sjellje dhe kontradikta. Ai e përkufizon konfliktin si një proces dinamik në të cilin ata të tria janë vazhdimisht në ndryshim dhe kanë një ndikim mbi njëri-tjetrin.

Konflikti mund të perceptohet (interpretohet nga një person, ndërsa në të vërtetë nuk ekziston) ose aktual (ekzistues në fakt). Për më tepër, konflikti mund të jetë i brendshëm (ndodh brenda një personi - një personi ose aktori që ndjek dy qëllime të kundërta). Ky lloj konflikti mund të quhet edhe dilemë. Ose mund të jetë një konflikt i aktorëve të bashkëvepruar (për shembull midis grupeve të ndryshme të njerëzve - dy grupe të ndryshme njerëzish/individësh që synojnë të njëjtin qëllim), i njohur gjithashtu si mosmarrëveshje. Përfundimisht, konflikti është një pjesë integrale e jetës sonë në baza ditore (për shembull, kush do të marrë copën e fundit të tortës në tryezë) dhe ne duhet ta pranojmë dhe ta njohim atë, në vend që ta shmangim.

Sic u përmend më lart, natyra e konfliktit është neutrale, gjë që na bën të besojmë se ai mund të jetë edhe pozitiv edhe negativ. Konflikti pozitiv ndodh kur i bën njerëzit të kenë parasysh ide të ndryshme, të gjejnë alternativa dhe të kuptojnë këndvështrime të

ndryshme; i eliminon problemet. Konfliktet pozitive pasurojnë jetën tonë dhe na ndihmojnë të rritemi. Nga ana tjetër, konfliktet negative janë ato që përfshijnë çdo lloj dhune, siç janë konfliktet e hapura të armatosura (si ai që ndodhi në Kosovë në vitet 1998/99); ato konflikte çojnë në ngacmim, diskriminim, bullizim, ndarje dhe mund të kenë viktima vdekjeprurëse.

Përveç kësaj, ajo që është me të vërtetë e rëndësishme është se si e trajtojmë konfliktin. Konflikti mund të trajtohet ose me dhunë ose pa dhunë. Në mënyrë të dhunshme do të thotë që zgjidhja e konfliktit do të shkaktojë dëm të paktën në njërin anë të konfliktit (për shembull, trajtimi i konfliktit duke sjellë më shumë dhunë për ta ndaluar atë). Mënyra tjetër që shihet gjithashtu si një mënyrë paqësore e trajtimit të konfliktit është jo dhuna. Kjo nënkupton kërkimin e mjeteve paqësore për zgjidhjen e një konflikti (dialog, ndërmjetësim, mohim etj.).

Përfundimisht, është e rëndësishme të kuptojmë se kur ndodh konflikti, ne gjithmonë mund ta transformojmë atë në diçka që është e dobishme për ne dhe na ndihmon të përmirësohemi. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të kuptohet koncepti i transformimit të konfliktit. Transformimi i konfliktit nënkupton ndryshimin e narratives nga të kesh një fitues dhe humbës në një konflikt (situatë fituese-humbëse), në situatën ku të gjitha palët janë fituese dhe mund të përfitojnë nga konflikti (situatë fituese-fituese).

Ekzistojnë pesë qasje kryesore për trajtimin e konfliktit dhe përpjekjen për ta menaxhuar atë. Sipas Kenneth Thomas<sup>6</sup>, këto qasje janë: shmangia e konfliktit, konkurrenca, nënshtrimi (akomodimi), bashkëpunimi dhe kompromisi.

5 Për më shumë informata lexoni Johan Galtung, "Peace by Peaceful Means", 1996;

6 For more info, search for Kenneth Thomas Conflict Models, 1970;

## IDE PËR PUNËTORI

## PUNËTORIA



Përshtatur nga pakoja e instrumenteve “Të rinjtë që transformojnë konfliktin”

## HARTËZIMI I KONFLIKTEVE

**Koha:** Deri në 1h e 30 min.

**Grupi:** Fleksibil

**Qëllimi:** Për të kuptuar se ekzistojnë pjesë të ndryshme

të konflikteve, që ne të mund të dallojmë problemin kryesor, rrënjët (shkaqet) dhe pasojat (efektin); konflikti mund të

zgjidhet duke punuar dhe duke u fokusuar në rrënjët e tij.

**Materialet:** Letra, stilolapsa, letër grafike, shënues.

## Përshkrimi i punëtorisë:

**HAPI 1** Shpjegoni se ka shumë konflikte që ndodhin në jetën tonë. Me këtë aktivitet, ne do të përpiqemi të hartëzojmë konfliktet në jetën tonë dhe ato që na prekin më shumë.

**HAPI 2** Tregojuni pjesëmarrësve se për të hartëzuar më mirë konfliktet, ne do të përdorim Pemën e Konfliktit (në Shtojcë). Vizatoni Pemën e Konfliktit në tabelë dhe shpjegoni atyre se çfarë do të thotë secila pjesë. Rrënjët janë shkaktarë të konfliktit, trangu është problemi/konflikti kryesor, dhe degët janë efekte të konfliktit. Përdorni një shembull të konfliktit që ata ta kuptojnë më mirë. (Shembull: Problemi kryesor janë mbeturinat në lumin Ibër. Shkaqet kryesore janë mungesa e rregulloreve

institucionale për hedhjen e mbeturinave; mungesa e njohurive të njerëzve për ndotjen dhe mjedisin; zakonet për të hedhur mbeturina në natyrë; asnjë politikë zyrtare për mbrojtjen e mjedisit etj. Pasojat apo efektet e këtij problemi janë mungesa e ujit të pijshëm; ndotja e ajrit; nuk ka mundësi për të notuar në Ibër; efekte të këqija për qeniet e gjalla në ujë etj).

**HAPI 3** Kërkojuni atyre të mendojnë individualisht për një konflikt specifik dhe të përpiqen të gjejnë rrënjët, problemin(et) kryesorë dhe efektet. Jepuni atyre 15 minuta për këtë. Kërkojuni të përgjigjen 3 pyetjeve: 1. Cili është problemi kryesor? 2. Cilat janë shkaqet kryesore të këtij problemi? Dhe 3. Çfarë ndikimi ka në ju, familjen tuaj, komunitetin tuaj etj.?

**HAPI 4** Pasi të keni përfunduar pemët e tyre individuale, ndani pjesëmarrësit në grupe (në varësi të numrit të njerëzve, jo më pak se 3 persona për grup). Kërkojuni atyre që së pari të ndajnë pemët e tyre dhe më pas të përpiqen të bëjnë një pemë të përbashkët që do t'ia paraqesin të gjithë grupit. Jepuni atyre rreth 30 minuta për këtë, në varësi të grupeve të mëdha.

**HAPI 5** Pas përgatitjes së letrave grafike të përbashkëta, kërkojuni që të kthehen së bashku dhe të paraqesin letrat e tyre grafike. Mundohuni të gjeni pika të përbashkëta/ngjashmëri për të gjithë ata. Lejoni pyetje nga grupi ose ndërmjetësi pasi të ketë përfunduar çdo prezantim.

**HAPI 6**

Informimi:  
● Si e trajtuat këtë ushtrim? Pse ishte i vështirë/ i lehtë?

- Cila ishte sfida kryesore për ju personalisht?
- Cila paraqiti sfidën kryesore për ju si grup?
- Cilat çështje u shfaqën si më të rëndësishmet në analizën tuaj?
- Cilat çështje ndikuan më shumë në zhvillimin e strategjisë suaj?
- Në çfarë mënyrash janë të ndërlidhura analiza juaj dhe strategjia juaj?
- Në çfarë mënyrash strategjia juaj përpunet me

nevojat e identifikuara?

- A jeni i befasuar për rezultatet e analizës suaj? Çfarë zbuluat? Çfarë nuk e prisnit?

**HAPI 7**

Përfundoni pjesën me vërejtje se edhe pse kemi konflikte të ndryshme në jetën tonë, ndonjëherë konfliktet mund të kenë efekte dhe rrënjë të ngjashme. Është e rëndësishme që të konsiderohet se duke përdorur një pemë konflikti, jo vetëm që mund të shohim një pamje më të gjerë të një konflikti, por


gjithashtu mund të na ndihmojë ta zgjidhim atë duke u fokusuar në rrënjët. Nëse fokusohemi vetëm tek efektet, konflikti nuk do të zgjidhet. Kujtojeni atyre për shembullin tuaj; nëse fokusohemi në zgjidhjen e efekteve, për shembull pastrimi i lbrit pa i mësuar njerëzit pse është e rëndësishme të mos hedhim mbeturina në lum, nuk do të ketë tërheqje, pasi lbri do të jetë përsëri plot plehra.

**SHTOJCA****Pema e Konfliktit****Efektet**

çfarë impakti ka kjo tek ju, tek familja jote apo tek komuniteti

**Shkaqet**

cilat janë shkaqet kryesore të këtij konflikti?

**Problemi i kujdesit**

Çfarë është konflikti?

# PUNËTORIA



Përshtatur nga pakoja e instrumenteve “Të rinjtë që transformojnë konfliktin”

## SA AFËR KONFLIKTIT JAM UNË

**Koha:** Deri në 1h e 30 min.

**Grupi:** Fleksibil

**Qëllimi:** Për të kuptuar se ka

mënyra të ndryshme për t'u marrë me konfliktin dhe për të hulumtuar qasjet për të

menaxhuar konfliktet.

**Materialet:** Shirit, letra, shënues

### Përshkrimi i punëtorisë:

#### HAPI A

##### HAPI 1

Bëni kryqin në dysheme me shirit. Duhet të jetë në mes të dhomës, ku të gjithë mund ta shohin atë. Do ta përdorni në fund të ushtrimit, por më mirë ta përgatitni paraprakisht.

##### HAPI 2

Vendoseni veten (domethënë ju, facilituesi) në mes të kryqit. Shpjegojuni pjesëmarrësve se ju përfaqësoni konfliktin. Kërkojuni pjesëmarrësve të mendojnë se si lidhen me konfliktin dhe më pas të pozicionohen në raport me ju (duke përfaqësuar konfliktin), bazuar në mënyrën se si ata përgjithësisht i trajtojnë konfliktet. Ju mund t'u kërkonit atyre të mendojnë

se si reagojnë: a i afrohen, a ikin, a përballen me të apo e injorojnë, etj. Ku qëndrojnë kur përballen me konflikte? Pozicionimi duhet të kryhet në heshtje.

##### HAPI 3

Pasi të gjithë të vendosen në heshtje, kërkojuni pjesëmarrësve të shikojnë njëri-tjetrin dhe të mendojnë se çfarë nënkuptojnë pozicionet e ndryshme. Kërkojuni pjesëmarrësve të shpjegojnë. Duhet të jetë vullnetare, por nëse dikush ka një pozicion interesant (si shumë larg ose afër konfliktit) kërkojuni të shpjegojë.

##### HAPI 4

Pas ndarjes, kërkojuni pjesëmarrësve të pushojnë, të lënë pozicionet e tyre dhe të bëjnë përsëri

një rreth përreth jush (facilituesit).

##### HAPI 5

Tani, kërkojuni pjesëmarrësve të mendojnë se si ndihen kur një konflikt është zgjidhur ose transformuar dhe të marrin një pozicion të ri dhe të ndryshëm, këtë herë duke marrë parasysh se si reagojnë.

##### HAPI 6

Kërkoni sërish vullnetarë që të shpjegojnë pozicionet e tyre dhe pse qëndrojnë aty.

##### HAPI 7

Më pas kërkojuni të gjithëve të bëjnë një pamje mendore të asaj që kanë parë (d.m.th., të dy grupet e pozicioneve) dhe të ulen në dysheme në një rreth.

## HAPI 8

Informimi:

- Si u ndjetë duke bërë këtë ushtrim?
- Çfarë vutë re nga pozicionet e të tjerëve në raundin e parë? Ju ka habitur ndonjë gjë?
- Po në raundin e dytë? Çfarë ishte e rëndësishme?
- Çfarë lloj qasjesh ndaj konflikteve keni mundur të vëzhgoni, bazuar në pozicionet e ndryshme të marra në të dy raundet?
- A reflekton kjo ndonjë gjë për mënyrën se si ju ose të tjerët që njihni, reagoni në jetën e përditshme ndaj konflikteve që hasni?
- Çfarë mësuat nga ky ushtrim?
- Çfarë zbuluat për veten dhe qasjet që përdorni në një situatë konfliktit?

## HAPI 9

Kjo është pjesa ku ju do t'u shpjegoni pjesëmarrësve pesë qasje të ndryshme ndaj konfliktit

### Prezantimi i dyshemesë:

Kryqi është bërë në dysheme. Pjesëmarrësve u shpjegohet se nëse i tregojmë qëndrimet ndaj konfliktit përmes diagrameve, do të kemi 2 elementë: një vijë horizontale dhe vertikale. Me vijën horizontale të diagra-

mit tregojmë objektivat ose qëllimet më racionale nga konflikti, ndërsa me vijën vertikale tregojmë marrëdhënien, që do të thotë lidhje më emocionale me konfliktin.

Duke përdorur këtë kryq në dysheme, ju do t'u shpjegoni pjesëmarrësve qasje të ndryshme ndaj konfliktit. Mund të identifikojmë pesë qëndrime ndaj konfliktit. Nëse e konsiderojmë konfliktin si një cikël që mund të bëhet i dhunshëm nëse palët kundërshtarë nuk arrijnë një marrëveshje të arsyeshme, **inJORIMI I KONFLIKTIT** (ose mosbërja e përpjekjeve për ta zgjidhur atë) nuk është një qëndrim pozitiv. Qëndrimi njihet zakonisht si shmangie.

Vendos në dysheme një letër A4 me titull « **Shmangia** » -në pjesën e poshtme të majtë të diagramit.

Shmangia mund të lidhet me frikën ose apatinë: duke marrë parasysh konfliktet në nivel grupi, njerëzit mund t'i shmangin konfliktet nëse mendojnë se objektivat e tyre nuk janë aq të rëndësishme sa ia vlejnë përpjekjet e një konfrontimi përmes konfliktit. Shmangia në këtë diagram do të thotë se as marrëdhëniet dhe as objektivat nuk janë të rëndësishme për palët e konfliktit.

Pasi ta shpjegoni këtë, pyetni pjesëmarrësit nëse

kishte dikush që po shmangte konfliktin në ushtrimin që ata bënë më parë.

Kur njerëzit zgjedhin të merren me konfliktin, në vend që ta shmangin atë, ata shpesh adoptojnë një nga katër qëndrimet e tjera.

Konkurrenca është kur dëshira e njëres palë është të fitojë dhe nuk ka shqetësim nëse pala tjetër humbet. Një qëndrim konkurrues nuk synon të arrijë një marrëveshje të arsyeshme me palën tjetër, por përkundrazi të arrijë ekskluzivisht objektivat e veta. Shumë sporte dhe gara, dhe marrëdhëniet ndërmjet kompanive dhe partive politike për shembull, bazohen në parimin "Unë fitoj - ti humb". Letër A4 me titullin «**Konkurrenca**» në pjesën e poshtme djathtas të diagramit.

Paraqitja (akomodimi) i referohet një preference për të mbajtur një marrëdhënie të mirë me palën tjetër, në vend që të mbrojtë interesat e veta. Marrëdhëniet familjare ose miqësie janë ato ku paraqitja është e zakonshme. Paraqitja mund të shihet si e kundërta e konkurrencës. Vendosni letrën A4 me titullin «**Paraqitja**» në pjesën e sipërme të majtë të diagramit.

Bashkëpunimi është kur interesat dhe marrëdhëniet e të gjitha palëve të përfshira në një konflikt merren pa-



rasysh dhe shpesh respektohen. Vullneti për të ruajtur një marrëdhënie pozitive me palën tjetër nuk do të thotë domosdoshmërisht heqje dorë nga objektivat e dikujt (si në paraqitje); qëndrimi bashkëpunues synon t'i arrijë të dyja në të njëjtën kohë. Vendosni letrën A4 me titullin «**Bashkëpunimi**» në pjesën e sipërme djathtas të diagramit.

Kompromisi është qëndrimi i pestë i mundshëm. Duke qenë se arritja e bashkëpunimit të plotë është shumë e vështirë, të dyja palët mund të përpiqen të fitojnë ato që i konsiderojnë si më të rëndësishmet, megjithëse nuk mund të presin të arrijnë të gjitha objektivat e tyre. Vendosni letrën A4 me titullin «**Kompromisi**» në mes të diagramit në kryqin e dy rreshtave.

Shpjegojuni pjesëmarrësve se asnjë nga këto qëndrime nuk është në vetvete e keqe. Kur ka një konflikt, secila palë duhet të mendojë se deri në çfarë mase objektivat dhe marrëdhëniet e tyre janë të rëndësishme për ta, përpara se të përcaktojë se cili qëndrim do të jetë më i përshtatshëm për të miratuar. Megjithatë, kini parasysh se të qenit gjithmonë konkurrues ose gjithmonë i paraqitur mund të çojë në situata ose marrëdhënie të paqëndrueshme;

bashkëpunimi është më i qëndrueshëm në terma afatgjatë.

#### HAPI B

Nëse ka kohë, nuk është gjithmonë e nevojshme.

#### HAPI 1

Diagrami është në dysheme me shenjat e qasjeve të ndryshme ndaj konfliktit. Kërkojuni pjesëmarrësve të ngrihen dhe të vendosen pranë njëres prej qasjeve në përgjigje të deklaratave të lexuara nga facilituesi bazuar në sjelljen e tyre më të zakonshme në atë situatë të veçantë.

Pas leximit të çdo deklaratë, facilituesit përshkruajnë zgjedhjen duke pyetur:

*Përse e zgjodhët këtë përgjigje?*

*Cila do të ishte përgjigja më e mirë dhe si do të mund të arrihej?*

Avantazhet dhe disavantazhet e pozicionit

Deklaratat/Pyetjet:

1. Ju keni një diskutim në klasë. Dikush ka shprehur një mendim të diskutueshëm i cili është krejtësisht i ndryshëm nga i juaji
2. Ju jeni duke punuar në një projekt universitar së bashku me shokun tuaj. Ju dëshironi ta përfundoni sot, por shoku juaj do të shkojë në festë dhe ju

sugjeron të përfundoni projektin nesër.

3. Ju caktoni takimin me shokun tuaj. Ai/ajo sapo u nda me të dashurin/të dashurën e tij/saj dhe ka nevojë për mbështetjen tuaj. Por papritur prindërit tuaj ju thonë se duhet të merrni pjesë në darkën familjare pasi po vijnë disa nga të afërmit tuaj të largët. Sigurisht që gjithçka ndodh në të njëjtën kohë.
4. Disa nga miqtë tuaj në Facebook kanë postuar një vërejtje për një çështje politike të cilën ju e konsideroni krejtësisht të gabuar dhe ofenduese.
5. Po diskutoni për një çështje të nxehtë në afatin kohor të mikut tuaj të ngushtë në Facebook. Ai/ajo nuk pajtohet me ju, dhe i ka fshirë të gjitha komentet tuaja.

#### HAPI 2

Informimi: A ishte e lehtë/e vështirë për të marrë vendime?


Cilën nga strategjitë përdorni zakonisht në jetën tuaj?

A ka ndonjë që është më efektiv? Pse?



## SHTOJCA

### DIAGRAMI NË DYSHEME:



## PRAKTIKAT E MIRA NGA NIVELI LOKAL

### 1. RRETHI (RRATHËT) I KOHEZIONIT

**Çfarë?** Rrethi(et) e kohezionit janë një grup njerëzish me ndikim dhe me prejardhje të ndryshme në rajonin e Mitrovicës, regjionin e Prishtinës dhe rajonin e Gjilanit. Këto grupe janë krijuar nga ekipi i RCT me qëllim të identifikimit të nevojave të komuniteteve në këto rajone dhe gjithashtu identifikimin e metodave për të transformuar konfliktin ndërmjet komuniteteve dhe për të nxitur pajtimin. Përveç

tre grupeve të Rrethit të Kohezionit, Aktiviteti RCT planifikon të zgjerohet në më shumë rajone ku nevojiten këto grupe. Çdo rreth ka më shumë se 20 anëtarë dhe ata takohen herë pas here për të diskutuar situatën dhe aktivitetet e mundshme që mund të jenë të dobishme për transformimin dhe pajtimin e konfliktit.

**Nga kush?** Community Building Mitrovica në kuadër të Projektit të Pajtimin dhe Transformimit të Konflikteve

## 2.4. DHUNA

Dhuna mund të shpjegohet si çdo veprim i ndalimit të një qenieje tjetër të gjallë nga maksimizimi i potencialit të tyre të plotë. Për më tepër, dhuna është çdo qëndrim, sjellje ose çdo kontekst njerëzor që dëmton çdo

qenie të gjallë ose mjedis. Ekzistojnë tre lloje të ndryshme të dhunës: e drejtpërdrejtë, kulturore dhe strukturore. Për të kuptuar më mirë këto dallime, ne mund të përdorim një trekëndësh dhune (Figura Nr. 5) të zhvilluar nga Johan Galtung.

# DHUNA DIREKTE




FIGURA NR. 5  
TREKËNDËSHI I DHUNËS SË JOHAN GALTUNG

Siç mund të vërejmë në trekëndësh, ka dhunë të dukshme dhe të padukshme. Duke filluar nga e dukshme, i referohet dhunës së drejtpërdrejtë, dhunës që mund ta shohim. Zakonisht bëhet fjalë për dhunë fizike ose luftë. Dhuna e padukshme dallon dy forma: dhunën kulturore dhe strukturore. Dhuna kulturore është ajo e adoptuar në kulturën e shoqërisë, zakonisht bazohet në stereotipe dhe paragjykime që shoqëria ka ndaj një grupi njerëzish. Kjo dhunë përfshin përjashtimin e bazuar në identitetin njerëzor dhe provokon seksizëm, racizëm, etnocentrizëm, ksenofobinë, homofobinë etj. Dhuna strukturore do të thotë se dhuna është inkorporuar në strukturat e shoqërisë (si ligjet, institucionet publike dhe të ngjashme), do të thotë gjithashtu se

ka sisteme të padrejta politike, sociale dhe ekonomike në të cilat qytetarët trajtohen dhunshëm. E rëndësishme të mbahet mend është se edhe nëse këto dy forma të dhunës janë latente, nëse ato janë të pranishme në shoqëri për një kohë mjaft të gjatë, ato mund të ndikojnë njëra-tjetrën dhe të provokojnë jo vetëm dhunë më kulturore dhe strukturore, por edhe dhunë më të drejtpërdrejtë. Prandaj, ata mund të krijojnë një rreth vicioz të dhunës.

## IDE PËR PUNËTORI

# PUNËTORIA

## ZGJIDHJA E NJË SHTEGU TJETËR

**Koha:** Deri në 30 min

**Grupi:** Fleksibil

**Qëllimi:** Për të hulumtuar mënyra alternative të

trajtimit të dhunës; (Këto dy ushtrime mund të shërbejnë si energjizim përpara se të flisni dhe të hulumtoni dhunën).

**Materialet:** Balonës, kruese dhëmbësh, shirit letre.

### Përshkrimi i punëtorisë:

#### Punëtorja A: Kalo linjën

**HAPI 1** Bëni vijën e shiritit në dysheme dhe kërkojuni pjesëmarrësve të çiftohen në atë mënyrë që të ketë një person nga secila anë e rreshtit.

**HAPI 2** Tregojuni atyre se tani ata do të luajnë një lojë. Nëse e bëni partnerin tuaj nga ana tjetër e linjës të

kalorë në anën tuaj - do të merrni 1000 euro. Nëse partneri juaj ju bën të kaloni në anën tjetër - partneri merr 1000 euro.

**HAPI 3** Tregojuni atyre se i kanë 5 minuta për të diskutuar.

**HAPI 4** Shiko se kush i ka kaluar linjat dhe ka fituar 1000 euro.

**HAPI 5** Kërkojuni atyre të shpjegojnë se si arritën një marrëveshje apo jo, dhe çfarë po ndodhte.

**HAPI 6** Zakonisht, pjesëmarrësit besojnë se duhet të ketë një fitues, por në fakt, ata mund të fitojnë duke kaluar së bashku. Ka rrugë tjetër përveç dhunës.

## Punëtorja B: Balonat

### HAPI 1

Kërkojuni pjesëmarrësve të bëjnë dy rreshta, jo përballë njëra-tjetrës (shpinat janë kthyer nga njëri-tjetri). Një rresht i pjesëmarrësve merr balona. Kërkojuni atyre në heshtje të fryjnë balonat. Linja tjetër merr kruese dhëmbësh.

### HAPI 2

Kur të jenë gati, tregojuni se janë 3 rregulla që ata/ato duhet të zbatojnë:

- Mos lëndoni askënd;
- Mos shkatërroni asgjë në dhomë;
- Mbroni balonat.

### HAPI 3

Filloni! I keni 30 sekonda për të luajtur.

### HAPI 4

Informimi:

- Si ndiheni pas këtyre ushtrimeve?
- Sa balona kanë mbetur?
- Kush ndihet fitues dhe dikush ndihet sikur ka humbur diçka?
- A mund të kujtojnë, cilat ishin udhëzimet? Në balona? Në lojën e kalimit të linjës?
- Pse i shkatërruan balonat? Apo pse nuk e bënë?
- Sa e lehtë është për ne të përdorim dhunë?

- Cila ishte mënyra paqësore për të reaguar?
- A mund t'i lidhni këto ushtrime me jetën reale? Si?

### HAPI 5

Përfundoni se ndonjëherë ne përdorim fuqinë vetëm sepse na është dhënë, ose na mësojnë se duhet të sillemi dhunshëm. Dhuna është një konstrukt shoqëror, jo diçka e trashëguar tek ne. Prandaj, ne mund të përpiqemi të çmësojmë sjelljet e dhunshme dhe të përpiqemi të mësojmë të reja, paqësore.

# PUNËTORIA



Përshtatur nga pakoja e instrumenteve “Të rinjtë që transformojnë konfliktin”

## DHUNA NË JETËN TIME

**Koha:** Deri në 1h e 30 min.

**Grupi:** Fleksibil

**Qëllimi:** Për të hulumtuar përvojat e dhunës ndër personale.

**Materialet:** Letër grafike, shënues, hapësirë të përshtatshme për zhvillimin e një diskutimi në grup dhe për

ndarjen në grupe më të vogla sipas nevojës

### Përshkrimi i punëtorisë:

#### Punëtorja A: Kalo linjën

**HAPI 1** Shpjegojuni pjesëmarrësve se ky është një shans që ata të ndajnë mendimet dhe ndjenjat e tyre në lidhje me përvojat personale të dhunës ndër personale, si kur njerëzit ishin të dhunshëm ndaj tyre dhe kur ata ishin të dhunshëm ndaj të tjerëve.

**HAPI 2** Kryeni një stuhi të vogël idesh rreth asaj se çfarë do të thotë dhunë, ose si e përkufizojnë atë (nëse kjo është bërë më herët, kujtoni diskutimin). Pyetini ata për shembuj të dhunës së përditshme, si të qenit i goditur, ose goditja e dikujt, ose abuzimi verbal etj.

**HAPI 3** Kërkojini të gjithëve që të marrin individualisht pesë minuta për të menduar për një kohë kur: (a) dikush ka vepruar dhunshëm ndaj tyre; (b) kanë vepruar dhunshëm ndaj dikujt tjetër (c) ata panë dikë tjetër duke qenë i dhunshëm, por nuk ndërhyjnë.

**HAPI 4** Pas reflektimit të tyre, tregojuni pjesëmarrësve se ata do të punojnë në grupe të vogla, sipas rregullave të caktuara: se të gjithë duhet të trajtohen me respekt, se ajo që dikush thotë mbahet në mirëbesim, se askush nuk duhet të ndihet nën presion për të thënë diçka që i bën

ata të mos ndjehen rehat, dhe për të bërë pyetje për të kuptuar, jo për të gjykuar.

**HAPI 5** Ndajini ata/ato në grupe të vogla dhe jepini pyetje, në mënyrë që çdo person në grup t'u përgjigjet atyre dhe t'i ndajë me të tjerët.

- Pse ndodhi situata e dhunshme?
- Si do të ishin sjellë anëtarët e tjerë të grupit në rrethana të ngjashme?
- Pse u sollët ashtu siç u sollët?
- Si mund të ishte sjellë ndryshe?
- A ka ndonjë sugjerim pjesa tjetër e grupit?
- Çfarë mund të kishte bërë dikush për të parandaluar që incidenti të ndodhte?

- Në rastin e dhunës, pse ata/ato nuk ndërhyjnë?
- Cilat ishin shkaqet e incidentit?
- Sa incidente ishin rezultat i keqkuptimeve, sa ishin rezultat i hidhërimit, inatit ose xhelozisë, dhe sa ishin rezultat i dallimeve të kulturës dhe zakoneve, opinioneve ose besimeve?
- Çfarë kuptimi e kuptojnë njerëzit fjalën “tolerancë”? Si do ta përkufizonin?
- A është e drejtë që njerëzit të jenë plotësisht tolerantë ndaj çdo gjëje që bëjnë apo thonë njerëzit e tjerë?
- Pse toleranca është një vlerë kyçe për promovimin e të drejtave të njeriut?

## HAPI 6

Përfundoni me mendimet mbi tolerancën dhe pse është e rëndësishme të zbuloni më shumë për veprimet e jo dhunës dhe jo të dhunshme, por edhe për mbështetjen ndaj viktimave të dhunës.

## 2.5. PAJTIMI

Pajtimi si koncept ka përkufizime dhe interpretime të ndryshme. Është i pranishëm në fe dhe filozofi deri në shkencat politike dhe sociologjinë. Një nga studiuesit pionier në fushën e pajtimit, John Paul Lederach<sup>7</sup>, e ka përkufizuar pajtimin si një proces që përmban paqe, mëshirë, të vërtetë dhe drejtësi. Edhe pse pajtimi nuk mund të ndodhë pa këto katër koncepte, ai përsëri mund të ekzistojë në një nivel filozofik. Për ta kuptuar më mirë, veçanërisht përmes thjerrëzave të, për shembull, konfliktit etnik, është e rëndësishme të shpjegohet pajtimi përmes proceseve më të thjeshta. Prandaj, pajtimi është një proces i:

- Ndërtimit të marrëdhënies (eve);
- Njohjes së të kaluarës nga të gjitha palët e përfshira në konflikt;
- Ndarjes së përvojave gjatë konfliktit;
- Pranimit të dyanshëm të të gjitha anëve;
- Ndryshimit të perceptimit të “tjetrit”;
- Së ardhmes së përbashkët.<sup>8</sup>

Pajtimi shpesh lidhet me nivelin e lartë politik, por në fakt varet dhe është më i rëndësishmi për njerëzit që kanë vuajtur nga dhuna dhe konflikti i hapur i armatosur. Prandaj, pajtimi duhet të përfshijë në proceset e sipërpërmendura çdo individ që është prekur nga konflikti. Edhe pajtimi nis nga hapa të vegjël. Mund të fillojë thjeshtë duke pirë një kafe me fqinjin me të cilin keni pasur konflikt. Nuk ka nevojë për shumë më tepër se kaq për ta nisur. Kafeja dhe vullneti janë të mjaftueshme për të nisur një proces të madh dhe të komplikuar siç është pajtimi.

<sup>7</sup> Për më shumë informata, lexoni “Building Peace, Sustainable Reconciliation in Divided Societies”, John Paul Lederach, 1996

<sup>8</sup> Për më shumë informata, lexoni “The Influence of Dialogue Projects on The Reconciliation Process in Kosovo, The Case of The Youth Peace Camp,” Radosavljevic Nevena, 2018;



## IDE PËR PUNËTORI

## PUNËTORIA



## HULUMTIMI I PAJTIMIT

**Koha:** Deri në 1h e 30 min.

**Grupi:** Më shumë se 8;

**Qëllimi:** Për të kuptuar rëndësinë e proceseve të

ndryshme që mund të çojnë në pajtim; për të hulumtuar rëndësinë e çdo akti që mund të çojë në pajtim.

**Materialet:** Letra, stilolapsa, ngjyra fytyre, çdo material që mund të shërbejë për shprehje artistike.

## Përshkrimi i punëtorisë:

**HAPI 1** Shkëmbeni ide me pjesëmarrësit në lidhje me domethënien e pajtimit;

**HAPI 2** Shpjegojuni atyre se sipas John Paul Lederach, është një proces që përfshin paqen, drejtësinë, mëshirën dhe të vërtetën.;

**HAPI 3** Tani ndajini pjesëmarrësit në 4 grupe, secili grup merr një nga konceptet: Paqen, Drejtësinë, Mëshirën dhe të Vërtetën;

**HAPI 4** Shpjegojuni secilit grup se ata duhet të mendojnë për veten e tyre duke e përfaqësuar konceptin si personazhe të gjalla - persona ose

kafshë, me historinë e tyre personale, gjininë, moshën, zakonet, sjelljen, etj. Në të njëjtën kohë, kërkojini secilit grup të diskutojë pyetjet e mëposhtme në grupet e tyre: "Për çfarë shqetësohen ata në një situatë konflikti" dhe "Kujt i frikësohen më shumë në një situatë konflikti midis këtyre koncepteve". Tregojuni atyre se duhet të zgjedhin një person për të përfaqësuar konceptin në shfaqjen televizive pas prezantimit. Jepuni atyre rreth 30 minuta për këtë.

**HAPI 5** Ftoni të katër përfaqësuesit në shfaqje. Duhet të menaxhohet në atë mënyrë që të gjithë pjesëmarrësit e tjerë t'i shohin ato. Mirë se

vini të gjithë në shfaqje dhe përdorni pyetjet e mëposhtme:

- Prezantimi i të gjithë personazheve
- Kush është miku juaj më i ngushtë mes personazheve të tjerë dhe pse?
- Kush ju frikëson më shumë nga personazhet e tjerë në dhomë dhe pse?
- E vërteta, a je unik/e? Keni vëllezër e motra?
- E vërteta: pse je kaq e vështirë për t'u gjetur?
- Mëshirë, çfarë raporti keni me drejtësinë?
- Drejtësi, të gjithë pretendojnë se ju ndjekin dhe veprojnë në emrin tuaj, a është e vërtetë?
- Paqe, si ndihesh për këta 3 persona?
- Lëvizni fizikisht dhe riorganizoni uljen tuaj

- Çfarë keni nevojë nga njëri-tjetri?
- Ku mund të takoheni?  
Cila është pika juaj e takimit? Si mund ta quajmë atë pikë?

Në rast se nuk e arrijnë përfundimin, pyetni pjesëmarrësit nëse e dinë se ku mund të takohen këto personazhe. Përgjigja është PAJTIMI.

#### HAPI 6

Informimi:

1. Cilat janë përshlypjet tuaja për përvojën tuaj në këtë lojë?
2. Çfarë është pajtimi?
3. Si mund të ndihmojnë këto koncepte procesin e pajtimit?
4. A është i mundur pajtimi pa asnjë nga këta personazhe? A janë të gjithë në të njëjtin nivel rëndësie?
5. Si mundet takimi i këtyre të katërve të sjellë pajtim

në realitetet tuaja?

6. Si mund të na ndihmojnë këto koncepte për të pajtuar njerëzit në çdo konflikt?

#### HAPI 7

Shprehni mendimin se çdo veprim është i rëndësishëm që pajtimi të fillojë dhe të ndodhë. Ndani me ta disa nga mendimet nga pjesët teorike, veçanërisht se hapat e vegjël janë të rëndësishëm.

## PUNËTORIA



## DIALOGU

**Koha:** 3h (Nëse përfshihet filmi);

**Grupi:** Më shumë se 8;

**Qëllimi:** Për të ndarë përvojën personale nga lufta, kuptoni

se edhe të tjerët kanë vuajtur dhe se konfliktet e armatosura dhe dhuna nuk i sjellin asgjë të mirë askujt;

**Materialet:** Letra (ndoshta projektor dhe laptop)

## Përshkrimi i punëtorisë:

Kjo punëtori është delikate pasi mund të provokojë emocione të forta tek pjesëmarrësit. Ajo duhet të zbatohet pas disa ditësh, kur të ketë sigurinë se pjesëmarrësit po shkojnë mirë dhe ata janë të gatshëm të kalojnë këtë proces. Është e rëndësishme që facilituesit të ndjejë se grupi është i gatshëm dhe në kontroll mbi situatën. Për të rikujtuar luftën në Kosovë, ju mund të luani për pjesëmarrësit filmin “Ribashkimi – 10 vjet pas luftës”. Mund t’u japë atyre perspektivë.

**HAPI 1** Kërkojuni pjesëmarrësve të ulen në rreth në mënyrën më të rehatshme që mundën. Thuaju atyre se ky ushtrim kërkon që ne të ndajmë vuajtjet tona nga lufta, t’i pranojmë ato, por edhe të kuptojmë të tjerët, dhe se si lufta në Kosovë ka ndikuar tek të gjithë ne;

**HAPI 2** Tregojuni pjesëmarrësve se ka disa rregulla që duhen të ndiqen:

1. Dëgjo me mendje dhe zemër të hapur;
2. Dëgjo për të kuptuar, jo për t’u përgjigjur apo gjykuar;
3. Mos komentoni;
4. Bëni pyetje vetëm nëse diçka nuk është e qartë;
5. Ne nuk kemi të drejtë të gjykojmë përvojën e askujt, pasi ato janë individuale dhe unike.

**HAPI 3** Kërkojuni pjesëmarrësve të marrin pak kohë për të menduar rreth pyetjeve: Si ndikoi tek unë lufta në Kosovë? Drejtpërdrejtë; apo tërthorazi? Si ka ndikuar në familjen time? Si ndikon në mua tani?

**HAPI 4** Pas 5 minutash tregojuni se janë të ftuar të ndajnë mendimet, sa herë që janë gati. Kërkoni vullnetarë në vend që të thërrisni njerëzit. Tregojuni atyre se kjo është një hapësirë e sigurt dhe do të qëndrojë në këtë dhomë, por është e rëndësishme ta ndani pasi mund të na çojë përpara nga vuajtja dhe mund të na sjellë mirëkuptim.

**HAPI 5** Pasi të gjithë të ndajnë mendimet, thuaju se ne të

gjithë vuajmë në mënyrën tonë. Shumë gjëra që mund të jenë të dhimbshme për dikë, ndoshta për dikë tjetër nuk janë, dhe anasjelltas. Pas gjithë këtyre historive, e vetmja gjë që mund të konkludojmë është se kemi vuajtur si shoqëri dhe nuk e kemi kërkuar kurrë. E vetmja gjë që mund të bëjmë është të kemi empati me njëri-tjetrin dhe të hapemi për të kuptuar se të gjithë jemi viktima të asaj që na ndodhi.

**HAPI 6** Pyetni pjesëmarrësit nëse dëshirojnë të tregojnë se si ndihen pas kësaj. Pas përfundimit të këtij sesioni, është e rëndësishme t’u jepni atyre hapësirë për të bërë gjëra që janë relaksuese dhe jo intensive.

## PRAKTIKAT E MIRA NGA NIVELI LOKAL

### 1. DIALOGU I TË RINJVE TË KOSOVËS / PROGRAMI I SHKËMBIMIT TË RINISË (SEANCA PËR PAJTIM DHE VIZITA MEMORIALE)

**Çfarë?** Dialogu i të rinjve të Kosovës / programi i shkëmbimit të rinisë (seancat për pajtim) - Shpjegimi i shprehjes pajtim si një shprehje gjithëpërfshirëse, prejardhja e saj, dhe përdorimi i saj përmes qasjeve të ndryshme. Tregimi i qasjes nga poshtë-lart dhe nga lart-poshtë ndaj procesit të pajtimit dhe efekti i tij në nivelin ndër personal dhe ndëretnik. Për më tepër, ky aktivitet hulumtoi më shumë se si të rinjtë pjesëmarrës nga komuniteti shqiptar dhe serb e perceptojnë procesin e pajtimit. Përveç kësaj, në kuadër të këtij aktiviteti organizohen edhe vizita përkujtimore, ku pjesëmarrësit kanë mundësi të mësojnë, në shumë raste për herë të parë, për viktimat civile nga lufta në Kosovë.

**Nga kush?** Iniciativa e Rinisë për të Drejtat e Njeriut në Kosovë

### 2. PROGRAMI ACCESS PËR MIKRO BURSËN ANGLEZE

**Çfarë?** Programi i Access për mikro bursën angleze është një program i shkollës së gjuhës. Ky projekt ka filluar në vitin 2014 me qëllim të sjelljes së nxënësve nga të gjitha komunitetet, kryesisht shqiptarët e Kosovës dhe serbët e Kosovës në një klasë për të mësuar anglisht në mënyrë që ata të ndajnë përvojat e tyre me nxënës të tjerë nga komunitete të ndryshme në të cilat nuk kanë ndër vepruar më parë. Ajo që është dëshmuar si rezultati më i suksesshëm i këtij projekti deri më tani, janë kampet verore dhe në kuadër të këtij projekti janë organizuar dy kampe verore. Në kampet verore ne vërtet

shohim se studentët mund të respektojnë dhe të mos shohin dallime kur janë bashkë. Ata flasin për gjërat që i shqetësojnë dhe diskutojnë gjithashtu dallimet dhe frikën që kanë të dy komunitetet. Nxënësit e kuptojnë gjithmonë se janë të ngjashëm kur krahasojnë dhe ballafaqojnë çështje të ndryshme. Është kampi veror që i bën ata të kërcejnë në vallëzimin tradicional të të dy komuniteteve dhe ku mësojnë për festat dhe festimet e njëri-tjetrit. Është gjithashtu kampi veror për të përjetuar situata të paparashikuara. Sidoqoftë, ka të gjitha këto lloje të ndryshme historish që ne mund t'i ndajmë nga përvoja jonë me studentët e Access gjatë viteve. Pas një ngjarjeje fatkeqe me një nga studentët shqiptarë që rrëshqiti nga mali shkëmbor dhe u plagos, studentët nga të gjitha komunitetet u organizuan dhe ndihmuan shokun e tyre të dilte në vend të sigurtë, dhe më pas e dërguan në spital. Pas kampeve verore, studentët nga Mitrovica Jugore ishin mjaft komod dhe donin të shkonin në Mitrovicën e Veriut, në pjesën e qytetit të tyre që nuk e kanë vizituar kurrë më parë.

**Nga kush?** Zbatuar nga Community Building Mitrovica me mbështetje të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Prishtinë.

## 2.6. TË DREJTAT E NJERIUT

Të drejtat e njeriut përfaqësojnë nevojat themelore të çdo qenie njerëzore, ato sigurojnë jetë me dinjitet dhe respekt, dhe të gjithë kanë të drejtë për to, që do të thotë se të drejtat e njeriut janë të barabarta për të gjithë (të gjithë njerëzit janë të barabartë në të drejtat e njeriut). Prandaj, dinjiteti njerëzor dhe barazia janë dy vlerat bërthamë të të drejtave të njeriut.

### Të drejtat e njeriut janë:

**1. Të patjetërsueshme** – Ato nuk mund të na merren, ose nuk mund t'i humbim. Ato mund vetëm të kufizohen, për shembull marrja e lirisë së dikujt kur ai kryen një krim.

**2. Të ndërruarura** – Të drejtat e njeriut varen nga njëra-tjetra; ato janë të lidhura dhe nuk mund të vëzhgohen veçmas. Të kesh një të drejtë njerëzore, do të thotë t'i kesh të gjitha. Nuk ka hierarki në rëndësinë e tyre.

**3. Universale** – Ato kanë të bëjnë me të gjithë njerëzit në botë. Të gjithë kanë të drejtë për to, pavarësisht nga gjinia, orientimi seksual, raca, feja, përkatësia etnike, kombësia, aftësia e kufizuar, gjuha, statusi shoqëror, etj.

Të drejtat e njeriut mbrohen me ligje të ndryshme në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe kombëtar. Dokumenti më i rëndësishëm për kontinentin evropian është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Është nënshkruar në vitin 1950 dhe është verifikuar në vitin 1953. Sipas kësaj Konvente, drejtat kryesore dhe liritë janë:

1. Neni 1 - Detyrimi për respektimin e të drejtave të njeriut;
2. Neni 2 - E drejta e jetës;
3. Neni 3 - Ndalimi i torturës;

4. Neni 4 - Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar;
5. Neni 5 - E drejta për liri dhe siguri;
6. Neni 6 - E drejta për gjykim të drejtë;
7. Neni 7 - Nuk ka dënim pa ligj;
8. Neni 8 - E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare;
9. Neni 9 - Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë;
10. Neni 10 - Liria e shprehjes;
11. Neni 11 - Liria e tubimit dhe e organizimit;
12. Neni 12 - E drejta për martesë;
13. Neni 13 - E drejta për mjet efektiv juridik;
14. Neni 14 - Ndalimi i diskriminimit;
15. Neni 15 - Shmangia në kohë emergjente;
16. Neni 16 - Kufizimet e veprimtarisë politike të të huajve;
17. Neni 17 - Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave;
18. Neni 18 - Kufizimi i përdorimit të kufizimeve të të drejtave.

## IDE PËR PUNËTORI

# PUNËTORIA



Përshtatur nga Compass: Doracak për Edukimin për të Drejtat e Njeriut me të Rinjtë

## Titulli

**Koha:** Deri në 1h e 30 min.

**Grupi:** Fleksibil;

**Qëllimi:** Për të hulumtuar devijimet e së drejtës për barazi

në nivel lokal, për të diskutuar shkeljet e të drejtave të njeriut dhe për të kuptuar më mirë qëndrimet e njerëzve të tjerë.

**Materialet:** Role të shtypura, një dhomë mjaft e madhe për të lëvizur.

### Përshkrimi i punëtorisë:

#### HAPI 1

Shtypni të gjitha rolet (në shtojcë) dhe përzieni ato. Vendosini ato në një vend së bashku, dhe më pas kërkojini çdo pjesëmarrësi të marrë një kartë me role.

#### HAPI 2

Ftojini ata të ulen, të lexojnë me kujdes rolin dhe të mendojnë për pozicionin e këtij personi;

#### HAPI 3

Tani kërkojuni atyre të fillojnë të hyjnë në rol. Për të ndihmuar, lexoni disa nga pyetjet e mëposhtme, duke ndaluar pas secilës, për t'u dhënë njerëzve kohë të reflektojnë dhe të ndërtojnë një pamje të vetes dhe të jetës së tyre:

- Si ka qenë fëmijëria juaj?
- Në çfarë lloj shtëpie keni jetuar?

- Çfarë lloj lojërash keni luajtur?
- Çfarë lloj pune bënin prindërit tuaj?
- Si është përditshmëria juaj tani?
- Ku shoqëroheni?
- Çfarë bëni në mëngjes, pasdite, në mbrëmje?
- Çfarë lloj jetese keni?
- Ku jeton?
- Sa para fitoni çdo muaj?
- Çfarë bëni në kohën tuaj të lirë?
- Çfarë bëni gjatë pushimeve tuaja?
- Çfarë ju emocionon dhe nga çfarë keni frikë?

#### HAPI 4

Tani kërkojuni atyre të bëjnë një vijë të drejtë në një rën anë të dhomës. Tregojuni pjesëmarrësve se do të lexoni një listë situatash ose ngjarjesh. Sa herë që mund t'i përgjigjen "po"

deklaratës, ata duhet të bëjnë një hap përpara. Përndryshe, ata duhet të qëndrojnë aty ku janë dhe të mos lëvizin.

#### HAPI 5

Lexoni situatat (në shtojcë) një nga një. Pushoni për një kohë midis çdo deklarate për t'u dhënë njerëzve kohë për të ecur përpara dhe për të parë përreth për të mbajtur shënime pozicionet e tyre në lidhje me njëri-tjetrin.

#### HAPI 6

Në fund ftoni të gjithë të marrin parasysh qëndrimet e tyre përfundimtare. Më pas jepni atyre disa minuta që të dalin nga roli përpara se të diskutojnë si grup.

**HAPI 7**

**Informimi:**  
Filloni duke pyetur pjesëmar-rësit se çfarë ndodhi dhe si ndihen ata për aktivitetin, dhe më pas vazhdoni të flisni për çështjet e ngritura dhe atë që ata mësuan.

1. Si u ndjenë njerëzit duke bërë një hap përpara - apo jo?
2. Për ata që dilnin përpara shpesh, në cilën pikë filluan të vinin re se të tjerët nuk po lëviznin aq

shpejt sa ata?

3. A ka ndier dikush se ka pasur momente kur të drejtat e tyre themelore të njeriut janë injoruar?
4. A mund t'i hamendësojnë njerëzit rolet e njëri-tjetrit? (Lëri njerëzit të zbulojnë rolet e tyre gjatë kësaj pjese të diskutimit)
5. Sa e lehtë apo e vështirë ishte të luash rolet e ndryshme? Si e imagjinonin ata se si ishte personi

që po luanin?

6. A e pasqyron ushtrimi shoqërinë në një farë mënyre? Si?
7. Cilat të drejta të njeriut janë në rrezik për secilin prej roleve? A mund të thotë dikush se të drejtat e tyre njerëzore nuk po respektoheshin ose se nuk kishin qasje në to?
8. Çfarë hapash të parë mund të ndërmerren për të adresuar pabarazitë në shoqëri?



## SHTOJCA 1

### ROLET

- 1 Jeni një vajzë e re rome që nuk e keni mbaruar kurrë shkollën fillore;
- 2 Ju jeni një 30 vjeçar, pa diplomë universitare;
- 3 Ju jeni një 22 vjeçare lezbike;
- 4 Jeni serb që jetoni në një fshat në jug të Kosovës dhe nuk flisni shqip;
- 5 Jeni djali i ambasadorit amerikan në Kosovë;
- 6 Ju jeni një refugjat 24-vjeçar nga Afganistani;
- 7 Ju jeni djali 19-vjeçar i një fermeri në një fshat të largët në mal;
- 8 Ju jeni një djalë 25 vjeç me diplomë Bachelor në art;
- 9 Jeni anëtar i një partie politike në pushtet me pozicione të larta;
- 10 Jeni një i ri me aftësi të kufizuara që mund të lëvizni vetëm me karrocë;
- 11 Ju jeni vajza e menaxherit të bankës lokale. Ju studioni ekonominë në universitet;
- 12 Jeni një nënë beqare e papunë;
- 13 Ju jeni punëtor i pensionuar nga Trepça;
- 14 Jeni një e re që jeton në Mitrovicë, duke luftuar për të drejtat e grave;
- 15 Jeni një i/e papunë i/e diplomuar në universitet që pret mundësinë e parë për të punuar;

- 16 Ju jeni mësues serb me banim në Mitrovicë;
- 17 Je veteran i luftës i pastrehë;
- 18 Ju jeni e dashura e një artisti të ri që është i varur nga heroina;
- 19 Jeni emigrant ilegal nga Siria;
- 20 Ju jeni pronar i një kompanie të suksesshme import-eksporti.



## SHTOJCA 2 SITUATAT

- Nuk keni hasur kurrë ndonjë vështirësi serioze financiare.
- Keni strehim të mirë me telefon dhe televizor.
- Ju ndjeni se gjuha, feja dhe kultura juaj respektohen në shoqërinë ku jetoni.
- Ju mendoni se mendimi juaj për çështjet shoqërore dhe politike ka rëndësi dhe se pikëpamjet tuaja dëgjohen.
- Njerëz të tjerë ju këshillojnë për çështje të ndryshme.
- Nuk keni frikë se mos ju ndalon policia.
- Ju e dini se ku të drejtoheni për këshilla dhe ndihmë nëse keni nevojë për të.
- Nuk jeni ndjerë kurrë i diskriminuar për shkak të origjinës suaj.
- Ju keni mbrojtjen e duhur shoqërore dhe mjekësore për nevojat tuaja.
- Mund të shkoni për pushime një herë në vit.
- Mund të ftoni miqtë për darkë në shtëpi.
- Keni një jetë interesante dhe jeni pozitiv për të ardhmen tuaj.
- Ju mendoni se mund të studioni dhe të ndiqni profesionin që keni zgjedhur.
- Nuk keni frikë se mos ju ngacmojnë apo sulmojnë -në rrugë apo në media.
- Ju mund të votoni në zgjedhjet kombëtare dhe lokale.
- Festat më të rëndësishme fetare mund t'i festoni me të afërmit dhe miqtë tuaj të ngushtë.
- Mund të merrni pjesë në një seminar ndërkombëtar jashtë vendit.
- Mund të shkoni në kinema ose teatër të paktën një herë në javë.
- Nuk keni frikë për të ardhmen e fëmijëve tuaj.
- Mund të blini rroba të reja të paktën një herë në tre muaj.
- Mund të bini në dashuri me personin që keni zgjedhur.
- Ju mendoni se kompetenca juaj vlerësohet dhe respektohet në shoqërinë ku jetoni.
- Mund të përdorni dhe të përfitoni nga interneti.
- Nuk keni frikë nga pasojat e ndryshimeve klimatike.
- Jeni të lirë të përdorni çdo faqe në internet pa frikë nga censurimi.



# PUNËTORIA



Përshtatur nga Compass: Doracak për Edukimin për të Drejtat e Njeriut me të Rinjtë

## Titulli

**Koha:** Deri në 1h e 30 min.

**Grupi:** Fleksibil;

**Qëllimi:** Rritja e njohurive për mbrojtës të ndryshëm të të

drejtave të njeriut në botë; motivimi i pjesëmarrësve që të ndër marrin veprime për të drejtat e njeriut.

**Materialet:** Një komplet prej 30 letrash për grup të vogël; gërshërë; zarfet

### Përshkrimi i punëtorisë:

**HAPI 1** Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla (3-4 persona). Jepni një grup kartash (në shtojcë) secilit grup.

**HAPI 2** Kërkojuni atyre të shpërndajnë kartat, me fytyrë poshtë në dysheme.

**HAPI 3** Shpjegoni se kartat përshkruajnë ngjarje në jetën e gjashtë aktivistëve të të drejtave të njeriut. Qëllimi për secilin grup është që të përputhen ngjarjet me karakterin e duhur, dhe në këtë mënyrë të ndërtohet një përshkrim i shkurtër i secilit person.

**HAPI 4** Shpjegoni se secili nga personazhet përbëhet nga një “grup prej pesë” (për shembull një “A”, një “B”, një “C”, një “D” dhe një “E”);

**HAPI 5** Tregoni secilit grup të bëjë raunde të marrjes së një karte në të njëjtën kohë, derisa kartat të mbarojnë;

**HAPI 6** Pas kësaj, tregoni atyre se kanë 30 minuta për të punuar me të dhe për të gjetur strategjinë e tyre për të lidhur kartat;

**HAPI 7** Mblidhni të gjithë së bashku dhe kërkoni nga një përfaqësues nga një grup të prezantojë, me fjalët e tyre, një nga personalitetet. Pastaj përsëriteni me grupet e tjera me radhë, kështu që secili personalitet të paraqitet i plotë, dhe secili grup mund të kontrollojë nëse e kanë bashkuar saktë kartën. Ju mund të keni përgjigjet e duhura për veten tuaj, në rast se ata e kërkojnë atë.

**HAPI 8** Informimi:  
1. Sa i lehtë ishte ushtrimi dhe cilat

strategji përdorën grupet e ndryshme për të renditur grupet e kartave?  
2. Për cilin nga personazhet njerëzit kishin dëgjuar tashmë dhe cilët prej tyre ishin të rinj? Pse mendojnë se nuk kishin dëgjuar më parë për disa nga personalitetet, ndërsa të tjerët janë shumë të njohur?  
3. A u befaskan njerëzit nga ndonjë informatë? Çfarë iu duk më tronditëse, apo më mbresëlënëse?  
4. Kërkojuni njerëzve të zgjedhin citimin me të cilin identifikohen më së fuqishmi: si mendojnë ata se do të ishin sjellë nëse do të ishin vënë në të njëjtin pozicion si ky person?  
5. Cilat të drejta të njeriut në veçanti pretendonin “luftëtarët” e ndryshëm?  
6. A është “heroizmi” një veprim i papërshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut? Çfarë veprimesh janë në dispozicion të njerëzve që janë viktimat të shkeljeve të të drejtave të njeriut?



## SHTOJCA



A

**Shpesh e ndjej te qaj por nuk e shprehi dhe e mbajë në vete. I gëlltiti ndjenjat e mija”. Kur ëndëroj, ëndëroj që jam kthyer Auschwitz.”**

Zill Schmidt

B

Lindur me 1924 në Turingen, Gjermani, në një familje performuese që udhëtonte, ajo ka vendosur që ta ndajë historinë e saj me të gjithë.

C

“Tek njerëzit Roman nga regjimi nazist. Në 1939, Zili ishte arrestuar në Strasbourg. “ Krimi: Cigan” lexoi policia. Ai/ajo është dërguar në kampin Leti qe tash është republika Ceke, por menaxhoi që të arratisëj. Ai/ajo u ri-arrestua pak më vonë. Në Mars të vitit 1943 ajo u dërgua..”

D

Për Auschwitz-Birkenau. Në kampin për familjarë ciganë përditshmëria kishte vdekje, dhunë, sëmundje, uri, etje. Duke rrezikuar jetën e saj/tij ajo vidhte ushqim dhe rroba për fëmijët e të rritur që t’iu ndihmonte të mbetnin gjallë. Dy herë emri i saj/tij ishte në listën për dhomën e gazit. E gjithë familje e tij/saj ishte mbytur nga nazistët në dhomat e gazit.



A

**Alas, mendjen me këtë këngë e kam tek të burgosurit dhe ata qe i ndihmojnë atyre. Ndjenjat me të errëta dhe torturat që nuk mund të harrohen kurrë. Shpresoj që kjo mizori të mos shkaktohet ndaj asnjë qenie humane.”**

Ngawang Sangdrol

B

Një murg/murgeshë budist që beson qe Tibeti duhet të jetë e pavarur nga Kina, e që u arrestua për herë të parë në moshë 10 vjecar/e. Krimi i saj/tij ishte që duhej të bashkpunonte.

C

Një demonstratë paqësore për lirinim e Tibetit. U arrestua përsëri në moshën 15 vjecare dhe u dënua me 3 vjet. Ky dënim iu shqiptua për shkak që ajo/ai këndoi këngë për pavarësinë, dhe më vonë prap u dënua me 8 vjet për shkak...

D

Bërtiti “Liri Tibetit” derisa qëndronte në shi në oborrin e burgut. Sot ajo/ai është sëmurë nga veshkët si pasojë e torturave që ka përjetuar.



A

Unë kam një ëndërr që një ditë ky komb do të ngrihet dhe do të jetojë kuptimin e vërtetë të besimit të tij: “Ne i konsiderojmë këto të vërteta si të vetëkuptueshme: që të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë.” Unë kam një ëndërr që katër fëmijët e mi do të jetojnë një ditë në një komb ku nuk do të gjykohehen nga ngjyra e lëkurës së tyre, por nga përmbajtja e karakterit të tyre”

Martin Luther King

B


Lindur në Atlanta, Xhorxhia, në vitin 1929, kur ligji u kërkonte zezakëve të zinin vende të veçanta në autobus, teatro dhe kinema dhe të pinin nga burime të veçanta uji nga të bardhët. Kur ishte 28 vjeç, bashkëthemeloi

C

një organizatë e kishave të zeza që inkurajuan marshime, demonstrata dhe bojkotime jo të dhunshme kundër segregacionit radikal. Organizata mori pjesë në një protestë në Birmingham, Albama, në të cilën qindra fëmijë të shkollës këndonin

D

mbushën rrugët në mbështetje. Policia u urdhërua të sulmonte me qenë dhe zjarrfikës me zorrë me presion të lartë. Ai/ai u arrestua dhe u burgos.



A

Shmangia e dhunës është forca më e madhe në dispozicion të njerëzimit. Është më e fuqishme se arma më e fuqishme e shkatërrimit e krijuar nga zgjuarsia e njeriut.”

Mahatma Gandhi

B

Lindur në 1869, nga prindër hindu që jetonin në Gujarat kur India mbahej ende me forcë në Perandorinë Britanike. Ai/ajo udhëhoqi luftën për Pavarësi, duke mos qëndruar kurrë nga besimi i tij/saj i vendosur

C

protestë pa dhunë dhe tolerancë fetare, pavarësisht se janë arrestuar dhe burgosur në disa raste. Kur indianët vepronin dhunshëm kundër njëri-tjetrit, ose kundër Rajit britanik, ai/ajo agjëronte derisa dhuna mbaronte. Ai/ajo udhëhoqi një hark 241 milje nëpër Indi dhe

D

i bindi ndjekësit të pranojnë brutalitetin e policisë dhe ushtarëve pa hakmarrje. Ai/ajo kaloi gjithsej 2338 ditë në burg në një jetë të përkushtuar pa u lodhur ndaj paqes.



A

**Kam luftuar kundër dominimit të bardhë dhe kam luftuar kundër dominimit të zi. Unë e kam çmuar idealin e një shoqërie demokratike dhe të lirë në të cilën të gjithë njerëzit jetojnë së bashku në një harmoni dhe me mundësi të barabarta. Është një ideal për të jetuar dhe për të arritur. Por nëse është e nevojshme, është një ideal për të cilin jam i përgatitur të vdes.”**

Nelson Mandela

B

Lindur në një fshat afër Umtata-s dhe u zgjodh President i Republikës së Afrikës së Jugut në zgjedhjet e para demokratike në atë vend në moshën 76-vjeçare. Deri në atë moment - dhe më gjerë - jeta e tij/saj iu kushtua

C

lufta kundër apartheidit, sistemi racist i përdorur nga ish-qeveria e bardhë për të shtypur popullsinë e zezë me shumicë. Ai/ajo pësoi forma të ndryshme represioni: u ndalua nga takimet, u detyrua të fshihej dhe më në fund ishte

D

arrestohet dhe dënohet me burgim të përjetshëm në moshën 44 vjeçare. 28 vitet e ardhshme të jetës së tij/saj i kaloi prapa hekurave, larg familjes dhe fëmijëve.



A

**Si rezultat i disa takimeve të dhimbshme, por në të njëjtën kohë ngushëlluese, e pashë vetë se si nga thellësia e egërsisë morale u ngrit papritur thirrja “është faji im” dhe se si me këtë klithmë pacienti fitoi të drejtën për të thirrur vetën një qenie njerëzore.”**

Evgenia Ginzberg

B

Lindur në vitin 1906 në Rusi dhe vdiq në Moskë në 1977. Punoi në heshtje si mësues dhe gazetar derisa regjimi i Stalinit e cilësoi terrorist në një gjyq të sajuar. Kaloi 18 vjet në

C

Kampet e burgjeve siberiane në kushte të tmerrshme sepse ai/ajo refuzoi të akuzonte të tjerët për krime që ata nuk i kishin kryer. Vitin e parë e kaloi në izolim në një qeli të lagur, ku kishte të ndaluar të ushtronte, të flas, të këndoj apo të shtrihej gjatë ditës. Më vonë ai/ajo ishte

D

dërguar nga njëri në tjetrin nga kampet e punës siberiane - duke përfshirë, si ndëshkim për ndihmën e një shoku të burgosur, më të keqen, nga e cila pak u kthyen gjallë.

## PRAKTIKAT E MIRA NGA NIVELI LOKAL

### 1. PIKTURIMI I MURALEVE

**Çfarë?** Të premten e 10 dhjetorit, ekipi i RCT shënoi Ditën e të Drejtave të Njeriut duke pikturuar një mural në anën veriore të urës kryesore në Mitrovicë. Ky aktivitet mbledhi së bashku artistë nga komuniteti shqiptar dhe serb i Kosovës, të cilët dizajnuan dhe pikturuan një mural me mesazhe për domosdoshmërinë e bashkëpunimit dhe harmonisë ndëretnike në Kosovë. Të mbledhur në një rast kaq të rëndësishëm, ato shërbejnë si shembull i përsosur se çfarë mund të arrihet nëse njerëzit nga bashkësitë e ndryshme etnike janë të gatshëm të bashkëpunojnë dhe të krijojnë së bashku. Aktivitete të tilla si kjo ndihmojnë në përmirësimin e lidhjeve dhe nxitjen e proceseve të pajtimit dhe ndërtimit të paqes në një qytet të ndarë. Murali i bashkë-dizajnuar dhe pikturuar nga Gentian Murati, Stefan Milutinović dhe Milan Dobrić është një urë simbolike ndërmjet komuniteteve në Kosovë - një urë e ndërtuar nga bashkëpunimi, kreativiteti, artet, mesazhet pozitive dhe vlerat dhe besimet e përbashkëta në përpjekjet për ndërtimin e besimit. Kjo pjesë e veçantë e qytetit ku është krijuar murali është ende një "temë e nxehtë" për shkak të historisë së saj të konfliktit. Megjithatë, është e rëndësishme t'u tregohet njerëzve se është simbol i unitetit të qytetit të Mitrovicës dhe jo ndarje. Prandaj, ky kontribut mural, jo vetëm që do të shërbejë si një vepër e bukur arti, por edhe një vepër për t'u përdorur nga qytetarët që do të marrin foto me të, si simbol i paqes.

**Nga kush?** Community Building Mitrovica në kuadër të projektit të Pajtimit dhe Transformimit të Konfliktëve.

### 2. LE TË NDAJMË GJUHËN TONË

**Çfarë?** #LetsShareOurLanguage (Le të ndajmë gjuhën tonë) është një projekt që zhvillon mjete dhe instrumente inovative e digjitale për të rritur kapacitetet e institucioneve të Kosovës dhe për të rritur përputhshmërinë e tyre me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, dhe për të promovuar pranimin shoqëror të gjuhëve zyrtare në Kosovë. Ky projekt po përmirëson procesin e ankesave dhe po zhvillon mjete online/dixhitale që do të bëhen pjesë e integruar e faqeve të internetit të institucioneve të nivelit qendror dhe vendor dhe që do të bëhen pjesë e të paktën 50% (14) të vetëqeverisjeve lokale dhe (10) ministrive. Të gjitha veprimet për këtë projekt realizohen në bashkëpunim me Qendrën për Iniciativa Shoqërore dhe Zyrën e Komisionerit për Gjuhët me mbështetjen financiare të Ambasadës së Holandës në Kosovë.

"Thuaj Diçka/Reci nešto" janë podcast që po regjistrohen si pjesë e kësaj fushate me përmbajtje interesante, të dhëna statistikore në lidhje me përdorimin dhe të drejtat e gjuhës dhe gjithçka që lidhet me qëllimin e projektit. IRSH ka publikuar tashmë dy podcaste, një me Zulfija Jakupin, një gazetare dhe një me Predrag Milijkovic, një avokat, dhe tashmë kanë planifikuar të regjistrojnë podcaste të tjera.

**Nga kush?** Initiative e Re Shoqërore

## 2. PLATFORMA E TË DREJTAVE MIJA

**Çfarë?** Platforma e të Drejtave të Mia (edrejtajem.org) – Një platformë online e cila u ofron të rinjve më shumë informata mbi të drejtat themelore të njeriut. Ai shpjegon më tej rolet dhe funksionet e institucioneve në komunitet. Në këtë mënyrë platforma ndërgjegjëson të rinjtë se cilat nga të drejtat e tyre mbrohen, si të identifikojnë shkeljet e të drejtave të tyre dhe të kontribuojnë për një shoqëri më paqësore duke kërkuar drejtësi kur është e nevojshme përmes kategorisë raport/pyet të faqes në internet.

**Nga kush?** Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë

## 3. MOSLËNIA E ASKUJT PRAPA

**Çfarë?** “Mos lënia e askujt prapa” është një projekt që ka të bëjë me shpërndarjen e pakove higjienike për 300 familje që jetojnë në «Rr. Adem Voca», e cila është rrugë e populuar kryesisht nga komunitetet rom, egjiptian dhe ashkali, të cilat janë komunitete që ende janë të përjashtuara nga shoqëria. Është e rëndësishme që të përmendet se të njëjtat komunitete do të vazhdojnë të përfitojnë nga ky projekt përmes procedurës së lehtësimit të bursave që do t’u jepen pesë (5) fëmijëve që jetojnë në atë zonë dhe vendosjes së pesë (5) kontejnerëve të mbeturinave. Qëllimi i projektit është përfshirja e këtyre komuniteteve në shoqëri, duke u nisur nga bazat që janë të drejtat e tyre për një mjedis të pastër, e drejta e tyre për qasje në arsim, dhe përkrahja e atyre që janë të marginalizuar.

**Nga kush?** Community Building Mitrovica

## 2.7. KUJTESA

Përkujtimi është një kujtim ose mendim i lidhur me një gjë ose ngjarje të veçantë. Mund të jetë një veprim i kujtesës (siç është shënimi i një dite kur ka ndodhur diçka) ose mund të jetë një regjistrim përkujtimor i ndonjë ngjarjeje ose personi (siç është një monument).

Kur flasim për përkujtim, zakonisht i referohemi kujtimeve të dhunës apo shkeljes së të drejtave të njeriut (për të dyja, mund të përdorim shembullin e luftës në Kosovë në vitet 1998/1999). Ka të bëjë me mbajtjen gjallë të një kujtimi, ose të paktën të mos i lejojmë vetes të anashkalojmë tmerret që kanë ndodhur në të kaluarën. Përkujtimi është i rëndësishëm sepse u jep mbyllje viktimave dhe u mundëson atyre të lëvizin nga e kaluara dhe tmerret që kanë ndodhur. Ky proces është i një rëndësie të madhe sepse na ndihmon “të falim por jo të harrojmë”. Dhe ne nuk duhet të harrojmë ngjarjet e kaluara pasi ato na kujtojnë që të mos i përsërisim.

Si përfundim, përkujtimi si akt lidhet me ligjet dhe konventat, siç është Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit dhe Gjenocidit. Kjo Konventë ishte ndër të parat e Kombeve të Bashkuara që lidhet me çështjet humanitare dhe u miratua në përgjigje të krimeve të kryera gjatë Luftës së Dytë Botërore.

## IDE PËR PUNËTORI

## PUNËTORIA



Përshtatur nga Compass: Doracak për Edukimin për të Drejtat e Njeriut me të Rinjtë

## ETIKETA E KUJTESËS

**Koha:** Deri në 1h e 30 min.

**Grupi:** Fleksibil;

**Qëllimi:** Të reflektojë mbi mitet dhe faktet për luftën dhe rolin që kanë në të memorialet

publike; për të nxitur dhembshurinë.

**Materialet:** Fletë letre flipchart, shirit, shënues shumëngjyrësh, opsionale:

fotografi të përkujtimeve të luftës dhe shembuj të reve me etiketa.

## Përshkrimi i punëtorisë:

**HAPI 1** Bëni një copë të madhe letre (për të matur përafërsisht 1,5 m x 1,5 m) duke ngjitur së bashku disa faqe letre flipchart. Ajo duhet të jetë mjaft e madhe që të gjithë anëtarët e grupit të jenë në gjendje të gjejnë një vend rreth tij. Vizatoni një vijë të zbehtë në mes.

**HAPI 2** Sigurohuni që të gjithë e dinë se çfarë është një “re etikete”. Një re etikete është një rregullim logjik i fjalëve kyçe brenda një përmbajtje tekstuale që përshkruan vizualisht temën në internet.

**HAPI 3** Shpjegoni grupit se ata do të bëjnë një re etiketash jo-elektronike për të ilustruar shoqatat dhe kujtimet

e evokuara nga memorialet publike të luftës.

**HAPI 4** Kërkojuni pjesëmarrësve të reflektojnë individualisht për një memorial lokal të luftës që u ngrit në Kosovë. Ata duhet të përpiqen të kujtojnë se si duket dhe të identifikojnë ndjenjat, idetë dhe shoqatat – pozitive dhe negative – që ai memorial ngjall tek ata.

**HAPI 5** Ftoni të gjithë të marrin një shënues shumëngjyrësh dhe të gjejnë një vend rreth letrës. Ende duke punuar individualisht, ata tani duhet të vendosin “etiketat” e tyre individuale në fletën e përbashkët të letrës, sipas parimeve të përgjithshme vijuese:

1. Etiketat janë krejtësisht individuale: ato janë thjeshtë mënyra se si e perceptoni një objekt të caktuar.
2. Lidhjet negative duhet të shkruhen në anën e majtë të vijës qendrore; sa më negative të jenë, aq më larg drejt skajit të majtë të letrës duhet të jenë.
3. Ndjenjat pozitive duhet të shkruhen në anën e djathtë të faqes; sa më pozitive të jenë, aq më larg drejt skajit të djathtë të letrës.
4. Ndjenjat që evokohen fuqishëm nga memoriali duhet të shkruhen në tekst më të madh sesa ndjenjat që ngjallen vetëm dobët, të cilat duhet të shkruhen në tekst më të vogël.

**HAPI 6** Kur pjesëmarrësit të kenë regjistruar etiketat e tyre, kërkoni të ulen dhe të shikojnë rezultatet kolektive. Pyetni:

- A ka ndonjë mesazh apo model të fortë në “re”?
- A janë të befashuar nga ndonjë prej etiketave?
- A ngjallen më shumë ndjenja pozitive sesa negative, apo anasjelltas?
- Cilat priren të jenë ndjenjat më të forta të shkaktuara?
- A është kjo mënyra se si mendoni se lufta duhet të mbahet mend nga brezat e ardhshëm? Çfarë mungon - ose ku duhet korrigjuar balanca?

**HAPI 7** Tani ftoni pjesëmarrësit të marrin sërish shënuesit. Këtë herë ata nuk duhet të mendojnë për memorialet aktuale, ekzistuese, por për një memorial imagjinar që do të dërgonte – për secilin prej tyre – mesazhet më të rëndësishme për luftën. Ata duhet të përsërisin procesin e etiketimit që kanë kaluar më parë, duke i vendosur sërish etiketat e tyre individualisht në të njëjtën fletë ku kanë vendosur mesazhet e tyre të para. Shpjegoni se reja e parë e etiketave tani është një hapësirë publike dhe

nuk mund të fshihet, kështu që etiketat e reja duhet të vendosen mbi të parat.

**HAPI 8** Kur “reja” të përfundojë, ftoni pjesëmarrësit të shikojnë përsëri të gjithë pamjen dhe më pas të kalojnë në përmbledhje dhe vlerësim.

- Informimi:
- HAPI 9**
- Sa mund ta kontrollonit formën e resë përfundimtare?
  - A ishit të frustruar nga mesazhet e tjera që dolën më fuqishëm se ato që dëshironi të promovoni?
  - A keni vepruar individualisht në rastin e resë së dytë, apo jeni tunduar ose të diskutoni ide me njerëz të tjerë, ose të kombinoni forcat në aktin e “tiketës”?
  - Në çfarë niveli u ndikuat ose nga etiketat e njerëzve të tjerë, ose nga ato tashme në faqe?
  - Sa ndryshon reja e kompletuar nga ajo e para dhe cilat janë mesazhet kryesore?
  - A i përfaqëson reja e fundit mesazhet që mendoni se gjeneratat e ardhshme duhet të marrin për luftën e Kosovës më mirë se e para? Pse? Pse jo?
  - Pse memorialet zyrtare priren të “lavdërojnë” luftën? A mendoni se lufta

- duhet lavdëruar?
- Çfarë mesazhi japin memorialet zyrtare për palën tjetër, serbe apo shqiptare? Si duhet ta kuptojmë këtë mesazh sot? Po monumentet për minoritetet?
  - Sa e lehtë ishte për ju të imagjinoni një lloj tjetër memoriali? Si do të ishin këto përkujtime? Çfarë mendoni se ishte e rëndësishme dhe çfarë e patë më të vështirë?
  - Nëse do të kishit humbur dikë të afërt në një luftë, si do të dëshironit që ai person të kujtohej dhe çfarë do t’i tregonit brezit të ardhshëm për luftën?
  - Sa e rëndësishme është që të ketë përmendore të përbashkëta (për të gjitha viktimat e luftës në Kosovë), jo të ndara?





**SHTOJCA**

SHEMBULL I ETIKETËS RE

**Qëllimi**  
 Kulturere  
 Ruajtja  
**Historike**  
 Arkitekture  
 Pallati  
 Mbrojtje  
**Personi**  
 Formim  
 Përkujtojnë  
 Ndërtesa  
**Monumenti**  
 Trashigimia  
 Strukturë  
 Përkujtim  
 Statuja

# PUNËTORIA



Përshtatur nga Compass: Doracak për Edukimin për të Drejtat e Njeriut me të Rinjtë

## KU QËNDRONI

**Koha:** Deri në 1h e 30 min.

**Grupi:** Më shumë se 10

**Qëllimi:** Për t'i ndihmuar pjesëmarrësit të kuptojnë pozicionin e tyre për luftën

në Kosovë, të kuptojnë edhe të tjerët, dhe të nxisin komunikimin për luftën dhe përkujtimin.

**Materialet:** Dy copa letre, një dhomë mjaftueshëm e madhe për të lëvizur.

### Përshkrimi i punëtorisë:

#### HAPI 1

Përgatitni hapësirën në atë mënyrë që në

njëerën anë të jetë letra ku shkruhet "PAJTOHEM" dhe në anën tjetër "NUK PAJTOHEM".

#### HAPI 2

Shpjegoni se do të lexoni deklarata të ndryshme dhe ata duhet të pozicionohen sipas asaj që mendojnë individualisht. Nëse ata pajtohen plotësisht, ata duhet të qëndrojnë pranë letrës ku është shkruar PAJTOHEM dhe anasjelltas. Në rast se nuk janë të sigurtë, duhet të qëndrojnë në mes.

#### HAPI 3

Tregoni atyre se ky ushtrim duhet të bëhet në qetësi.

#### HAPI 4

Lexoni një deklaratë dhe jepini kohë për të lëvizur. Pasi

të jenë pozicionuar, pyesni nëse ka ndonjë koment. Në rast se pozicioni i dikujt është interesant ose i ndryshëm nga pozicionet që kanë të tjerët, kërkon komente nga ky person. Stimuloni reflektimin dhe diskutimin. Kërkojuni atyre në pikat e fundit të shpjegojnë pse i kanë zënë këto pozicione ekstreme. Pyesni dikë pranë qendrës nëse pozicioni i tij tregon mungesën e një mendimi të fortë apo mungesën e njohurive.

#### HAPI 5

Tregoni atyre se mund të ndryshojnë pozicionin e tyre ndërsa dëgjojnë komentet e njëri-tjetrit.

#### HAPI 6

Pasi të keni kaluar nëpër deklaratat, sillni grupin përsëri së bashku për informim.

#### HAPI 7

Informimi:

1. A kishte ndonjë pyetje që njerëzit e kishin të pamundur t'i përgjigjeshin – ose sepse ishte e vështirë të vendosnin vetë, ose sepse pyetja ishte formuluar keq?
2. Pse njerëzit ndryshojnë pozicionet gjatë diskutimeve?
3. A u befasuan njerëzit nga shkalla e mosmarrëveshjeve për çështjet?
4. A mendoni se ka përgjigje "të drejta" dhe "të gabuara" për deklaratat e ndryshme, apo është vetëm çështje e opinionit personal?

5. A mund të jetë ndonjëherë e mundur që të gjithë të arrijnë marrëveshje për atë që ndodhi gjatë luftës?

6. Pse është e rëndësishme të dihet se kemi këndvështrime të ndryshme për luftën në Kosovë?

7. Për çfarë mund të pajtohem?

## SHTOJCA

### DEKLARATAT (MUND TË SHTOHEN MË SHUMË):

- 1 Shkeljet e të drejtave të njeriut mund të justifikohen;
- 2 Përdorimi i dhunës për të ndaluar dhunën është i justifikuar;
- 3 Lufta nuk i sjell askujt asgjë të mirë;
- 4 Vuajtjet nuk mund të krahasohen;
- 5 Shqiptarët ishin viktimat e luftës në Kosovë;
- 6 Serbët ishin viktimat e luftës në Kosovë;
- 7 Viktimat janë të gjitha të njëjta;
- 8 Duhet të falim por jo të harrojmë;
- 9 Na duhet një memorial i përbashkët për viktimat e luftës së Kosovës;
- 10 Jam i gatshëm të mësoj më shumë për të gjitha viktimat e luftës në Kosovë;
- 11 Unë di mjaftueshëm për vuajtjet e luftës të grupeve të tjera etnike në Kosovë;
- 12 Të jetosh së bashku dhe në paqe është e mundur.

## PRAKTIKAT E MIRA NGA NIVELI LOKAL

### 1. MUZEU VIRTUAL I REFUGJATËVE

**Çfarë?** Muzeu virtual i refugjatëve - një projekt kujtesë që po krijon arkiva dixhitale që ndihmojnë në ruajtjen e kujtesës, ofrojnë një bazë për të kuptuar të kaluarën në Kosovë, pasurojnë dhe sfidojnë narrativat, parandalojnë përsëritjen e luftës, ndërtojnë një ndjenjë të paqes së qëndrueshme dhe mundësojnë një vizion dhe proces të përbashkët për pajtimi i ardhshëm. Projekti është pjesë e projektit “Nxitja e qasjeve të reja për pajtimin e të rinjve” që synon të sfidojë diskursin publik të njëanshëm dhe etniko-nacionalist lidhur me të kaluarën e Kosovës, dhe ta pasurojë atë me histori dhe përvoja personale të njerëzve. Platforma online kontribuon në njohjen simbolike të vuajtjeve të civilëve nga të gjitha grupet etnike gjatë luftës në Kosovë. Ajo gjithashtu promovon një debat publik gjithëpërfshirës për të kaluarën dhe rrit ndjeshmërinë shoqërore duke publikuar histori të ndryshme. (<https://museumofrefugees-ks.org/>).

**Nga kush?** Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë.

### 2. KORNIZA E SHOQËRISË CIVILE PËR STRATEGJINË KOMBËTARE PËR TRAJTIM TË SË KALUARËS NË KOSOVË

**Çfarë?** Korniza e Shoqërisë Civile për Strategjinë Kombëtare për Trajtim të së Kaluarës në Kosovë, qëllimi kryesor i këtij projekti ishte realizimi i një kornize të drejtuar nga shoqëria civile për një Strategji Kombëtare për Trajtimin e së Kaluarës në Kosovë, e dizajnuar me kontributin e qytetarëve në mënyrë që ajo të adresojë nevojat aktuale të shoqërisë në Kosovë, dhe duke ditur mekanizmat aktualë

të Drejtësisë Kalimtare që do të miratohen nga Qeveria e Kosovës për të forcuar garancitë e mos përsëritjes (GMP) dhe perspektivat për pajtim në mes të komuniteteve në Kosovë. Grupi filloi një nismë të përbashkët për të hartuar dhe miratuar se si të angazhohej me viktimat, të mbijetuarit, të kaluarat e dhimbshme dhe narrativat historike. Nisma synon të parandalojë diskursin dhe veprimet e dëmshme në lidhje me trashëgiminë e konfliktit dhe do të shërbejë si një dokument referimi ndaj të cilit kushdo që shkel parimet e tij duhet të mbajë përgjegjësi moralisht. Kjo nismë mbështetet nga Ambasada e Zvicrës në Kosovë, Ambasada Britanike në Kosovë dhe UNDP.

**Nga kush?** Nisma e Re Shoqërore

### 3. MUZEU FËMIJËT E LUFTËS

**Çfarë?** Muzeu Fëmijët e Luftës - një nismë për të përmirësuar kujtesën kolektive për luftën e fundit në Kosovë, si një mënyrë për t'u përballur me të kaluarën, si dhe duke zhvilluar një qasje kritike ndaj tregimeve të ndryshme përmes hulumtimit dhe dokumentimit të përvojave dhe tregimeve të kohës së luftës. Nisma gjithëpërfshirëse e përkujtimit kontribuon në të kuptuarit e historive të fëmijërisë të luftës dhe në përgjithësi se si jeta e përditshme gjatë luftës së fundit ka mbetur në margjinat e kujtesës dhe përkujtimit kolektiv.

**Nga kush?** Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut.

#### 4. VEPRIMET RRUGËS PËR TRAJTIM ME PARIMET E KALUARA NË KONTEKSTIN E KOSOVËS

**Çfarë?** Veprimet në rrugë për trajtimin e parimeve të së kaluarës në kontekstin e Kosovës

Me organizimin e aksioneve në rrugë, temat që lidhen me të kaluarën trajtohen përmes formave të artit në mënyrë që të tërheqin vëmendjen e publikut të gjerë për tema të tilla që synojnë ngritjen e gjithë përfshirjes, njohjen e vuajtjeve të së kaluarës nga viktimat, dhe më tutje të informojë akterët publikë dhe politikë, mediat dhe publikun e gjerë se si duhet trajtuar viktimat, të mbijetuarit dhe të kaluarën tonë në përgjithësi. (<https://www.facebook.com/YIHRKS/posts/2000761660088124>) (<https://www.facebook.com/YIHRKS/posts/1912047068959584>)

**Nga kush?** Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë.

#### 5. VEPRIMET NË RRUGË QË SHËNOJNË DITËN KOMBËTARE TË PERSONAVE TË PAGJETUR

**Çfarë?** Veprimet në rrugë për shënimin e Ditës Kombëtare të Personave të Zhdukur - Tashmë një ftesë tradicionale për qytetarët e Kosovës që të fikin dritat në shtëpitë e tyre për 5 minuta për të shënuar Ditën Kombëtare të Personave të Pagjetur nga lufta e fundit në Kosovë. Me pesë minuta errësirë në familjet tona, ne ndjejmë dhimbjen dhe errësirën në të cilën jetojnë prej 21 vitesh familjarët e 1639 personave të pagjetur. (<https://www.facebook.com/events/957540101657757/>)

**Nga kush?** Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë.

#### 6. VEPRIMET E RRUGËS QË SHËNOJNË DITËN NDËRKOMBËTARE TË ZHDUKJEVE TË DETYRUARA

**Çfarë?** Veprimet në rrugë për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Zhdukjeve të Detyrueshme - NRDN (YIHR) organizoi veprime në rrugë për të kujtuar shoqërinë dhe institucionet për çështjen e personave të zhdukur e cila ende nuk është zgjidhur, dhe për tu solidarizuar me familjet e personave të pagjetur. Përmes aksioneve të ndryshme simbolike në rrugë NRDN (YIHR) KS ndërgjegjëson se shoqëria kosovare vazhdon të përballet me mohimin e së drejtës për të ditur të vërtetën dhe të drejtën për drejtësi. (<https://www.facebook.com/YIHRKS/posts/1951303078367316>)

**Nga kush?** Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë.

#### 7. SESIONE INFORMUESE MBI TRAJTIMIN E PARIMEVE TË SË KALUARËS NË SHKOLLAT E MESME/UNIVERSITETE TË NDRYSHME

**Çfarë?** 7. Sesione informuese mbi trajtimin e parimeve të së kaluarës në shkollat e mesme/universitete të ndryshme - Duke i informuar të rinjtë mbi 10 parimet e kësaj nisme qytetare, të rinjtë mësojnë më shumë rreth trajtimit të proceseve të së kaluarës, shprehjet e përdorura, dhe çfarë qasjeje duhet të kenë ndaj këtyre temave. Duke diskutuar këto parime, të rinjtë kuptojnë më shumë rëndësinë e të kuptuarit të konfliktit dhe rëndësinë e trajtimit të së kaluarës si një proces për të parandaluar përsëritjen e historisë.

**Nga kush?** Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë.

## 2.8. EMPATIA DHE SHKRIM-LEXIMI EMOCIONAL

Kur trajtoni konfliktet dhe punoni në ndërtimin e paqes, një nga gjërat më të rëndësishme janë emocionet. Njohja dhe të kuptuarit e emocioneve tona, por edhe aftësia për të kuptuar emocionet e njerëzve të tjerë dhe për të empatizuar me ta është me rëndësi të madhe në këtë fushë. Prandaj, shkrim-leximi emocional dhe ndjeshmëria janë dy gjëra thelbësore për paqen.

Shkrim-leximi emocional nënkupton vetë-reflektim emocional, ndërgjegjësim dhe pranim të ndjenjave tona, si dhe të dimë

se si t'i trajtojmë ato. Për të na ndihmuar të zbulojmë dhe kuptojmë më mirë emocionet tona, apo edhe për t'i emërtuar ato, mund të përdorim Rrotën e Emocioneve, zhvilluar nga Robert Plutchik (Figura Nr. 6). Për më tepër, shkrim-leximi emocional përfshin ndjeshmërinë e cila është aftësia për të kuptuar se çfarë ndjejnë njerëzit e tjerë, ose për të imagjinuar veten në vendin e një personi tjetër. Në thelb, të përpiqesh të “ecësh në këpucët e njerëzve të tjerë”.

Për të zgjidhur konfliktin në mënyrë paqësore, për t'iu përgjigjur në mënyrë jo të dhunshme dhunës, për të ndërtuar paqen dhe për të nxitur pajtimin, duhet të jemi sa më të arsimuar emocionalisht. Ne duhet të hapemi për të empatizuar me të tjerët.




FIGURA NR. 6 RROTA E EMOCIONEVE NGA ROBERT PLUTCHIK

IDE PËR PUNËTORI

## PUNËTORIA



Përshtatur nga Punëtoritë e Ekipit të Kampit Rinor të Paqes

## ECJA ME KËPUCËT E TJETRIT

**Koha:** Deri në 45 min.**Grupi:** Fleksibil;**Qëllimi:** Të reflektojmë mbi sjelljet tona në konflikt;

kuptojmë më mirë emocionet e tyre, për të empatizuar me tjetrin.

**Materialet:** Altoparlant, muzikë qetësuese për meditim, hapësirë që pjesëmarrësit të ndihen rehat

## Përshkrimi i punëtorisë:

## HAPI 1

Thuaji pjesëmarrësve të gjejnë një vend dhe pozicion të rehatshëm për veten e tyre;

## HAPI 2

Shpjegoni se ky ushtrim është individual, ata nuk kanë nevojë të ndajnë asgjë dhe duhet të bëhet në qetësi;

## HAPI 3

Pasi të gjithë të kenë gjetur vendin e tyre, ftojini të mbyllin sytë dhe të marrin frymë thellë;

## HAPI 4

Lexoni ngadalë dhe bëni pushime pas çdo fjalie, në mënyrë që pjesëmarrësit të kenë kohë për të menduar dhe reflektuar;

*Imagjinoni 3 karrige. Ju jeni ulur në njëren nga karriget dhe tjetra është para jush dhe personi me të cilin keni pasur diskutim është aty. Karrigia e tretë është*

*mes juve dhe është bosh. Tani imagjinoni bisedën që keni pasur. Imagjinoni që nuk jeni në "vend", por jeni atje. Si është marrëdhënia me personin tjetër? Sa e rëndësishme është për ju? si u ndjeve? Ishe i zemëruar? E trishtuar? I frustruar? Çfarë ju duhet tani? Çfarë po mendoni për personin tjetër? A ka ndonjë ndjesi në trupin tuaj?*

*Pas 5 minutash, imagjinoni se jeni ulur në karrigen para jush. Ju jeni personi tjetër tani. Nuk je më ti, por personi me të cilin ke pasur konflikt. Si po ndihesh? Çfarë mendoni për personin tjetër? Çfarë te nevojitet? Cilat janë ndjenjat tuaja ndaj personit tjetër?*

*Si përfundim, imagjinoni se jeni ulur në karrige në mes të vëzhgimit të bisedës? Çfarë shihni? Cilat janë idetë që ju vijnë në mendje? Çka mendoni, si ndihen këta dy persona? Çfarë mendoni se u duhet tani këtyre dy njerëzve?*

## HAPI 5

Ftojini ata të kthehen në dhomë dhe të hapin sytë sa herë që janë gati. Jepuni atyre një ose dy minuta pushim dhe kthejini për diskutim.

## HAPI 6

Informimi:

- Si ishte ky ushtrim? A ju pëlqeu?
- Si u ndjetë gjatë aktivitetit?
- A ishe në dijeni të emocioneve dhe mënyrës se si i trajtonit ato?
- A ishin përgjigjet të ngjashme mes jush dhe çiftit tuaj?
- A mësuat ndonjë gjë për veten?
- Kur punuam për një konflikt që kishit ju, si u ndjeve ta shihje situatën nga këndvështrime të ndryshme?
- A mësuat diçka? Për veten? Për personin tjetër?
- Do të bënit diçka ndryshe nëse do të përballshit me të njëjtën bisedë tani?
- Çfarë do të ndodhte nëse jemi të vetëdijshëm për emocionet e tjetrit?

## PUNËTORIA



Përshtatur nga pakoja e instrumenteve “Të rinjtë që transformojnë konfliktin”

## KUR JAM NE SITUATA KONFLIKTI...

**Koha:** Deri në 45 min

**Grupi:** Fleksibil

“[filmi] kërkonte qartë – me anë të një interviste – të ekspozonte, analizonte dhe shpjegonte këtë grup të veçantë të rinjsh, të kufizuar dhe të frustruar nga situata e tyre shoqërore, me të kaluar penale dhe qëndrime të dhunshme, duke trajtuar kështu aspekte specifike të një çështjeje që tashmë atëherë ishte një shqetësim i madh publik.”

Gjykata theksoi gjithashtu se raportimi i lajmeve është thelbësor në një shoqëri demokratike dhe i lejon shtypit të luajë rolin e “mbrojtësit publik”. Ata thanë se do të duhej të kishte arsye shumë të forta për ndëshkimin e një gazetari që publikoi deklarata të bëra nga dikush tjetër. Është një nga funksionet e rëndësishme të shtypit të lirë që lejon dhe inkurajon diskutimin publik të çështjeve me rëndësi të përgjithshme për shoqërinë.

#### Rasti

Kandidati në këtë rast është Z. Jens Olaf Jersild, një shtetas danez që punon për Danmarks Radio (e cila transmeton gjithashtu programe televizive). Kanali i lajmeve konsiderohet si një kanal serioz dhe ka një audiencë njerëzish të mirë informuar. Z. Jersild donte të transmetonte një dokumentar mbi një grup ekstrem racist të quajtur “Greenjackets”

. Ai i kontaktoi anëtarët e grupit dhe zhvilloi një intervistë të gjatë me ta; pastaj e shkurtoi filmin në disa minuta dhe shtoi disa komente të tijat. Rezultati përfundimtar u shfaq si pjesë e një programi lajmesh dhe u transmetua në televizionin kombëtar. Në transmetim, anëtarët e Greenjackets u shfaqën duke bërë komente fyese dhe nënçmuese për emigrantët dhe grupet etnike në Danimarkë, duke krahasuar burrat me ngjyrë me gorillat dhe duke thënë se ata “nuk janë njerëz”.

Një gjykatë daneze i shpalli anëtarët e Greenjackets fajtorë për komente raciste dhe gjithashtu e shpalli fajtor zotin Jersild sepse ai i kishte ‘inkurajuar’ ata dhe i kishte transmetuar vërejtjet për një audiencë më të gjerë. Z. Jersild apeloj dënimin e tij në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sepse ai mendonte se dënimi i tij nga një gjykatë daneze ishte shkelje e të drejtës së tij për lirinë e shprehjes (neni 10 i GJEDNJ). Gjykata Evropiane duhej të vendoste nëse kufizimi i së drejtës së tij për të transmetuar komentet ishte ‘legjitimë’. Kjo do të thoshte nëse ishte arritur ekuilibri i duhur ndërmjet mbrojtjes së të drejtave të njerëzve që ishin objektivi i komenteve raciste dhe nevojës që publiku të dinte për ekzistencën e grupeve të tilla.



### **Kartë Roli për Z. Jersild**

Ju jeni një gazetar serioz dhe keni dashur të bëni një film për racizmin dhe ksenofobinë që ka bërë 2 gjëra:

1. Ilustroi nivelin e problemit – duke përfshirë natyrën ekstreme të pikëpamjeve të mbajtura nga Greenjackets

2. Tregoi se Greenjackets janë një grup i kriminalizuar me shumë anëtarë të papjekur emocionalisht dhe në disavantazh shoqëror.

Ju besoni se të dyja këto pika janë të rëndësishme për shoqërinë për t'i kuptuar dhe mendoni se programi juaj arriti t'i trajtojë të dyja, pjesërisht duke transmetuar drejtpërdrejtë disa nga opinionet më të këqija, dhe pjesërisht duke përshkruar nivelin e dobët të arsimit, sfondin dhe vështirësitë shoqërore të përjetuara nga të rinjtë që keni intervistuar. Ju nuk mendoni se ndonjë nga shikuesit tuaj do ta kishte kuptuar se programi juaj po mbështet mendimet raciste të shprehura.

Si gazetar, ju e vlerësoni shumë lirinë e shprehjes: kufizimi i tepërt do ta bënte të pamundur që gazetarët të informonin publikun për çështje reale – dhe të pakëndshme. Ju besoni se gazetarët kanë përgjegjësinë për të sjellë në vëmendjen e publikut çështje të tilla në mënyrë që ato të njihen dhe të trajtohen.

Neni 10 i Konventës Evropiane (i thjeshtësuar)

1. Secili ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të mbajtur mendime, dhe për të marrë dhe komunikuar informata dhe ide pa ndërhyrje.

2. Liria e shprehjes mund të kufizohet nëse kufizimi është "i nevojshëm në një shoqëri demokratike" - në veçanti, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve.

### **Kartë roli për Qeverinë Daneze**

Ju besoni se ishte e drejtë që zoti Jersild u dënua nga gjykata daneze. Programi i tij përmbante pikëpamje shumë ekstreme dhe raciste të cilat nuk duheshin dëgjuar nga një audiencë e gjerë. Programi ishte sensacionalist dhe nuk përmbante komente të mjaftueshme për të thënë se pikëpamjet e shprehura ishin të papranueshme dhe të rrezikshme. Ju besoni se gazetarët kanë përgjegjësinë të sigurojnë që shikuesit të mos jenë të mërzhitur ose të mashtruar. Ju mendoni se njerëzit që shikonin programin e tij nuk do ta kishin kuptuar që gazetari ishte i tronditur nga deklaratat raciste dhe se ai nuk i miratonte ato. Ata nuk do ta kishin kuptuar se deklarata të tilla janë injorante, të dëmshme dhe të paligjshme. Z. Jersild e redaktoi filmin për të treguar komentet më të këqija të shprehura nga Greenjackets. Ju mendoni se ai nuk duhej t'i kishte intervistuar anëtarët dhe t'i inkurajonte ata të shprehnin pikëpamje të tilla, dhe sigurisht që nuk duhej t'u jepte mendimeve një publicitet të gjerë duke i përfshirë në programin e tij. Ju nuk mendoni se programi duhet të ishte bërë dhe zoti Jersild duhet të mbahet përgjegjës për dhënien e një publiciteti të gjerë mendimeve të tilla të rrezikshme.

Neni 10 i Konventës Evropiane (i thjeshtësuar)

1. Secili ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të mbajtur mendime, dhe për të marrë dhe komunikuar informata dhe ide pa ndërhyrje.

2. Liria e shprehjes mund të kufizohet nëse kufizimi është "i nevojshëm në një shoqëri demokratike" - në veçanti, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve.

### Kartë roli për Gjyqtarët

Është detyra juaj të menaxhoni gjykimin dhe më pas të vendosni nëse mendoni se gjykatat daneze vepruan drejt dhe nëse zoti Jersild ishte vërtet fajtor ose nëse të drejtat e tij ishin shkelur.

Procesi i gjyimit:

Filloni duke i kujtuar z. Jersild dhe përfaqësuesin e Qeverisë Daneze se secilës palë do t'i jepen disa minuta për të paraqitur anën e tyre të çështjes; atëherë do të bëni pyetje dhe ata mund t'i përgjigjen njëri-tjetrit. Tregojuni atyre se ata duhet të sillen në mënyrë të rregullt dhe të ndjekin çdo udhëzim nga ju.

Vendimi që duhet të nxirrni:

Ju duhet të mendoni nëse zoti Jersild duhet të kishte lejuar që filmi i tij të transmetohej për publikun. E drejta e tij për lirinë e shprehjes duket se e lejon atë ta bëjë këtë, por liria e shprehjes nuk është një e drejtë absolute – ajo duhet të balancohet kundrejt shqetësimeve të tjera shoqërore dhe të drejtave të tjera të njeriut. Është detyra juaj të vendosni nëse balanca është vendosur saktë në këtë rast.

Këto janë pyetjet kryesore që do t'ju duhet të vendosni dhe t'i peshoni kur të dëgjoni provat e të dyja palëve:

- A mendoni se filmi mund të jetë kup-tuar nga publiku se mbështet mendimet raciste?
- A ishte e rëndësishme që publiku të dinte për besimet raciste dhe historikun e Greenjackets, apo ishte më e rëndësishme që mendime të tilla të mos arrinin një audiencë të gjerë?

Neni 10 i Konventës Evropiane (i thjeshtësuar)

1. Secili ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të mbajtur mendime, dhe për të marrë dhe komunikuar informata dhe ide pa ndërhyrje.

2. Liria e shprehjes mund të kufizohet nëse kufizimi është "i nevojshëm në një shoqëri demokratike" - në veçanti, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve.

### 3.5. Lajmet e rreme dhe arsimimi mediatik

Kur flitet për lajme të rreme, ka shumë shprehje që duhen sqaruar dhe shpjeguar për të kuptuar më mirë këtë fenomen. Në lidhje me këtë, flasim për keqinformim, dezinformim, dhe natyrisht lajme të rreme. Keqinformimi është “informata që është e rremë ose mashtruese, por jo e krijuar me qëllim për të shkaktuar dëm”<sup>15</sup>. Nga ana tjetër, kemi dezinformim që është “i rremë dhe i krijuar qëllimisht për të dëmtuar një person, grup shoqëror, organizatë ose një vend”<sup>16</sup>. Së fundi, kemi lajme të rreme që përkufizohen si “informata të rreme, shpesh të një natyre sensacionale, që imiton përmbajtjen e mediave të lajmeve”<sup>17</sup>. Nëse kërkojmë edhe më shumë shpjegime, fjalori i Kembrixhit do t'i paraqiste lajmet e rreme si “histori të rreme që duken si lajme, të përhapura në internet ose duke përdorur media të tjera, të krijuara zakonisht për të ndikuar në pikëpamjet politike ose si shaka”<sup>18</sup>.

Në botën ku jetojmë, lajmet e rreme janë bërë një dukuri e përditshme. Prandaj, për të mos u ndikuar apo mashtruar prej tyre, arsimimi mediatik është vendimtar. Literatura mediatike është një shprehje që i referohet “aftësisë për të deshifruar mesazhet nga media; vlerësoni ndikimin e atyre mesazheve në mendimet, ndjenjat dhe sjelljet; dhe krijoni media me mendim dhe ndërgjegje”<sup>19</sup>.

Për qëllime të luftimit të lajmeve të rreme dhe nxitjes së arsimimit mediatik, ne gjithmonë mund të përdorim rregullin e ESC për arsimimin mediatik. Rregulli ESC (rregulli i emocioneve, burimit dhe pretendimit) na fton të mendojmë:

1. Çfarë emocionesh më jep ky lajm?
2. Cila është besueshmëria e burimit?
3. Dhe çfarë pretendimi përbën ky lajm?

Duke përdorur këtë rregull, ne mund të fillojmë të dekonstruojmë lajmet e rreme që vetëm dëmtojnë shoqëritë tona. Përveç kësaj, ne mund të zbulojmë lajme të rreme më mirë duke ndjekur pyetjet me 5W.

1. PREJ nga vjen informata? – Shiko linkun . A duket i njohur apo i besueshëm?
2. KUR është bërë postimi online? Cila është data në postim? A është data e vërtetë? A është postimi i fundit?
3. KUSH e krijoi informatën? – Kush e shkroi artikullin? Kush i bëri fotot?
4. SI duket postimi ose faqja e internetit? Shikoni paraqitjen. A është faqja e internetit e paraqitur mirë dhe e organizuar me kujdes? Shikoni titullin. A është e bujshme?
5. PSE ose SI e dini me siguri se është e vërtetë? – Kontrolloni përsëri përmbajtjen. A duket e pamundur ndonjë informatë?

<sup>15</sup> Doracaku i demaskimit 2020, faqe 5;

<sup>16</sup> Doracaku i demaskimit 2020, faqe 5;

<sup>17</sup> Doracaku i demaskimit 2020, faqe 5;

<sup>18</sup> Fjalori i Kembrixhit, qasur në maj 2022;

<sup>19</sup> Media Literacy Now, qasur në maj 2022 <https://medialiteracynow.org/what-is-media-literacy/>

## IDE PËR PUNËTORI

## PUNËTORIA



Zhvilluar nga British Council –  
Mësimdhënia Anglisht

## DETEKTORI (ZBULUESI) I LAJMEVE TË RREME

**Koha:** 1h e 30 min.

**Grupi:** Fleksibil

**Qëllimi:** Për të hulumtuar se si të zbuloni lajmet e rreme, të nxisni të menduarit kritik,

të ndërgjegjësoni për lajmet e rreme dhe si t'i njihni ato.

**Materialet:** Tabela (në shtojcë); 5W printuar nga teoria; Ose dërgojini

pjesëmarrësit në dy faqet e internetit online, ose bëni fotokopje të dy faqeve të internetit dhe shpërndajini ato tek pjesëmarrësit.

### Përshkrimi i punëtorisë:

#### HAPI 1

Shpjegojuni pjesëmarrësve se sot do të përiqemi të zbulojmë lajme të rreme. Filloni duke i ndarë në grupe të vogla pune.

#### HAPI 2

Kur të bëni ndarjen në grupe, jepini pyetjet e mëposhtme për të diskutuar dhe për të krijuar një poster/letër grafiku të përbashkët:

Ku i merrni lajmet tuaja?  
Cilat burime përdorni?

Çfarë mendoni për këtë fjalë? “Duhet të jetë e vërtetë sepse e lexova në internet.”

Çfarë kuptoni për ‘lajmet e rreme’? Mendoni për disa fjalë kyçe që i lidhni me të.

Jepuni 15 minuta për këtë.

#### HAPI 3

Pas 15 minutash, kthejini ata në grup dhe kërkojuni të paraqesin letrën grafike të tyre. Gjatë prezantimit, përiquni të mbani shënime për lajmet e rreme dhe çfarë mund të jenë.

#### HAPI 4

Përmbliidhni atë që ata thanë për lajmet e rreme dhe ofroni atyre përkufizimin nga pjesa teorike.

#### HAPI 5

Tani kur ata janë të vetëdijshëm për përkufizimin, ndajini me ta ose faqet e internetit, ose shembuj të printuar të faqeve të internetit. Për më tepër, jepuni atyre edhe tabelën e printuar (në Shtojcë).

#### HAPI 6

Ftoni ata të kalojnë këto dy faqe në internet për disa minuta (jo shumë të gjatë, deri në 2 minuta për tekst) dhe të përiqen t'u përgjigjen pyetjeve në tabelë (shtojca).

#### HAPI 7

Kontrolloni me ta përgjigjet nga tabela. Ato të sakta janë si më poshtë:

#### Oktapodi pemë

Habitati: Në pyjet e buta tropikale të bregut perëndimor të Amerikës së Veriut.

Karakteristikat: Oktapodi ka tetë krahë. Mesatarisht (e matur nga maja e krahut deri te maja e mantelit) është e gjatë 30–33 cm. Është amfib, inteligjent dhe shikimi i tij është i krahasueshëm me shikimin e njerëzve.

Historia: Oktapodi është bërë i rrezikuar sepse industria e modës filloi ta vriste në numër të madh dhe t'ua shiste të pasurve në formën e stolive të kapelave.

### Pema Oktapod

Habitati: Bregdeti veri-perëndimor i Paqësorit të SHBA

Karakteristikat: Vetë pema shtrihet nga një bazë qendrore që është 15 metra përreth, dhe në vend që të qëllojë drejt lart me një trung qendror, trupi i pemës ndahet në një numër trungjesh më të vegjël.

Historia: Besohet të jetë rreth 250 deri në 300 vjeç. Askush nuk e di se si kjo pemë kishte kaq shumë trungje.

Theksoni se të dy tekstet e ofrojnë këtë informatë.

### HAPI 8

Tani thuani atyre se një nga këto faqe interneti është e rreme. Kështu që ata mund ta njohin më mirë, dërgoni përsëri në grupe të vogla që ishin në fillim dhe jepuni 5 W-të (të përgatitura paraprakisht) nga teoria dhe kërkojuni atyre t'u përgjigjen atyre pyetjeve dhe të përpiqen të gjejnë faqen e rreme të internetit. Jepuni atyre 10 minuta për këtë.

### HAPI 9

Kthehuni prapa si grup dhe bëni pyetjen "Cili është i rremë?" (Oktapodi i pemës). Si e dini? Kaloni të gjitha pyetjet me ta. Jepu atyre prova që vër-

tetojnë se është e rreme (1. URL-ja është e paplotë; 2. Përmbajtja - shiko seksionin mbi historinë - është e bujshme dhe jo e besueshme; 3. Pamjet e oktapodit përbehen tërësisht nga vepra arti dhe pamje të Fotot shop-it - një pamje e kundërt kërkimi e tregon këtë; 4. Nuk ka asnjë seksion 'Rreth nesh' ose informatë kontakti në faqe; 5. Një kontroll i thjeshtë në faqet e internetit më të besueshme, si Snopes dhe Wikipedia, zbulon se krijesa nuk ekziston.)

### HAPI 10

Përfundoni me një kujtesë se si të dalloni lajmet e rreme me 5W dhe se kjo është diçka që duhet kontrolluar përpara se të besoni ose të ndani lajme.

## SHTOJCA

| Habitati                | Karakteristikat | Historia |
|-------------------------|-----------------|----------|
| <b>Oktapodi i pemës</b> |                 |          |

### Pema oktapod

Faqja e internetit numër 1: <https://zapatopi.net/treeoctopus/>

Faqja e internetit numër 2: <https://www.atlasobscura.com/places/octopus-tree-of-oregon>

## PUNËTORIA



Zhvilluar nga doracaku "Bookmarks"

## KONTROLLIMI I FAKTEVE

**Koha:** Deri në 1h**Grupi:** Fleksibil**Qëllimi:** Për të vlerësuar besueshmërinë e informacionit të gjetur në internet; Për të

hulumtuar disa nga vështirësitë me të cilat përballen të rinjtë homoseksualë me gjuhën e urrejtjes në internet; Për të pasur parasysh sjelljen e tyre

në lidhje me përmbajtjen në internet.

**Materialet:** Qasje në internet; letra, stilolapsa, shënues, letër grafike

## Përshkrimi i punëtorisë:

## HAPI 1

Shpjegojuni pjesëmarrësve se aktiviteti do të hulumtojë përdorimin e internetit si një burim informate. Kontrolloni sa kohë shpenzojnë ata në internet? Dhe sa nga ajo kohë për të lexuar lajme?

## HAPI 2

Jepuni atyre skenarin e mëposhtëm dhe kontrolloni nëse të gjithë e kuptojnë detyrën.

**Skenarët:**

Pas një sërë sulmesh homofobike kundër të rinjve homoseksualë – veçanërisht në faqet dhe videot online – dhe lobimit të fortë nga OJ-Q-të, do të ketë një debat në parlament për këtë çështje. Qeveria ka propozuar

projektligjin për të ndarë para nga buxheti për përpjekjet arsimore për të luftuar qëndrimet homofobike dhe për të ofruar mbështetje për të rinjtë homoseksualë. Partitë kryesore të opozitës janë të gjitha kundër ligjit të ri. Ju duhet të imagjinoni se po punoni si studiues për një politikan që dëshiron të flasë në debat. Ata ju kërkuan që të përgatisni një konferencë për fjalimin e saj me disa pika kyçe që duhen theksuar në debat. Keni 20 minuta për të bërë disa hulumtime paraprake.

## HAPI 3

Ndajini ata në grupe me nga 4. Shpjegoni se në grupe, 2 veta veprojnë si 'studiues' dhe 2 veta që vëzhgojnë 'metodologjinë' e

studiuesve. Tregojuni atyre se hulumtimi kërkon një metodologji të duhur. Pyetni nëse ata mund të sugjerojnë disa konsiderata të rëndësishme në kryerjen e hulumtimit dhe bëni një listë të tyre në një letër grafike.

## HAPI 4

Kërkoni që vullnetarët të veprojnë si vëzhgues. Jepuni atyre kopje të fletës së monitoruesve dhe sigurohuni që ta kuptojnë detyrën. Për pjesën tjetër të grupit (2 nga katër) jepini fletë politikanësh. (Fletët janë në shtojcë). Ndani grupin në mënyrë që të keni një numër afërsisht të barabartë që punon për qeverinë dhe për partitë e ndryshme opozitare. Jepini secilit grup një kartë me detyrën e tyre.

**HAPI 5**

Shpjegoni se ata kanë 30 minuta për të kryer hulumtimin e tyre. Sugjeroni që të përdorin 20 minuta e para për të gjetur informatat përkatëse, dhe lini 10 minuta në fund për t'u pajtuar për pikat kryesore që do t'i paraqesin përfaqësuesit të tyre parlamentar.

**HAPI 6**

Kur grupet të kenë përfunduar detyrën, ftojini të largohen nga kompjuterët. Jepni atyre 5-10 minuta të tjera në mënyrë që monitoruesit në grupin e tyre të mund të japin komente mbi disa nga vëzhgimet e tyre kryesore.

**HAPI 7**

Ftojini studiuesit të paraqesin pikat kryesore që përzgjedhën për fjalimin e deputetit të tyre. Këto mund të paraqiten si "pika": pjesëmarrësit duhet të imagjinojnë se po informojnë deputetin.

**HAPI 8**

Lini një kohë pas çdo prezantimi që monitoruesit të paraqesin rezultatet e tyre dhe për çdo pyetje nga grupet e tjera mbi informatat e paraqitura ose strategjinë e përdorur.

**HAPI 9**

Informimi Pyetje rreth hulumtimit dhe informimit për përfaqësuesit parlamentar:

1. Sa e lehtë ishte detyra? Çfarë ishte më e vështirë?
2. Si vendosët se cilat faqe interneti të përdorni për informata? Sa u shqetësove nga 'besueshmëria' e faqeve ose 'e vërteta' e informatave që keni zgjedhur?
3. A i keni dhënë më shumë rëndësi gjetjes së informatave që do të mbështeste qëndrimin e përfaqësuesit tuaj, apo ofrimit të një përshkrimi 'objektiv' të çështjes? Çfarë mendoni se duhet të bëjë një studiues i vërtetë?
4. A keni kërkuar shembuj të gjuhës së urrejtjes kundër homoseksualëve? Nëse disa grupe nuk do ta bënin, a mendojnë ata se kjo do të kishte qenë e rëndësishme?
5. A mendoni se përfaqësuesi juaj do të ishte i kënaqur me kërkimin tuaj? A mendoni se ata që ajo përfaqëson do të ishin të lumtur?

Pyetje rreth përdorimit të internetit për qëllime kërkimore

1. A keni zbuluar ndonjë gjë të rëndësishme në lidhje me përdorimin e internetit për kërkime?

Dëshironi të shtoni diçka në listën e konsideratave të përpiluara në fillim të aktivitetit?

2. A jeni befasuar nga informatat e ndryshme që njerëzit arritën të gjenin? Si e shpjegoni këtë?
3. Cilat janë disa nga mënyrat se si mund të kontrollojmë nëse një faqe interneti është e besueshme, apo nëse informatat mund të besohen? A e bëni këtë zakonisht?

Pyetje në lidhje me homofobinë/gjuhën e urrejtjes në internet

1. A keni gjetur ndonjë shembull diskriminimi apo abuzimi?
2. A mendoni se keni gjetur ndonjë informatë që ishte 'e rreme' apo e padrejtë?
3. Cilat janë rreziqet e lejitimit të dikujt që të postojë mendimet e tij në internet? A mund të mendoni për gjëra që mund të bëni për të zvogëluar rreziqun që njerëzit e tjerë t'i marrin këto mendime si "fakt"?

## SHTOJCA

### Politikani 1:

Politikani juaj është anëtar i qeverisë. Ajo duhet të flasë fuqishëm në favor të legjislacionit të ri. Bëni një hulumtim në internet për të gjetur ndonjë informatë që do të ishte e dobishme për të në fjalimin e saj. Më pas bëni një listë me rreth 5 pika kyçe që mendoni se ajo duhet t'i adresojë.

### Politikani 2:

Politikani juaj është anëtar i opozitës. Ai është kundër ndarjes së parave nga buxheti për trajtimin e këtij problemi. Bëni një hulumtim në internet për të gjetur ndonjë informatë që do të ishte e dobishme për të në fjalimin e tij. Më pas bëni një listë me rreth 5 pika kyçe që mendoni se ai duhet t'i trajtojë.

### Politikani 3:

Politikani juaj është anëtar i një partie të pakicës. Partia juaj ende nuk ka vendosur nëse do ta mbështesë apo do ta kundërshtojë legjislacionin. Bëni një hulumtim në internet për të gjetur ndonjë informatë që do të ishte e dobishme për politikanin tuaj për të marrë vendimin e saj. Më pas bëni një listë me rreth 5 pika kyçe që mendoni se ajo duhet t'i adresojë.

### Monitorimi

Detyra juaj është të përpiqeni të analizoni qasjen e përdorur nga studiuesit. Përpiqueni të mblidhni sa më shumë informata për pyetjet në fletën e monitoruesve. Ju mund t'u kërkonte studiuesve të shpjegojnë se çfarë po bëjnë, apo pse po marrin një qasje të veçantë, për sa kohë që ju nuk i shpërqendroni ata shumë..

### Fleta e Monitorëve

|   | PËR ÇDO FAQE TË VIZITUAR: |
|---|---------------------------|
| EMRI I FAQES  |                           |
| PËRAAF. NUMRI I MINUTAVE TË SHPENZUARA NË FAQE  |                           |
| ORIENTIMI POLITIK' (PRO-GAY, ANTI-GAY, NEUTRAL)   |                           |
| PSE U ZGJODH FAQJA?   |                           |
| AUTORITETI I FAQES: - PSE DUHET T'I BESOHEM FAQES? - A E KONTROLLOI KËTË GRUPI?                       |                           |
| PËR NDONJË INFORMACION TË NXJERRË, A ËSHTË DHËNË BURIMI APO REFERENCA, DHE A E KONTROLLOI KËTË GRUPI? |                           |
| NDONJË GJË TË TJETËR QË LIDHET ME ATË SE IU QASËN HULUMTUESIT DETYRËS SË TYRE                         |                           |



# 04

## Ndërmarrësia shoqërore



## 4.1. Ndërmarrësia shoqërore dhe – Teoria dhe praktika

Sipas David Bornstein<sup>20</sup>, ndërmarrësia shoqërore mund të përshkruhet si një proces në të cilin qytetarët ose ndërtojnë ose transformojnë institucione për t'iu përgjigjur problemeve shoqërore, si varfëria, sëmundjet, abuzimet e të drejtave të njeriut, konflikti, korrupsioni, çështjet mjedisore, etj. Nëse duam të thjeshtojmë përkufizimin e saj, mund të themi gjithashtu se do të thotë të bësh biznes për një kauzë shoqërore.<sup>21</sup>

Ndërmarrësia ka qenë diçka interesante për shumë njerëz për shkak të karakteristikave të saj. Së pari, ajo kërkon “frymëzim, kreativitet, veprim të drejtpërdrejtë, guxim dhe qëndresë. Këto karakteristika janë thelbësore për procesin e inovacionit.”<sup>22</sup>

Për t'u bërë një ndërmarrës social, ka 4 aftësi që duhet të mësohen:

1. Inteligjenca ekonomike – një person duhet të jetë në gjendje t'i shohë gjërat nga mënyra/perspektiva të ndryshme;
2. Të motivuar nga shoqëria – Nevojat e njerëzve duhet të jenë fokusi kryesor;
3. Kurajë – Gatishmëri për të marrë vendime të vështira;
4. Të menduarit e shpejtë dhe alternativ – aftësia për të parë mundësi të reja dhe për të kërkuar mënyra inovative për të bërë gjëra.

Shumë do të pyesnin se si ndryshon ndërmarrësia shoqërore nga ndërmarrësia. Dallimi kryesor midis këtyre të dyjave është se në ndërmarrësi, qëllimi ose arsyeja kryesore për ta bërë atë janë paratë, ndërsa në ndërmarrësinë shoqërore, forca lëvizëse është altruizmi, që do të thotë të ndihmohet të tjerët. Duke marrë parasysh këtë, mund të konkludojmë lehtësisht se ndërmarrësia shoqërore mund të përdoret edhe në situata konflikti apo shoqërisht pas konfliktit si mjet i transformimit të konflikteve. Kur ka një situatë konflikti ose shoqërie pas konfliktit, ndërmarrësia shoqërore mund të përdoret për përshtatjen, adresimin dhe ndryshimin e konfliktit.<sup>23</sup>

<sup>20</sup> David Bornstein është gazetar dhe autor i specializuar në inovacionet shoqërore.

<sup>21</sup> Gurlek, Alper, Sadikovic, Edo, Rrjeti i Ambasadorëve Rinor të Paqes;

<sup>22</sup> [https://ssir.org/articles/entry/social\\_entrepreneurship\\_the\\_case\\_for\\_definition](https://ssir.org/articles/entry/social_entrepreneurship_the_case_for_definition)

<sup>23</sup> Spanuth, A., & Gümüşay, A.A., 2021, "Tre mënyra se si ndërmarrësit shoqërorë punojnë në rajonet e konfliktit"; Pioneers Post, Northwood;

## IDE PËR PUNËTORI

## PUNËTORIA



Zhvilluar nga Instrumenti "Ndikimi i Qëndrueshëm" nga Rrjeti i Ambasadorëve Rinor të Pages

## HULUMTIMI I NDËRMARRËSISË SHOQËRORE

**Koha:** Deri në 1h

**Grupi:** Fleksibil

**Qëllimi:** Për të hulumtuar dhe kuptuar më mirë se çfarë

është ndërmarrësia shoqërore dhe sfondi i saj teorik, si dhe për të vendosur një bazë të përbashkët në këtë fushë.

**Materialet:** Letra, letra grafike, shënues, 4 hapësira të ndryshme ose tavolina me karrige

### Përshkrimi i punëtorisë:

**HAPI 1** Shpjegojuni pjesëmarrësve se ky sesion i kush-tohet hulumtimit të ndërmarrësisë shoqërore dhe çfarë mund të jetë ajo.

**HAPI 2** Kërkoni 4 vullnetarë që do të përfaqësojnë 4 pyetje të ndryshme rreth 4 tabelave të ndryshme. Çdo vullnetar merr një pyetje:

1. Çfarë është ndërmarrësia shoqërore?
2. Çfarë i duhet një personi për t'u bërë një ndërmarrës shoqëror?
3. Hartoni shembujt më të mirë të ndërmarrësisë shoqërore për të cilat jeni në dijeni.
4. Si mund të përdoret ndërmarrësia shoqërore për zgjidhjen e konflikteve?

**HAPI 3** Pasi t'u delegoni pyetje vullnetarëve, shpjegoni se grupi do të ndahet në 4 dhe se ata do të kenë 5 minuta për të hedhur ide për çdo pyetje. Pas 5 minutash, grupet do të ndërrohen dhe do të kalojnë në pyetjen tjetër.

**HAPI 4** Kur të gjitha grupet të kenë kaluar në të gjitha pyetjet, -p vullnetarët të paraqesin atë për të cilën folën dhe cilat janë përfundimet kryesore. Filloni nga pyetja numër 1 deri në 4.

**HAPI 5** Pasi të keni kryer të gjitha prezantimet, përfundoni me përfundimet tuaja bazuar në pjesën teorike dhe përgjigjuni të gjitha pyetjeve që janë

bërë. Gjithashtu sigurohuni që t'i shtoni ndërmarrësit shoqërorë vendor që nuk ishin në listë.

**HAPI 6** Përfundoni me një pyetje "A është ndërmarrësia shoqërore që pjesëmarrësit do të donin të angazhoheshin më shumë? Nëse po, si?"

## PUNËTORIA



Zhvilluar nga Instrumenti "Ndikimi i Qëndrueshëm" nga Rrjeti i Ambasadorëve të Rinj të Pages

## Unë dhe ndërmarrësia shoqërore

**Koha:** Deri në 1h

**Grupi:** Fleksibil

**Qëllimi:** Reflektoni mbi ëndrrat, mundësitë dhe shanset e pjesëmarrësve për

t'u angazhuar më shumë në ndërmarrësinë shoqërore ose për t'u bërë ndërmarrës shoqërorë.

**Materialet:** Fletushka, stilolapsa

### Përshkrimi i punëtorisë:

#### HAPI 1

Informoni pjesëmarrësit se ky sesion synon të hulumtojë dëshirat dhe potencialet e tyre për ndërmarrësi shoqërore.

#### HAPI 2

Jepuni atyre fletushka dhe shpjegoni se kjo fletushkë paraqet "Konceptin e iriqit". Këto fletëpalosje duhet të plotësohen vetë, pasi është një reflektim individual.

#### HAPI 3

Në çdo rreth ata duhet t'i përgjigjen njëjës prej pyetjeve që janë tashmë në fletushkë.

1. Në çfarë mund të jesh më i miri në botë? Të jesh më i miri në botë nuk është rreptësisht e nevojshme. Ju mund të jeni një eks-

pert relativ në diçka dhe ende të bëni punë domethënëse. Gatimi? Peshkimi? Puthje? Inxhinieri? Shkenca raketore? Ata shkojnë në rrethin e parë siç është shënuar në fletëpalosje.

2. Çfarë e drejton motorin tuaj ekonomik? Shumë nga aftësitë që mund të keni, si "përtpypja e çamçakëzit" ose "zvarritja" nuk janë shumë të tregtueshme. (Megjithatë, më befasoni.) Ideja kryesore këtu është tregtueshmëria. Për çfarë do t'ju paguajnë njerëzit e tjerë? Çfarë aftësie mund t'ju sjellë të ardhura të qëndrueshme?

3. Për çfarë jeni thellësisht i apasionuar? Ideja këtu nuk është të nxisni pasionin, por të zbuloni se

çfarë ju bën të pasionuar. Jini të singertë me veten. Çfarë ju emocionon vërtet? Çfarë ju motivon të ngriheni në mëngjes?

#### HAPI 4

Sqaroni se çfarë duhet të shkruhet në çdo rreth. Jepuni atyre 20 minuta për këtë.

#### HAPI 5


Kur të gjithë të kenë mbaruar, shpjegoni atyre se çfarë do të thotë çdo rreth. Kryqëzimi midis rathëve të parë dhe të dytë në figurë do të thotë që ju jeni duke bërë atë që jeni thellësisht të apasionuar dhe në një farë mënyre po fitoni para prej saj, megjithatë nuk jeni aq të mirë në këtë. Pra, ky skenar nuk duket më shumë se një "ëndërr" pasi njerëzit në fund

do të preferojnë ta marrin shërbimin nga ata që janë të mirë në ofrimin e tij. Kryqëzimi midis rrahëve të parë dhe të tretë, që sugjeron se jeni duke bërë atë që jeni të pasionuar dhe mund të jeni vërtet ekspert në këtë, megjithatë nuk ka asnjë përfitim ekonomik nga kjo. Fatkeqësisht, aktivitetet që i

përkasin këtij skenari do të jenë vetëm hobi juaj. Kryqëzimi i fundit i dy rrahëve është ai ndërmjet të dytit dhe të tretës. Kjo sugjeron që ju jeni duke bërë diçka në të cilën jeni të shkëlqyer dhe për fat të mirë ka njerëz të gatshëm të paguajnë për të. Problemi këtu është mungesa e pasionit. Nëse nuk do të

mbahesh pas asaj që po bën dhe e urren çdo sekondë të saj, atëherë çfarë kuptimi ka ta bësh atë?

Iriqi i fshehur në këtë figurë është kryqëzimi i të tre rrahëve. Mund të tingëllojë si një utopi për disa prej jush, por mund të kthehet në realitet.



**HAPI 6** Tani ndajeni të gjithë grupin në çifte dhe kërkojuni atyre (nëse duan) të ndajnë konceptin e tyre të Iriqit. Ata, si çifte, duhet të anali-

zojnë konceptet dhe të mendojnë për zgjidhjen më të mirë të mundshme, në mënyrë që Iriqi i tyre të plotësohet. Jepuni atyre 10 minuta për këtë.

**HAPI 7** Pasi të gjithë të ndajnë, ftoni të mblidhen përsëri dhe të fillojnë të diskutojnë.

## INFORMIMI



1. Si ndiheni?
2. A mendoni se është e mundur të bëni punën që përmbush të 3 rrathët?
3. A na lejon realiteti ta bëjmë këtë?
4. A jeni i gatshëm të punoni më tej në mënyrë që të plotësohen të 3 rrathët?

## FLETA/SHËNIMI:



## PRAKTIKAT E MIRA NGA NIVELI LOKAL

### 1. SKEMA E GRANTIT RCT

**Çfarë?** Skema e Granteve RCT synon të ofrojë mbështetje të komunitetit për idetë e zgjidhjes së problemeve në temën e pajtimit, transformimit të konflikteve dhe ndërtimit të paqes. Skema e granteve në shkallë të vogël zbatohet në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica për individët dhe organizatat bazë duke adresuar

nevojat që kanë të bëjnë me ndërtimin e besimit ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në Kosovë. Ky grant u mundëson atyre individëve dhe organizatave bazë të zbatojnë idetë e tyre. Ky projekt është ende në vazhdim, por katër ide për zgjidhjen e problemeve do të zgjidhen dhe do të mbështeten me grantin.

**Nga kush?** Community Building Mitrovica

## 4.2. Problemet shoqërore, aktivizmi, dhe ndërmarrësia shoqërore

Problemet shoqërore kanë shumë përkufizime. Si fillim, problemet shoqërore lidhen me sjelljet dhe kontekstet që po ndikojnë negativisht tek njerëzit. Për më tepër, mund të përkufizohet si "një gjendje e padëshirueshme që njerëzit besojnë se duhet korrigjuar". Janë çështje që prekin negativisht një numër të madh njerëzish. Ato përfshijnë pengimin e njerëzve që të gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre." Problemet shoqërore mund të jenë p.sh: varfëria, kequshqyerja, racizmi, papunësia etj.

Në anën tjetër të problemeve shoqërore kemi aktivizmin. Aktivizmi mund të shpjegohet si "përdorimi i veprimit të drejtpërdrejtë dhe të dukshëm për të arritur një rezultat, zakonisht politik apo shoqëror". Më thjesht, ai mund të përshkruhet si një veprim i avokimit ose fushatës për të sjellë ndonjë ndryshim, qoftë politik apo shoqëror.

Problemet shoqërore dhe aktivizmi janë të lidhura me ndërmarrësinë shoqërore në nivele të ndryshme. Para së gjithash, problemet shoqërore duhet të jenë diçka që trajtohet drejtpërdrejt nga ndërmarrësia shoqërore. Ndërmarrësia shoqërore duhet të nxisë zgjidhjen e tyre dhe të sjellë ndryshime pozitive. Nga ana tjetër, aktivizmi duhet parë si pjesë e ndërmarrësisë shoqërore dhe një nga mënyrat për të sjellë ndryshime shoqërore.

Duke u fokusuar në problemet shoqërore, aktivistët mund të bëjnë presion të mëtijshëm mbi akterët e ndryshëm për të krijuar ndryshimin e nevojshëm.

## IDE PËR PUNËTORI

## PUNËTORIA



Zhvilluar nga Instrumenti “Ndikimi i Qëndrueshëm” nga Rrjeti i Ambasadorëve të Rinjë të Pages

## ZHVILLIMI I IDESË DHE VEPRIMIT

**Koha:** Deri në 1h  
**Grupi:** Fleksibil

**Qëllimi:** Të hartojë problemet shoqërore lokale dhe të

kërkojë zgjidhje të mundshme.  
**Materialet:** Fleta, stilolapsa

## Përshkrimi i punëtorisë:

## HAPI 1

Shpjegojuni pjesëmarrësve se ky sesion synon të hulumtojë problemet shoqërore lokale dhe zgjidhjet e mundshme për to. Prandaj, kërkojuni atyre të mendojnë për problemet kryesore shoqërore në mjedisin e tyre.

## HAPI 2

Për t'u frymëzuar, jepuni atyre këtë listë të problemeve të mundshme shoqërore që mund të trajtohen nga ndërmarrësia shoqërore:

1. Përplasja kulturore: Zgjidhja e problemeve kulturore në komunitetin tuaj
2. Nuk është e lehtë të jesh i gjelbërt: Të trajtosh problemet mjedisore drejtpërdrejtë

3. Sigurimi i komoditetit të shtëpisë: Ushqimi, Veshja dhe Strehimi
4. Shëroni veten: Trajtimi i problemeve shëndetësore
5. Lëvizja e Popullit: Migrimi dhe Imigrimi
6. Mënyrat e të jetuarit: Adresimi i çështjeve të stilit të jetesës
7. Të punosh për të jetuar: Të ndihmohesh njerëzit të gjejnë punë
8. Ndërtuesit e paqes janë të bekuar: Duke punuar për Paqe dhe Pajtim
9. Kthimi në shkollë: Arsimi dhe zhvillimi personal dhe komunitar
10. Ndarja etnike: Bashkimi i shoqërisë së ndarë.

## HAPI 3

Jepuni atyre rreth 10 minuta për të menduar për problemin shoqëror që do të donin të trajtonin.

## HAPI 4

Kur të gjithë të kenë vendosur mbi cilin problem duan të punojnë, ftojini të mendojnë për Iriqët, që do të thotë se si këto çështje mund të trajtohen nga një shërbim me të cilin ju jeni të mirë, që ju pëlqen ta bëni dhe mund t'ua shisni njerëzve të tjerë. Në rast se Iriqi nuk është përfunduar më parë, mund ta bëni edhe si pjesë e këtij sesioni.



**HAPI 5** Jepuni atyre një fletë dhe 15 minuta për të menduar dhe plotësuar.

**HAPI 6** Kur të gjithë të kenë mbaruar, ftojini të lexojnë fletët e tyre. Pas çdo leximi,

grupi duhet të komentojë se sa i realizueshëm është plani dhe çfarë mund të bëhet për ta bërë që të ndodhë.

**HAPI 7** Informimi:  
1. Si ndiheni pas këtij aktiviteti?

2. A janë veprimet që propozuat për të cilat do të dëshironit të punoni?
3. A mendoni se problemet shoqërore mund të zgjidhen me veprimet tuaja?



## FLETA/SHENIMI:

Unë do të doja të ofroj këtë shërbim/produkt:.....

Të adresoj këtë problem:.....

Për këta persona:.....

Një veprim që mund të bëj për të më ndihmuar:.....

## PUNËTORIA



Zhvilluar nga Instrumenti “Ndikimi i Qëndrueshëm” nga Rrjeti i Ambasadorëve të Rinj të Pages”

## BËRJA E PLANIT TË NDËRMARRËSISË SHOQËRORE

KJO PUNËTORI DUHET TË PASOJË PAS PUNËTORISË NUMËR 1

**Koha:** Deri në 1h

**Grupi:** Fleksibil

**Qëllimi:** Zhvilloni më tej planin e ndërmarrjes dhe testojeni atë.

**Materialet:** Fletët e shtypura, stilolapsat;

### Përshkrimi i punëtorisë:

#### HAPI 1

Ky sesion ka për qëllim zhvillimin e planit të ndërmarrjes shoqërore. Ftoni pjesëmarrësit të përdorin idetë e tyre nga sesionet e mëparshme dhe tani përpunoni t'i testoni ato.

#### HAPI 2

Jepuni fletët dhe thuani se për të testuar idetë e tyre, ne do të përdorim “Business Model Canvas”. Prezantimi pamor i një modeli biznesi i ka nëntë elementë:

- 1) Partnerët kryesorë: Çfarë mund të bëjë kompania që të mund të fokusohet në aktivitetet e saj kryesore?
- 2) Aktivitetet kryesore: Cilat gjëra unike strategjike bën biznesi për të ofruar propozimin e tij?

3) Burimet kryesore: Çfarë asetesh unike strategjike duhet të ketë biznesi për të konkurruar?

4) Propozimet e vlerës: Çfarë është bindëse në lidhje me propozimin? Pse klientët blejnë, përdorin?

5) Marrëdhëniet me klientin: Si ndërvepron me klientin përmes “udhëtimit” të tyre?

6) Kanalet: Si promovohen, shiten dhe shpërndahen këto propozime? Pse? A po funksionon?

7) Segmentet e klientëve: Kush janë klientët? Çfarë mendojnë ata? Shohin? Ndjejnë? Bëjnë?

8) Struktura e kostos: Cilët janë shtytësit kryesorë të kostos së biznesit? Si janë të lidhura me të hyrat?

9) Rrjedhat e të hyrave: Si fiton biznesi të hyra nga propozimet e vlerës?

#### HAPI 3

Jepuni atyre 20 minuta për të testuar propozimet e tyre sipas fletës 2.

#### HAPI 4


Kur të gjithë të kenë mbaruar me fletët e tyre, vendosini në çifte që të mund të paraqesin dhe komentojnë planin e njëri-tjetrit dhe çfarë duhet të ndryshohet.

#### HAPI 5

Informimi:

1. Si ishte ky ushtrim për ju?
2. Sa e realizueshme duket tani ideja juaj?
3. Si shkoi prova e idesë suaj?

## FLETA 1:



## FLETA 2:

- 1 Propozimi i vlerës: Çfarë po ofroni/shitni dhe çfarë është e veçantë e ofertës suaj?

---

- 2 Aktivitetet kyçe: Çfarë do të bëni në të vërtetë për të ofruar propozimin tuaj?

---

- 3 Segmenti i klientit: Kujt po i ofroni shërbimin/produktin tuaj?  
Pasi të siguroheni se keni plotësuar dy seksionet e para, është koha për

---

- 4 Kanalet: Si/Ku do të promovoni, shisni dhe ofroni shërbimet tuaja?

---

- 5 Marrëdhëniet me klientin: Si do të ndërveproni me klientët?

---

- 6 Partnerët kyç: Me të cilët mund të bashkëpunoni për t'u liruar nga disa prej aktiviteteve?  
Pas kësaj pike, qëllimi është ngritja e biznesit. Pra, gjëra të tilla si kostot, çmimet, shitjet dhe marketingu, dhe marrëdhëniet me klientët bëhen vërtetë të rëndësishme.

---

- 7 Burimet kryesore: Çfarë duhet të jeni në këtë biznes, dhe si t'i blini ato?

---

- 8 Struktura e kostos: Sa i kushtojnë kompanisë suaj burimet dhe aktivitetet tuaja?

---

- 9 Rrjedhat e të hyrave: Si po fitoni para? Cilat janë të ardhurat tuaja? (Shënim i përkthyesit: Në Anglisht është fjala Income dhe në shqip dmth të ardhurat, nëse ang. do ishte revenue atëherë shqip do përkthehej të hyrat?)

---

# 05

## Mirënjohjet

Ekipi i Doracakut për edukimin qytetar për paqe do të donte që të falënderojë personat e mëposhtëm për mbështetjen e tyre në krijimin e kësaj pjese.

Së pari, dëshirojmë të falënderojmë USAID-in për mbështetjen e tyre në kornizën e projektit të Pajtimit dhe Transformimit të Konfliktëve, përmes të cilit është krijuar ky doracak. Për më tepër, përgatitja e këtij doracaku do të ishte e pamundur pa përpjekje të mëdha nga anëtarët e stafit të Community Building Mitrovica, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë dhe Iniciativa e Re Shoqërore, dhe ne jemi plotësisht mirënjohës për këtë.

Në fund fare, shumë faleminderit për ndërtesën e paqes në mbarë botën, veçanërisht ata në Kosovë, të cilët vazhdojnë të na frymëzojnë dhe motivojnë ne për t'u përfshirë në çështje kaq të rëndësishme siç janë proceset e paqes dhe pajtimit.

**Paqja është një ide revolucionare...Ai revolucion ndodh gjatë gjithë kohës; detyra jonë është ta zgjerojmë atë në shtrirje dhe fushëveprim. Detyrat janë të pafundme; çështja është nëse ne jemi në dorë të tyre"**

Johan Galtung,  
Paqe me mjete paqësore, faqe 274

# 06

## Bibliografia

- Cambridge dictionary, <https://dictionary.cambridge.org/>
- Compass: Manual for Human Rights Education with Young People, Council of Europe, 2020
- Education Pack “All different, all equal”, 2016, Council of Europe
- Edward t. Hall, 1976, “Beyond Culture”, Anchor; Anchor Books ed edition,
- European Convention on Human Rights”, Council of Europe, 1950;
- European Court of Human Rights <https://echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=home>
- Galtung, J; 1996, “Peace by Peaceful Means”; International Peace Research Institute Oslo; Sage Publications, Inc.
- Galtung, J, 2003, “Peace Journalism”. Media Asia, Volume 3, Issue 3
- Gurlek, A, Sadikovic, E, 2017, “Social Entrepreneurship 101”, Sende;
- Lederach, JP, 1998 “Building Peace: Sustainable Reconciliation in Divided Societies”; United States Institute of Peace Press
- Manual Bookmarks, 2016, Council of Europe
- Manual “We CAN”, 2017, Council of Europe
- Media Literacy Now, <https://medialiteracynow.org/what-is-media-literacy/>
- Radosavljevic, N. 2018, “The Influence of Dialogue Projects on The Reconciliation Process in Kosovo, The Case of The Youth Peace Camp”, European Centre for Minority Issues, Flensburg
- Social Problems, <https://open.lib.umn.edu/socialproblems/chapter/1-1-what-is-a-social-problem/>, accessed May 2022
- Spanuth, A., & Gümüşay, A.A., 2021, “Three ways social entrepreneurs work in conflict regions”; Pioneers Post, Northwood;
- Stanford Social Innovation Review, [https://ssir.org/articles/entry/social\\_entrepreneurship\\_the\\_case\\_for\\_definition](https://ssir.org/articles/entry/social_entrepreneurship_the_case_for_definition)
- “Sustainable Impact” Toolkit by Youth Peace Ambassadors Network and Sende
- Teaching English, The British Council, <https://www.teachingenglish.org.uk/article/fake-news>
- Thomas - Klimann Conflict Models, 1970
- Toolkit on Intercultural Dialogue, Service Civil International, 2018

Toolkit “Youth Transforming Conflict”, Council of Europe and European Commission;2012

The Debunking Handbook 2020, <https://www.climatechangecommunication.org/wp-content/uploads/2020/10/DebunkingHandbook2020.pdf>

Universal declaration of Human rights, Article 19, <https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>

Youth Peace Camp, Council of Europe program, <https://www.coe.int/en/web/youth-peace-dialogue/youth-peace-camp>

White Paper on Intercultural Dialogue, 2008, Launched by the Council of Europe Ministers of Foreign Affairs at their 118th Ministerial Session, Strasbourg;



